



FKEE

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË
KOSOVSKI FOND ZA ENERGETSKU EFIKASNOST
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND

RAPORTI VJETOR 2024

Prishtinë, Korrik 2025



Përmbajtja

<u>1. Hyrje</u>	<u>01</u>
<u>Përmbledhje Ekzekutive</u>	<u>01</u>
<u>2. Fjala Hyrëse e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve</u>	<u>02</u>
<u>3. Fjala Hyrëse e Drejtorit Menaxhues</u>	<u>03</u>
<u>4. Fondi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë</u>	<u>05</u>
<u>4.1 Misioni dhe fushëveprimi</u>	<u>05</u>
<u>4.2 Organizimi i brendshëm i FKEE-së</u>	<u>05</u>
<u>4.2.1 Bordi i Drejtorëve të FKEE</u>	<u>05</u>
<u>4.2.2 Drejtori Menaxhues</u>	<u>07</u>
<u>4.3 Departamentet e FKEE-së</u>	<u>08</u>
<u>4.3.1 Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme</u>	<u>09</u>
<u>4.3.2 Departamenti i Financave</u>	<u>09</u>
<u>4.3.3 Departamenti i Operacioneve</u>	<u>09</u>
<u>4.3.4. Struktura organizative e Fondit të Kosovës për Efiçencë të Energjisë</u>	<u>09</u>
<u>5. Aktivitetet Kryesore të FKEE-së</u>	<u>12</u>
<u>5.1 Burimet njerëzore</u>	<u>12</u>
<u>5.2. Diversiteti, barazia, gjithpërfshirja dhe mirëqenia</u>	<u>12</u>
<u>5.3 Zhvillimi i Kapaciteteve dhe Strukturës Organizative të FKEE-së</u>	<u>14</u>
<u>5.4 Prokurimi dhe zgjerimi i konkurrencës në treg</u>	<u>15</u>
<u>5.5 Aktivitetet Ligjore të FKEE-së</u>	<u>17</u>
<u>5.6 Hartimi dhe implementimi i kontratave dhe marrëveshjeve</u>	<u>17</u>
<u>5.7 Menaxhimi i rrezikut dhe mbështetja ligjore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve</u>	<u>18</u>
<u>5.8 Përmbledhje e përgjithshme mbi rastet gjyqësore</u>	<u>19</u>
<u>5.9 Procesi i kthimit të investimeve</u>	<u>19</u>
<u>5.10 Mbrojtja e të dhënave</u>	<u>19</u>
<u>6. Aktivitetet në Fushën e Efiçencës së Energjisë</u>	<u>20</u>
<u>6.1 Projektet e zbatuara në sektorin publik</u>	<u>20</u>
<u>6.1.1 Projektet në Proces të Zbatimit të Masave të Efiçencës së Energjisë</u>	<u>21</u>
<u>6.1.2 Projektet në fazën e garancionit</u>	<u>21</u>
<u>6.1.3 Projektet në fazën e dizajnit të masave të Efiçencës së Energjisë</u>	<u>23</u>
<u>6.1.4 Projekte në proces të tenderimit dhe fillimit të zbatimit të masave të efiçencës së energjisë</u>	<u>23</u>

<u>6.1.5 Studimi i fizibilitetit dhe aplikimi i masave EE në ndërtesa publike në Kosovë</u>	<u>25</u>
<u>6.1.6 Projekte në proces për qëndrueshmërinë klimatike në sektorin e ujit në Kosovë</u>	<u>25</u>
<u>6.2 Donacionet</u>	<u>26</u>
<u>6.3 Projektet e zbatuara në sektorin e banimit (rezidencial)</u>	<u>27</u>
<u>6.3.1 Zbatimi i masave EE në Sektorin Rezidencial në shtëpitë individuale</u>	<u>28</u>
<u>6.3.2 Zbatimi i masave EE në ndërtesat shumë-banesore sociale në pronësi të komunave</u>	<u>34</u>
<u>6.3.3 Kursimi i energjisë për ngrohje</u>	<u>36</u>
<u>6.4 Sfidat në Zbatimin e Projekteve në Sektorin Publik dhe Rrezidencial</u>	<u>36</u>
<u>7. Raporti i Impaktit</u>	<u>39</u>
<u>7.1 Ndikimi i Investimeve të FKEE-së</u>	<u>39</u>
<u>7.1.1 Ndikimi mjedisor</u>	<u>39</u>
<u>7.2 Ndikimi social</u>	<u>49</u>
<u>7.3 Ndikimi ekonomik</u>	<u>49</u>
<u>8. Potenciali në Sektorin Rezidencial</u>	<u>73</u>
<u>8.1 Sektori rezidencial – Një Histori Suksesi</u>	<u>73</u>
<u>8.2 Potenciali për Zgjerim dhe Nevoja për Përkrahje Buxhetore</u>	<u>74</u>
<u>8.3 Hapja e Zyrës në Mitrovicë të Veriut</u>	<u>74</u>
<u>9. Menaxhimi Financiar, Arritjet dhe Sfidat</u>	<u>76</u>
<u>9.1 Menaxhimi i Portofolit të Skemës Kthyese (Komponenti Qarkullues)</u>	<u>77</u>
<u>9.2 Qëndrueshmëria financiare e FKEE-së</u>	<u>78</u>
<u>10. Komunikimi me Publikun dhe Transparenca</u>	<u>80</u>
<u>10.1 Përfshirja e publikut, komunikimi dhe transparenca</u>	<u>80</u>
<u>10.2 Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe partnerët</u>	<u>82</u>
<u>11. Fjalime dhe Mirënjohje</u>	<u>83</u>
<u>11.1 Fjala e Donatorëve</u>	<u>83</u>
<u>11.2 Mirënjohje për Donatorët dhe Bashkëpunëtorët</u>	<u>86</u>
<u>12. Lista e shkurtesave të përdorura</u>	<u>87</u>
<u>13. Përfundimi</u>	<u>88</u>
<u>Pasqyrat financiare më dhe për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024.</u>	

1. Hyrje

Përmbledhje Ekzekutive

Fondi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë (në tekstin e mëtejme: FKEE), në përputhje me kërkesat ligjore që dalin nga Ligji për Efiçencë të Energjisë (Ligji Nr. 06/L-079), paraqet Raportin Vjetor për vitin 2024 në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Raporti përmban informata mbi aktivitetet në lidhje me fushëveprimin e FKEE-së, me qëllimin kryesor që të punojë në rritjen e efiçencës së energjisë në Kosovë dhe në arritjen e objektivave shtetërore.

Qëllimi i FKEE-së është të reduktojë konsumin e energjisë, të ulë emetimet e gazrave serrë dhe të mbështesë praktikën më të qëndrueshme sa i përket efiçencës së energjisë. I themeluar si një mekanizëm për të mbështetur dhe zbatuar masa të efiçencës së energjisë, FKEE ka menaxhuar burimet financiare dhe ka zbatuar e financuar projekte investive në këtë fushë.

Raporti përmban të dhëna lidhur me arritjet, sfidat dhe synimet e ardhshme që kanë për qëllim promovimin e masave për kursimin e energjisë dhe përmirësimin e efikasitetit të saj në sektorë të ndryshëm, si në atë publik, ashtu edhe në atë rezidencial apo privat. Investimet në këto projekte kanë kontribuar në uljen e konsumit të energjisë dhe reduktimin e emetimeve të gazrave serrë.

Viti 2024 ka sjellur arritje të rëndësishme në financimin dhe implementimin e projekteve me një fokus të veçantë në uljen e konsumit të energjisë, zvogëlimin e ndikimit mjedisor dhe sigurinë e furnizimit. Investimet kryesore përfshijnë rinovimin e ndërtesave me konsum të lartë të energjisë dhe përmirësimin e performancës energjetike të tyre.

Investimet e FKEE-së në këto projekte kanë rezultuar në kursime të llogaritura të energjisë deri në **60%**, e në disa raste edhe më shumë, dhe përmirësime të kushteve mjedisore. Krahas matjeve, këtë e dëshmojnë edhe përfituesit kanë raportuar kursime në faturat e energjisë si rezultat i mbështetjes së Fondit.

FKEE, në përputhje me misionin e vet për të promovuar praktikën e energjisë efiçente dhe ruajtjen e mjedisit, ka synuar të përmirësojë ofrimin e shërbimeve të tij duke hapur një zyrë të re në Mitrovicë të Veriut, për të qenë më pranë përfituesve të tij, duke siguruar gjithëpërfshirje dhe qasje më të lehtë për të gjithë qytetarët. Qëllimi i hapjes së kësaj zyre të re ka qenë përmirësimi i qasjes në mënyrë që shërbimet e FKEE-së të bëhen më të arritshme për sektorin privat dhe atë publik në këtë rajon. Suksesi i kësaj iniciative mbështetet në planifikim të kujdesshëm, burime të mjaftueshme dhe bashkëpunim aktiv me palët e interesit, siç janë Bashkimi Evropian, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe komunat veriore të Republikës së Kosovës. Me mision të qartë dhe punonjës të angazhuar, zyra në Mitrovicë të Veriut synon të bëhet një qendër për avancimin e efiçencës së energjisë në atë rajon.

FKEE ka realizuar një vit të suksesshëm, duke pasur një ndikim të ndjeshëm në përmirësimin e efiçencës së energjisë dhe reduktimin e ndotjes. Me fokus në projekte të qëndrueshme dhe bashkëpunime strategjike, FKEE do të vazhdojë të rrisë ndikimin dhe të kontribuojë në objektivat e caktuara në Strategjinë e Energjisë. Rritja e vazhdueshme financiare, partneritetet e suksesshme dhe një portofol i projekteve në zgjerim, e vendosin FKEE-në në një pozicion të shkëlqyer për të shtyer përpara inovacionin dhe qëndrueshmërinë në vitet në vazhdim.

2. Fjala Hyrëse e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve



Enis Spahiu

Kryesues i Bordit të Drejtorëve

Fondi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë (FKEE)

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar anëtarë të Bordit, partnerë strategjikë dhe bashkëpunëtorë,

Me krenari dhe mirënjohje ju paraqesim Raportin Vjetor për vitin 2024 të Fondit të Kosovës për Efiçencë të Energjisë, për një vit që ka shënuar hapa domethënës për efiçencën e energjisë dhe qëndrueshmërinë e sektorit energjetik në Republikën e Kosovës.

Gjatë vitit 2024, Fondi ka realizuar projekte ambicioze me ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe rritjen e efikasitetit energjetik. Një nga sukseset më të spikatura është zbatimi i masave të efiçencës së energjisë në sektorin e amvisërisë dhe fillimin e projektit në ndërtesa të banimit social. Po ashtu, janë finalizuar projektet në sektorin publik dhe kanë filluar iniciativa të reja për modernizimin energjetik të institucioneve publike.

Një arritje kyçe ishte edhe zgjerimi i gamës së financimeve dhe sigurimi i investimeve të reja nga donatorët tanë, duke rritur stabilitetin financiar të Fondit. Po ashtu, hapja e zyrës së re në Mitrovicën e Veriut ka siguruar një qasje më të gjerë në programet e efiçencës së energjisë dhe ka forcuar bashkëpunimin me komunitetet lokale.

Me gjithë sukseset dhe të arriturat, viti 2024 ka sjellë edhe sfida të konsiderueshme. Proceset burokratike dhe vonesat administrative në prokurim publik lidhur me zbatimin e projekteve, janë përballuar dhe menaxhuar me përkushtim nga stafi i Fondit, duke përmirësuar procedurat tona të brendshme dhe duke rritur transparencën. Sfida e rritjes së kapaciteteve njerëzore brenda Fondit është adresuar me rekrutime strategjike dhe trajnime për stafin. Po ashtu, angazhimi për rritjen e vetëdijesimit publik mbi efiçencën e energjisë dhe zbatimin e masave të reja inovative vazhdon të mbetet një prioritet i vështirë, por i domosdoshëm.

Fondi do të vazhdojë të konsolidojë pozitën e tij si një institucion qendror për promovimin e efiçencës së energjisë në Republikën e Kosovës. Synim strategjik do të mbetet zgjerimi i skemave të financimit, mbështetja e sektorit privat në masa inovative për kursimin e energjisë dhe integrimi i teknologjive të reja për të rritur ndikimin e projekteve. Angazhimi ynë do të mbetet i palëkundur për krijimin e një mjedisi më të pastër dhe një sistemi energjetik më të qëndrueshëm për brezat e ardhshëm.

Dua të falënderoj Drejtorin Menaxhues të Fondit për përkushtimin e tij për arritjen e objektivave të Fondit. Gjithashtu, jam mirënjohës edhe për stafin e Fondit dhe e falënderoj secilin një nga një, për punën e palodhur. Mirënjohje dhe falënderim të veçantë meritojnë edhe partnerët e jashtëm. Suksesi ynë është rezultat i bashkëpunimit, vizionit dhe punës së palodhur për të ndikuar pozitivisht në jetën e qytetarëve tanë.

3. Fjala Hyrëse e Drejtorit Menaxhues



Driton Hetemi

Drejtor Menaxhues dhe Anëtar Bordi

Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE)

Duke reflektuar mbi vitin 2024, jemi krenarë për një vit transformimi, qëndrueshmërie dhe arritjesh të jashtëzakonshme për Fondin e Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE). Ky vit u karakterizua nga zbatimi i suksesshëm i projekteve madhore, nënshkrimi i iniciativave të reja strategjike dhe një ristrukturim i thellë i institucionit tonë, duke na bërë më të fortë, më fleksibil dhe më të përgatitur për të përmbushur misionin tonë.

Eficienca e energjisë mbetet thelbi i zhvillimit të qëndrueshëm, dhe në vitin 2024, FKEE ka bërë hapa të mëdhenj në sjelljen e përfitimeve të prekshme për qytetarët dhe mjedisin. Me sukses përmbyllëm thirrjen e parë për subvencionimin e masave të eficiencës së energjisë për shtëpitë individuale përmes përkrahjes financiare nga Bashkimi Evropian, duke ndikuar pozitivisht në rreth 1,800 familje, ndërsa thirrja e dytë mundësoi që mbi 1,200 familje të tjera të përfitonin nga masat e kursimit të energjisë në shtëpitë e tyre. Investimet totale të mundësuarra për këto ~3,000 familje arrijnë në një shumë prej rreth 11 milionë euro, duke kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe uljen e konsumit të energjisë për familjet përfituese. Angazhimi ynë për të zgjeruar më tej këto mundësi mbetet i palëkundur.

Gjithashtu, ky vit shënoi thyerjen e barrierave të gjata procedurale, duke na mundësuar fillimin e zbatimit të masave të eficiencës së energjisë në 25 ndërtesa të banimit social në 12 komuna, përderisa po presim fillimin e 3 projekteve të tjera në komunën e 13-të. Në të njëjtën kohë, bashkëpunimi ynë me sektorin publik vazhdon të zgjerohet, me mbi 85 projekte të përfunduara si dhe 1 në përfundim, dhe shumë iniciativa të reja, përfshirë 17 projekte të reja në sektorin publik që tashmë janë në proces realizimi, duke dëshmuar përkushtimin tonë për krijimin e komuniteteve më të qëndrueshme.

Një nga arritjet më të rëndësishme të vitit ishte ristrukturimi i FKEE-së, një proces që ka forcuar kapacitetet tona të brendshme dhe ka rritur efikasitetin tonë operativ. Kjo reformë ka qenë kyçe për optimizimin e zbatimit të projekteve, ngritjes së ekspertizës së brendshme, përmirësimin e bashkëpunimit me palët e interesit dhe forcimin e transparencës dhe llogaridhënies. Në qendër të këtij transformimi qëndron ekipi ynë i jashtëzakonshëm, një grup profesionistësh të përkushtuar, ekspertiza dhe angazhimi i të cilëve kanë qenë vendimtarë në shndërrimin e sfidave në mundësi. Përkushtimi i tyre është forca lëvizëse e suksesit tonë.

Rrugëtimi ynë nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen e palëkundur të partnerëve tanë të çmuar - Bashkimit Evropian, Bankës Botërore dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës. Besimi, financimi dhe ekspertiza e tyre teknike kanë qenë thelbësore për realizimin e vizionit tonë të përbashkët për një Kosovë më të gjelbër dhe më efiçiente në energji.

Jemi gjithashtu thellësisht mirënjohës për partnerët tanë që kanë luajtur një rol kyç në asistencën teknike dhe ndërtimin e kapaciteteve, përfshirë GIZ Kosova, Balkan Green Foundation, Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare, Universiteti i Arkitekturës në UP, LuxDev, Posta e Kosovës, KESCO dhe shumë të tjerë. Kontributi i tyre ka qenë jetik për forcimin e kapaciteteve tona institucionale dhe rritjen e ndikimit të programeve tona.

Po aq i rëndësishëm ka qenë edhe bashkëpunimi me palët tona partnere, përfshirë Asociacionin e Komunave të Kosovës, koordinatorët komunalë për energji, Ministrinë e Ekonomisë, kompanitë private të angazhuara për punët konsulente, shërbyese, mbikëqyrëse dhe ndërtimore, mediat, shoqërinë civile, dhe shumë të tjerë. Përkushtimi dhe mbështetja e tyre kanë qenë thelbësore për zbatimin e suksesshëm të iniciativave tona dhe për orientimin e Kosovës drejt një të ardhmeje më efiçiente në energji.

Një falënderim i veçantë i shkon Bordit të Drejtorëve të FKEE-së, për vizionin e tyre strategjik, mbështetjen e vazhdueshme dhe angazhimin e palëkundur në drejtimin e institucionit drejt arritjeve të reja. Po ashtu, një mirënjohje e thellë i takon stafit të FKEE-së – punonjësve administrativë, arkitektëve, inxhinierëve dhe profesionistëve të tjerë, të cilët me punën dhe përkushtimin e tyre kanë mundur zbatimin e suksesshëm të projekteve dhe avancimin e politikave të efiçencës së energjisë në vend.

Duke parë përpara, FKEE mbetet e përkushtuar për të përsheptuar përpjekjet për efiçencën e energjisë, reduktimin e emetimeve të karbonit dhe sigurimin e një të ardhmeje të qëndrueshme për brezat e ardhshëm. Rezultatet që kemi arritur në vitin 2024 nuk janë thjesht arritje, por gurë themeli për një të ardhme edhe më ambicioze dhe me ndikim.

Së bashku, po formësojmë një Kosovë më efiçiente, më të qëndrueshme dhe më të fortë.

4. Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë

4.1 Misioni dhe fushëveprimi

Misioni i FKEE-së është të përmirësojë efikasitetin e energjisë dhe të reduktojë konsumin e energjisë në ndërtesa dhe objekte duke promovuar gjithashtu praktika të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin.

Fondi gjithashtu, është i përkushtuar për të avancuar eficiencën e energjisë përmes një sërë programesh dhe iniciativash duke ofruar financim dhe asistencë për projekte efikase, realizon auditime energjie për përmirësimin e ndërtesave dhe objekteve, zhvillon politika për eficiencën e energjisë, bashkëpunon ngushtë për të çuar përpara qëllimet dhe objektivat, dhe promovon qëndrueshmërinë duke reduktuar konsumin e energjisë.

4.2 Organizimi i brendshëm i FKEE-së

Organet e FKEE-së janë:



4.2.1 Bordi i Drejtorëve të FKEE

Bordi i Drejtorëve të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë shërben si organ kryesor qeverisës, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e përgjithshme të FKEE-së, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Eficiencë të Energjisë (Nr.06/L-079).

Ky Bord Bordi i Drejtorëve përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, nga të cilët pesë (5) kanë të drejtë vote. Gjatë vitit 2024 përbërja e Bordit kishte këtë përbërje:

- **Z. Enis Spahiu** Kryesues, përfaqësues nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
- **Znj. Nora Arifi** Anëtare, përfaqësuese nga Ministria e Punëve të Brendshme (Administrata Publike);
- **Z. Alban Nevzati** Anëtar, përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë;
- **Z. Afrim Prokshi** Anëtar, përfaqësues nga Asociacioni i Komunave të Kosovës;
- **Z. Driton Hetemi** Anëtar, Drejtor Menaxhues;
 - Dy (2) anëtarë të pavarur, pa të drejtë vote, të emëruar nga dy donatorët kryesorë ;
 - **Znj. Elene Imnadze** (deri në maj të 2024-tës) dhe **Z. Besart Myderrizi** nga Banka Botërore (nga qershori i 2024-tës) si dhe **Z. Alessandro Bianciardi** nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

Anëtarët e Bordit Drejtues emërohen bazuar në kriteret dhe kërkesat e përcaktuara sipas Ligjit për Eficiencë të Energjisë si dhe Rregullores për Organizimin e Brendshëm të FKEE-së.

Në përputhje me autoritetin e dhënë dhe për qëllime të vendimmarrjes, Bordi i Drejtorëve të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë ka mbajtur pesëmbëdhjetë **(15)** mbledhje gjatë vitit 2024. Në këto takime janë marrë vendime dhe aprovime të rëndësishme për zhvillimin dhe funksionimin e suksesshëm të FKEE-së, duke siguruar kështu që projektet të zbatohen me efikasitet dhe që burimet financiare të menaxhohen në mënyrë transparente dhe të qëndrueshme.

Disa nga vendimet e marra dhe aprovimet e dhëna në vitin 2024 ishin:

Ndryshimi/miratimi i rregulloreve të brendshme:

- Rregullore për Menaxhimin e Pasurive Jofinanciare të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë;
- Rregullore për Procedurat dhe Standardet e Kontabilitetit të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë;
- Rregullore për Organizimin e Brendshëm të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë;
- Rregullore për Rekrutimin, Menaxhimin dhe Kompensimin e Personelit të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë;
- Rregullore për Katalogun e Vendeve të Punës të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë;
- Parimet e Përgjithshme dhe Kodi i Etikës i Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë.

Aprovimi i buxhetit vjetor, raportit vjetor, pasqyrave vjetore financiare dhe raportit të auditorit të jashtëm

Vendimi për hapjen e Zyrës Regjionale të FKEE-së në Mitrovicë të Veriut

Miratimi për hapjen e thirrjes së dytë publike dhe krijimi i listës së pritjes për projektin “Zbatimi i masave të eficiencës së energjisë për shtëpitë individuale të banimit”

Themelimi i Komitetit të Auditimit të Brendshëm të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë

Themelimi i Komitetit të Menaxhimit të Riskut të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë

Vendimi për vendosjen e tarifës për projektet e menaxhuara nga FKEE në vlerë prej 2% të vlerës së investimit të tërësishëm në Marrëveshjet për Shërbime të Energjisë; si dhe çështje të tjera operative dhe rregullative në kuadër të përgjegjësisë së tij.

Për të gjitha aktivitetet, Bordi i Drejtorëve është mbështetur nga Drejtori Menaxhues, Menaxherja e Zyrës (sekretaria e bordit), Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme, Departamenti i Operacioneve si dhe Departamenti i Financave.

4.2.2 Drejtori Menaxhues

Drejtori Menaxhues i FKEE-së, i cili është edhe Zyrtari Kryesor Administrativ, emërohet nga Bordi i Drejtorëve dhe është përgjegjës për tërë menaxhimin dhe vendimet operacionale.

Gjatë periudhës raportuese Drejtori Menaxhues ka marrë të gjitha vendimet menaxheriale dhe operative për FKEE-në që kanë pasur të bëjnë me:

- Përfaqësimin dhe menaxhimin e punëve të FKEE-së dhe zbatimin e vendimeve e politikave të Bordit të Drejtorëve;
- Ofrimin e rekomandimeve për Bordin e Drejtorëve në lidhje me përmirësimin e operacioneve të FKEE-së dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Përgatitjen e politikës së investimeve dhe Planin tre (3) vjeçar të zhvillimit të punës;
- Përgatitjen dhe propozimin e planeve vjetore dhe planeve financiare, përfshirë nivelin e pagesave dhe ngarkesave;
- Prezantimin e të gjitha veprimeve, rregullave, urdhërave e udhëzimeve për miratim nga Bordi i Drejtorëve;
- Punësimin e personelit në përputhje me rregulloret e brendshme që kanë të bëjnë me procedurën dhe kriteret e punësimit të personelit të FKEE-së;
- Monitorimin e ecurisë së aktiviteteve të FKEE-së dhe përgatitjen e raporteve tremujore të progresit për Bordin e Drejtorëve duke demonstruar qartë nivelin e arritjes së treguesve të performancës;
- Miratimin e projekteve të cilat duhet të jenë në pajtim me kriteret e përshtatshmërisë dhe kushtet e tjera të ftesave për Shprehjen e Interesit dhe/ose Thirrjet për Propozime të FKEE-së të aprovuara paraprakisht nga Bordi i Drejtorëve;
- Kryerjen e aktiviteteve të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4.3 Departamentet e FKEE-së

Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE) operon përmes tri departamenteve, katër njësi kryesore administrative:



Drejtorët që menaxhojnë me departamentet dhe **udhëheqësit** që menaxhojnë me njësitë, organizojnë dhe mbikëqyrin aktivitetet, duke siguruar efikasitet, llogaridhënie dhe përmbushjen e objektivave strategjike të FKEE-së.

4.3.1 Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme

Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme luan një rol kyç në **menaxhimin administrativ, ligjor dhe teknologjik** të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë. Ai është përgjegjës për **përgatitjen dhe administrimin e Marrëveshjeve të Financimit**, si dhe për **ndryshimet e mundshme gjatë zbatimit të projekteve**, në koordinim të ngushtë me Departamentin e Financave dhe Departamentin e Operacioneve. Një aspekt i rëndësishëm i punës së tij është **koordinimi dhe bashkëpunimi me institucionet qeveritare dhe organizatat partnere**, duke siguruar që aktivitetet të jenë në përputhje me rregulloret dhe prioritetet strategjike të Kosovës.

Ky departament gjithashtu ofron **këshillim ligjor**, duke mbështetur departamentet e tjera në **përgatitjen e thirrjeve për propozime, ftesave dhe tenderëve**, si dhe në **procedurat e kontraktimit**. Në rast të çështjeve ligjore apo procedurave gjyqësore, ky departament përfaqëson FKEE-në dhe siguron mbrojtjen e interesave të institucionit.

Një nga funksionet kryesore të departamentit është **monitorimi i zbatimit të projekteve të mbështetura nga FKEE**, duke siguruar që të gjitha aktivitetet të jenë në përputhje me **rregullat e prokurimit publik dhe standardet ndërkombëtare**.

Për të siguruar një operim efikas dhe një administrim të qëndrueshëm, Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme është përgjegjës për **rekrutimin, organizimin dhe trajnimin e personelit**, duke promovuar një kulturë pune që mbështetet në **profesionalizëm, integritet dhe respekt për komunitetin**.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është **komunikimi dhe prezantimi publik i aktiviteteve të Fondit**. Ky Departament siguron **përditësimin dhe menaxhimin e faqes zyrtare të internetit dhe rrjeteve sociale**, duke rritur transparencën dhe informimin e publikut mbi projektet dhe iniciativat e institucionit. Po ashtu, ai **zhvillon dhe mirëmban sistemet e Teknologjisë së Informacionit (TI)**, duke përfshirë bazën e të dhënave të programeve dhe projekteve, duke lehtësuar administrimin dhe përmirësuar aksesin në informacionet kyçe. për të mundësuar një administrim më të lehtë dhe një qasje më të shpejtë në informacione të rëndësishme.

4.3.2 Departamenti i Financave

Departamenti i Financave luan një rol kyç në menaxhimin dhe mbështetjen financiare të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë. Ai është përgjegjës për përgatitjen dhe zbatimin e **planeve financiare**, analizave ekonomike dhe raporteve të detajuara, duke siguruar që veprimet financiare të jenë në përputhje me objektivat strategjike dhe rregulloret përkatëse.

Një nga funksionet kryesore të këtij departamenti është **vlerësimi ekonomik dhe financiar i thirrjeve për propozime dhe tenderëve**, duke analizuar aspektet e fizibilitetit financiar dhe ndikimin ekonomik të projekteve të propozuara. Përveç kësaj, ai kryen **analizën e rrezikut dhe vlerësimin e kredisë** për përfituesit, duke vlerësuar kapacitetin e tyre për të përmbushur detyrimet financiare dhe përshtatshmërinë e garancive financiare të paraqitura.

Departamenti i Financave bashkëpunon ngushtë me departamentet e tjera të FKEE-së, veçanërisht në aspektin e **kontraktimit dhe zbatimit të Marrëveshjeve të Financimit**. Ai gjithashtu zhvillon dhe forcon **marrëdhëniet me institucione financiare**, si brenda vendit ashtu edhe në nivel ndërkombëtar, duke identifikuar mundësi të reja financimi dhe partneritete për zgjerimin e veprimtarisë së Fondit.

Për më tepër, Departamenti i Financave është përgjegjës për **zhvillimin e instrumenteve**

financiare të FKEE-së, duke përfshirë skemat e financimit të projekteve dhe modalitetet e pagesave. Ai merret me **përpunimin e kërkesave të përfituesve për pagesa, lëshimin e urdhërpagesave** dhe garantimin e një administrimi të saktë dhe transparent të fondeve.


Nëpërmjet një menaxhimi të kujdesshëm financiar dhe analizës së rreziqeve, Departamenti i Financave **siguron qëndrueshmërinë dhe efikasitetin** e operacioneve financiare duke ndihmuar në realizimin e misionit të saj për nxitjen e **efiçencës së energjisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë**.

4.3.3 Departamenti i Operacioneve

Departamenti i Operacioneve luan një rol kyç në **hartimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e projekteve** të mbështetura nga Fondi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë. Ky departament është përgjegjës për **përgatitjen e thirrjeve për propozime dhe tenderëve**, duke i analizuar ato nga **këndvështrimi teknik, ekonomik dhe mjedisor**.

Një nga funksionet kryesore të këtij departamenti është **vlerësimi dhe selektimi i projekteve**. Ai koordinon procesin e **vlerësimit të propozimeve të pranuar**, duke analizuar **aspektin teknik, ekonomik/financiar dhe ndikimin mjedisor** të tyre. Ndërkaq, pas këtij procesi, bëhet përgatitja e **raporteve të vlerësimit**, të cilat i dorëzohen FKEE-së për përpunim të mëtejshëm dhe për marrjen e vendimeve për financim.


Në fazën e implementimit, ky Departament **monitoron dhe verifikon progresin e projekteve**, duke siguruar që ato të zbatohen në përputhje me planet fillestare dhe dispozitat e marrëveshjeve të financimit. Ai gjithashtu **identifikon dhe këshillon FKEE-në mbi devijimet e mundshme**, duke propozuar masa korrigjuese për të siguruar zbatim efikas dhe rezultate të



Përveç përgjegjësiwe operacionale, ky departament kontribuon në zhvillimin strategjik të FKEE-së. Ai përgatit inpute për planet vjetore të punës dhe raportet vjetore, si në aspektin teknik ashtu edhe financiar, duke ndihmuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucionit. Po ashtu, Departamenti i Operacioneve përfshihet në hartimin e politikave strategjike dhe planeve afatmesme të zhvillimit të FKEE-së, duke siguruar që aktivitetet dhe investimet të jenë në përputhje me prioritetet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e efiçencës së energjisë dhe qëndrueshmërisë mjedisore.

Përmes këtyre funksioneve, Departamenti i Operacioneve siguron që FKEE të zbatojë projekte me impakt të lartë, efikasitet të lartë dhe përfitime afatgjata për ekonominë dhe mjedisin e Kosovës.

4.3.4. Struktura organizative e Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë



Legjenda:



5. Aktivitetet Kryesore të FKEE-së

5.1 Burimet njerëzore

Suksesi i FKEE-së në promovimin e efijencës së energjisë dhe qëndrueshmërisë udhëhiqet nga përkushtimi dhe ekspertiza e ekipit që ka. Gjatë vitit të kaluar, FKEE është përkujdesur për të përmbushur kërkesat në rritje të projekteve të efijencës së energjisë, duke siguruar që të ofrohen rezultate të rëndësishme, por gjithashtu të krijohet një ambient ku inkurajohet inovacioni dhe puna në grup. Numri i përgjithshëm i të punësuarve deri më 31 dhjetor 2024, në FKEE ishte 26 punonjës. Personeli i FKEE-së është një ekip ekspertësh me performancë të dëshmuar në fushat e përgjegjësive që ata mbulojnë.

Në vitin 2024, FKEE ka vërejtur rritje të kërkesës për zbatim të masave të efijencës së energjisë, që ka sjellë nevojën për të zgjeruar kapitalin njerëzor. FKEE ka shtuar numrin e punonjësve me rreth 30% (ndonëse projektet janë shumëfishuar), duke angazhuar profesionistë me njohuri të specializuara në fushën e efijencës së energjisë, energjisë së ripërtëritshme dhe inxhinierisë, politikës mjedisore si dhe ekspertë në financa dhe menaxhimin e projekteve. Ky zgjerim ka lejuar që t'i shërbehet më mirë partnerëve, palëve të interesit dhe përfituesve fundorë, duke u siguruar që të ruhet ritmi për arritjen e qëllimeve afatgjata për reduktimin e konsumit të energjisë.

Fusha e efijencës së energjisë është duke ndryshuar me shpejtësi dhe ngritja e kapaciteteve në vazhdimësi është thelbësore për të mbajtur një avantazh profesional në këtë fushë. Në vitin 2024, FKEE ka investuar në programe trajnimi dhe zhvillimi, ku përfshihen certifikimi i punonjësve në auditimin e energjisë, trajnime në menaxhimin e kontratave, trajnime në praktikën e prokurimit publik, pjesëmarrje në vizita studimore me qëllim shkëmbimin e përvojave, seminare, punëtori etj. Këto iniciativa kanë përmirësuar aftësinë e ekipit të FKEE-së për t'u përballur me sfidat dhe për të siguruar që FKEE të mbetet në krye të risive në fushën e efijencës së energjisë në vend.

5.2 Diversiteti, barazia, gjithpërfshirja dhe mirëqenia

Në përputhje me vlerat e qëndrueshmërisë dhe orientimin drejt zgjidhjeve të së ardhmes, FKEE është fokusuar në krijimin e një mjedisi pune gjithpërfshirës dhe të larmishëm.

Gjatë vitit 2024, FKEE ka ndërmarrë hapa konkretë për të siguruar një proces rekrutimi të drejtë, gjithpërfshirës dhe të bazuar në meritokraci. Përmes politikave të qarta dhe mekanizmave transparentë të vlerësimit, kemi synuar të rrisim diversitetin në ekip, duke përfshirë një përfaqësim më të gjerë gjinor dhe profesional. Këto përpjekje kanë siguruar që çdo kandidat të vlerësohet mbi bazën e aftësive dhe përvojës së tij, duke ruajtur standardet më të larta të profesionalizmit. Duke promovuar një kulturë gjithpërfshirëse, FKEE garanton që perspektivat dhe përvojat e ndryshme të ekipit të kontribuojnë në zgjidhje inovative për përmirësimin e efijencës së energjisë në komunitete të ndryshme. Gjatë vitit 2024, iniciativat e FKEE-së për Diversitet, Barazi dhe Gjithpërfshirje kanë përfshirë edhe angazhimin e kujdesshëm në procesin e rekrutimit, me qëllim rritjen e diversitetit në ekip sa i përket gjinisë dhe grupeve profesionale, gjithmonë duke respektuar parimin e meritokracisë. Duke kultivuar një kulturë më gjithpërfshirëse, FKEE siguron që perspektivat dhe përvojat e ndryshme të anëtarëve të ekipit të kontribuojnë në zgjidhje inovative, duke adresuar më mirë sfidat e efijencës së energjisë në komunitete të ndryshme.

Përveç zhvillimit profesional, FKEE ka vendosur një theks të fortë mbi mirëqenien e punonjësve.

Programi i mirëqenies përfshin mbështetje për shëndetin fizik dhe mendor të stafit, duke ndihmuar në krijimin e një ambienti pune produktiv dhe pozitiv. Si pjesë e këtij programi, FKEE ofron sigurim shëndetësor për të gjithë punonjësit, duke u mundësuar atyre qasje në shërbime mjekësore cilësore dhe duke siguruar mbrojtje e kujdes shëndetësor të vazhdueshëm.

Në këtë drejtim, janë organizuar vizita dhe teste laboratorike mjekësore në Qendrën e Mjekësisë së Punës në Gjakovë për të gjithë stafin. Si rezultat, çdo punonjës është pajisur me një certifikatë mjekësore të vlefshme për tre vitet e ardhshme. Këto vizita do të jenë rutinore dhe do të përsëriten në baza të rregullta, duke siguruar monitorim të vazhdueshëm të shëndetit të stafit. Përmes kësaj përkrahje, synohet të rritet mirëqenia e punonjësve, të promovohet një ambient pune i qëndrueshëm dhe të kontribuohet në motivimin dhe produktivitetin e ekipit.

FKEE ka vazhduar të mbështesë përfaqësimin e grave në fushën e efijencës së energjisë, si brenda institucionit ashtu edhe në programet e saj për përfituesit. Brenda organizatës, FKEE siguron përfaqësim të drejtë gjinor në çdo nivel, me gratë që përfaqësohen në mbi 50% të stafit. Një qasje e tillë reflektohet edhe në skemat mbështetëse për qytetarët, ku grantet për përfituesit kanë qenë deri në 45%, duke arritur deri në 50% në rastet kur shtëpia është në bashkëpronësi ose pronësi të gruas. Institucioni do të vazhdojë të zhvillojë politika dhe programe të dedikuara për avancimin profesional të grave, duke siguruar mundësi të barabarta për zhvillim të karrierës dhe pozita drejtuese. FKEE ka vazhduar të mbështesë përfaqësimin e grave në fushën e efijencës së energjisë, duke ofruar një kulturë organizative të hapur dhe mbështetëse. Institucioni do të vazhdojë të zhvillojë politika dhe programe të dedikuara për zhvillimin e karrierës së grave, duke siguruar mundësi të barabarta për avancim profesional dhe pozita drejtuese.

Tabela 1. Përqindja e punonjësve sipas gjinisë dhe nivelit

Nivelet e pozitive	Burra	Gra
Menaxherial	50% (2)	50% (2)
Administrativ	33.3% (1)	66.6% (2)
Profesional	44.4% (4)	55.6% (5)
Ekspert	30% (3)	70% (7)
Totali i Punonjësve	38.5% (10)	61.5% (16)

5.3 Zhvillimi i Kapaciteteve dhe Strukturës Organizative të FKEE-së

Në përputhje me planet zhvillimore dhe zgjerimin e projekteve nga viti 2023 në 2024, FKEE ka rritur kapacitetet profesionale duke u mbështetur në rregulloret e brendshme dhe legjislacionin në fuqi.

Për të siguruar funksionalitet të plotë sipas strukturës organizative, është vazhduar me rekrutimin e personelit në menaxhimin e projekteve, çështjet administrative, financiare dhe menaxhimin e përgjithshëm. Në nëntor 2023, u hapën konkurset për disa pozita kyçe, duke përfshirë Zyrтарin Financiar, Zyrтарin e Kontabilitetit, Drejtorin e Shërbimeve të Përgjithshme, Drejtorin e Financave dhe Drejtorin e Operacioneve. Proceset përfunduan në fillim të vitit 2024, duke kompletuar Departamentin e Financave me katër punonjës dhe Departamentin e Operacioneve me dhjetë punonjës, përfshirë ekspertë të angazhuar përmes projekteve të ndërlidhura me BE, GIZ dhe Bankën Botërore. Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme u plotësua me një Drejtoreshë dhe një Asistent Administrativ në Mitrovicën e Veriut, duke e çuar numrin total të punonjësve në nëntë (9). Proceset rekrutuese u zhvilluan pa probleme, me transparencë të plotë dhe bazuar në parimet e meritokracisë.

Pas përfundimit të projektit “Efiçienca e Energjisë dhe Energjia e Ripërtëritshme” të financuar nga BE, Banka Botërore dhe Qeveria e Kosovës, FKEE vendosi që kontratat e punonjësve të angazhuar përmes rregullave të prokurimit të Bankës Botërore të konvertoheshin në kontrata të rregullta pune. Ky vendim u mbështet në dokumentacionin relevant të projektit, sipas marrëveshjes së ratifikuar në Kuvendin e Kosovës dhe me miratimin nga Bordi i Drejtorëve.

Gjatë vitit 2024, FKEE angazhoi tetë praktikantë nga platforma Kosovo Generation Unlimited, CSR Kosova dhe projekte të tjera, kryesisht me profil inxhinierik, të cilët kontribuan kryesisht në Departamentin e Operacioneve dhe në atë të Financave.



Bordi i Drejtorëve ndërmori një rishikim të thelluar të rregulloreve të institucionit, duke përditësuar gjashtë prej tyre dhe draftuar rregullore të reja, përfshirë rregulloren për katalogun e vendeve të punës. Kjo rregullore ka përcaktuar qartë secilën pozitë dhe përshtimet e detajuara të detyrave të punës, duke sjellë një strukturë më të qartë organizative. Për më tepër, u rishikua dhe përditësua Kodi i Etikës, duke e përshtatur atë me standardet më të larta dhe duke siguruar që praktikat profesionale dhe etike të jenë të zbatueshme për të gjithë punonjësit.

Në nëntor 2024, FKEE shpalli thirrje publike për përzgjedhjen e anëtarëve të jashtëm të Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Menaxhimit të Riskut. Përmes një procesi transparent, u emëruan tre ekspertë me mandat trevjeçar, të cilët do të mbështesin dhe mbikëqyrin njësitë përkatëse të institucionit.

5.4 Prokurimi dhe zgjerimi i konkurrencës në treg

Konkurrenca e tregut në prokurimin e punëve për zbatimin e masave të eficientës së energjisë në Kosovë ndjek një proces që është në përputhje me Ligjet në fuqi dhe praktikën më të mirë ndërkombëtare. Duke marrë parasysh fokusin e Kosovës për përmirësimin e eficientës së energjisë dhe arritjen e objektivave të sigurisë së furnizimit, siguri që proceset e prokurimit për projektet e eficientës së energjisë të jenë konkurruese është thelbësor me qëllim të ofrimit të një zgjidhjeje të levërdishme dhe të përshtatshme, si nga ana e kostos ashtu edhe nga ana e cilësisë.

Kosova ka një kornizë ligjore dhe rregullatore që rregullon prokurimin publik. Këtu përfshihet **Ligji për Prokurimin Publik** (Ligji Nr. 04/L-042) që rregullon procesin e prokurimit në Kosovë, duke siguruar transparencë, drejtësi dhe trajtim të barabartë të të gjithë furnizuesve, **Ligji për Eficientë të Energjisë** (Ligji Nr. 06/L-079), që ofron bazën ligjore për iniciativat e eficientës së energjisë, duke përcaktuar përgjegjësitë e institucioneve, ndarjen e fondeve dhe zbatimin e masave për kursimin e energjisë, si dhe **Strategjinë e Energjisë të Kosovës 2022-2031**, që thekson eficientën e energjisë si një qëllim kyç për të reduktuar konsumin e energjisë në sektorë të ndryshëm.

Konkurrenca e tregut në procesin e prokurimit të projekteve të eficientës së energjisë në Kosovë është dëshmuar të jetë thelbësore sepse ka siguruar dhe u ka mundësuar më shumë kontraktorëve të konkurrojnë dhe të përzgjidhen ata me ekspertizë të dëshmuar, me standarde të larta të cilësisë dhe me zgjidhje inovative. Kjo ka promovuar përdorimin e teknologjive më të reja të eficientës së energjisë dhe ka siguruar që projektet të jenë zbatuar në mënyrë të duhur.



Hapja e tregut ka inkurajuar kontraktorët të dorëzojnë oferta konkurruese në procese të hapura dhe transparente, çka ka ndihmuar në kontrollimin e kostove dhe cilësisë. Duke pasur parasysh që Kosova është e fokusuar në kursimin e energjisë dhe sigurinë e furnizimit, përdorimi i fondeve në mënyrë efektive është kyç për arritjen e objektivave kombëtare të energjisë.

Në të njëjtën kohë konkurrenca ka inkurajuar inovacionin, pasi kontraktorët janë motivuar të paraqesin zgjidhjet më të mira teknologjike për eficientën e energjisë. Zbatimi i tyre ka çuar në kursime afatgjata të energjisë duke përfituar si sektori publik ashtu edhe ai rezidencial, si konsumatorë fundorë.



Në përfundim, FKEE është siguruar që të zgjidhen kontraktorët të cilët ofrojnë teknologjitë dhe ekspertët e duhur, të minimizohen rreziqet dhe të maksimizohen kursimet e energjisë, duke mbështetur përfundimisht objektivat e FKEE-së për promovimin e sigurisë së furnizimit të energjisë dhe zvogëlimin e emetimeve të karbonit.

Krahasimi i të dhënave midis viteve 2023 dhe 2024 tregon një rritje të ndjeshme të konkurrencës në procedurat e prokurimit publik, veçanërisht në sektorin e punëve, dizajnit energjetik dhe mbikëqyrjes. Të gjitha prokurimet kanë qenë të hapura dhe transparente, duke mundësuar pjesëmarrjen e një numri më të madh operatorësh ekonomikë. Si rezultat, tregu është zgjeruar ndjeshëm, duke angazhuar më shumë kompani dhe duke përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e projekteve të realizuara.



- **Procedurat e tenderimit të punëve ndërtimore** kanë shënuar një rritje të madhe të vlerës së ndarë për kontrata me **170.6%**, nga 2,555,757.8 € në 6,916,000.00 €. Numri i ofertave të pranura është rritur ndjeshëm me **660%**, nga 5 në 38 ofertues, ndërsa numri i kontratave të shpërblyera është rritur me **166.7%**, nga 3 në 8.



- **Procedurat e shërbimeve** kanë pasur një rënie të vlerës së ndarë me **60.6%**, nga 1,051,412.00 € në 414,399.00 €, por numri i ofertave të pranuar është rritur me **55.6%**, nga 36 në 56 ofertues. Ndërkohë, numri i kontratave të shpërblyera ka pësuar një rënie të vogël prej **5.3%**, nga 19 në 18.



- **Procedurat e furnizimeve** kanë parë një rritje të vlerës së ndarë me **48%**, nga 68,800.00 € në 101,807.00 €. Numri i ofertave të pranuar është rritur me **41.7%**, nga 12 në 17 ofertues, ndërsa numri i kontratave të shpërblyera është rritur me **125%**, nga 4 në 9.



Nga këto të dhëna, është e qartë se praktikat e ndjekura në vitin 2024 kanë ndikuar pozitivisht në zgjerimin e konkurrencës në prokurimin publik. Procedura e hapur ka mundësuar pjesëmarrje më të gjerë të operatorëve ekonomikë, duke rritur ndjeshëm numrin e ofertuesve në të gjitha kategoritë. Kriteri i çmimit më të ulët ka nxitur më shumë konkurrencë mes operatorëve, duke sjellë oferta më të favorshme për institucionet publike. Po ashtu, ndarja e kontratave në lote ka luajtur një rol të rëndësishëm në përfshirjen e një numri më të madh operatorësh, duke krijuar një treg më të hapur dhe të diversifikuar.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se viti 2024 për FKEE-në ka sjellë një përmirësim të ndjeshëm në konkurrencën e prokurimeve publike, duke i dhënë mundësi më shumë operatorëve ekonomikë të marrin pjesë dhe duke siguruar një përdorim më efikas të fondeve publike.

5.5 Aktivitetet Ligjore të FKEE-së

Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë është siguruar që të jetë në përputhje me kornizën ligjore, standardet etike dhe praktikat e menaxhimit të rrezikut. Gjatë vitit 2024, Zyra Ligjore ka ofruar udhëzime të specializuara, duke parandaluar dhe zbutur rreziqet që mund të ndikojnë në operacionet e FKEE-së.

Qëllimi kryesor i punës së FKEE-së është respektimi i të gjitha ligjeve dhe rregullorve të aplikueshme. Gjatë vitit 2024, Zyra Ligjore ka monitoruar dhe siguruar që të gjitha aktivitetet të zhvillohen në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës dhe direktivat Evropiane që lidhen me eficiencën e energjisë, mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin financiar.

Gjatë vitit 2024, FKEE ka hartuar një sërë aktesh të brendshme legjislative me qëllim rritjen e efektivitetit dhe përputhshmërinë me kornizën ligjore në fuqi. Ky proces është udhëhequr nga eksperti ligjor i ofruar nga Shoqata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit) (GIZ) i cili ka siguruar asistencë profesionale dhe ka kontribuar në hartimin e rregulloreve të brendshme për të forcuar funksionimin e institucionit. Në këtë kuadër, janë zhvilluar takime dhe konsultime të vazhdueshme me stafin e FKEE-së për të siguruar që aktet e hartuara për miratim të reflektojnë nevojat dhe objektivat strategjike të institucionit, duke përmirësuar transparencën dhe eficiencën në menaxhimin e fondeve dhe projekteve.

5.6 Hartimi dhe implementimi i kontratave dhe marrëveshjeve

Gjatë kësaj periudhe raportimi, FKEE ka trajtuar një sërë kontratash të rëndësishme për operacionet e saj. Janë rishikuar dhe hartuar me kujdes marrëveshjet me zhvilluesit e projekteve, duke marrë parasysh nga perspektiva financiare, operative dhe ligjore, si dhe me përfituesit e projekteve dhe palët e tjera të interesit.

Kjo ka përfshirë përpilimin ligjor, financiar dhe operativ të Marrëveshjeve të Shërbimit të Energjisë (MShE), Marrëveshjeve të Financimit, Marrëveshjeve të Bashkëfinancimit, Marrëveshjeve të Partneritetit dhe Memorandumet e Mirëkuptimit (MeM) ndërmjet FKEE-së dhe palëve të treta. Gjithashtu, është bërë rishikimi i marrëveshjeve të shpërndarjes së fondeve të subvencionuara, duke përfshirë detyrimet e përfituesve.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe komunat përfituese nga projektet e Eficiencës së Energjisë, është inicuar procesi i nënshkrimit të marrëveshjeve për kalimin e pronësisë së pasurive (aseteve) të investuara përmes projektit "Zbatimi i Masave të Eficiencës së Energjisë" në objektet publike në pronësi të komunave. Ky proces përfshin 85 projektet e finalizuara nga FKEE, ndërsa marrëveshjet pritet të finalizohen me të gjitha komunat gjatë vitit 2025.

5.7 Menaxhimi i rrezikut dhe mbështetja ligjore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

Fondi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë (FKEE) ka ndjekur një qasje proaktive për të menaxhuar dhe lehtësuar rreziqet ligjore, operative dhe financiare, duke zbatuar korniza dhe strategji të fuqishme në të gjitha nivelet e operacioneve të tij.

Nga aspekti ligjor, FKEE është siguruar që të veprojë në përputhje të plotë me rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare, duke bashkëpunuar me ekspertë ligjorë për të siguruar harmonizimin me ndryshimet e vazhdueshme ligjore.

Nga aspekti operativ, FKEE ka kryer monitorim të detajuar dhe të vazhdueshëm të performancës, duke identifikuar dhe adresuar çdo pasiguri apo problem që ka lindur gjatë zbatimit të projekteve në terren.

Duke parashikuar sfidat e mundshme, FKEE ka siguruar rezultate të qëndrueshme dhe minimizim rreziqesh për të mbrojtur si përfituesit ashtu edhe investitorët e tij. Gjithashtu gjatë vitit 2024, FKEE ka qenë proaktive në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, pavarësisht nëse janë adresuar konflikte me kontraktorët, zhvilluesit e projekteve, ose përfituesit.

Zyra Ligjore ka ofruar mbështetje ligjore për të siguruar që mosmarrëveshjet të menaxhohen në mënyrë efektive dhe në përputhje me ligjin. Kjo ka përfshirë konsultat e ndryshme kur ka qenë e nevojshme si dhe përfaqësimin e FKEE-së në proceset formale të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

5.8 Përmbledhje e përgjithshme mbi rastet gjyqësore

FKEE ka numër të vogël të mosmarrëveshjeve ligjore të cilat kanë kërkuar procedura të formalizuara në gjykatë, por sidoqoftë, FKEE ka ndërmarrë hapa konkretë për të mbrojtur interesat e institucionit dhe ka qenë e përgatitur për të mbikëqyrur dhe menaxhuar çdo veprim ligjor, që është shfaqur për të siguruar që operacionet e FKEE-së të mos preken negativisht.

Tabela 2. Rastet e FKEE-së në proces gjyqësor:

Lloji i çështjes	Numri i rasteve	Statusi aktual	Aktive	Pasive
Kontest civil	3	Të hapura	1	2

Njëra nga sfidat kryesore gjatë vitit të kaluar ka qenë vonesa në trajtimin e lëndëve nga gjykatat. Këto vonesa kanë krijuar pasiguri ligjore dhe kanë shtyrë zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme. Për të adresuar këtë problematikë, janë intensifikuar përpjekjet për komunikim të vazhdueshëm me organet gjyqësore, si dhe janë shqyrtuar alternativa për përshejtimin e proceseve.

Pavarësisht këtyre sfidave, institucioni mbetet i përkushtuar për të garantuar mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të palëve të përfshira

5.9 Procesi i kthimit të investimeve

Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE), me mbështetjen e vazhdueshme të Zyrës Ekzekutive, Zyrës Ligjore, Departamentit të Financave dhe Departamentit të Operacioneve, ka qenë i angazhuar në procesin e kthimit të investimeve nga komunat përfituese të projekteve për zbatimin e masave të eficiencës së energjisë. Ky proces, i cili tani udhëhiqet nga Departamenti i Financave të FKEE-së, ka për qëllim sigurimin e zbatimit të kushteve financiare të marrëveshjeve me komunat.

Si sfidë në këtë proces, nga viti 2023 ishte identifikuar mungesa e një baze të të dhënave e cila përmbante të gjitha detajet lidhur me obligimet e komunave sipas kushteve kontraktuale, bazë e të dhënave e cila është krijuar në vitin 2024 dhe ka ndihmuar që procesi i kthimit të jetë në nivel dukshëm më të mirë.

5.10 Mbrojtja e të dhënave

Me rritjen e sasisë së të dhënave personale dhe të ndjeshme që janë mbledhur përgjatë zbatimit të projekteve të ndryshme për zbatimin të masave të Eficiencës së Energjisë, FKEE ka siguruar që të gjitha aktivitetet të jenë kryer në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Janë ofruar udhëzime mbi trajtimin e sigurt të të dhënave dhe FKEE është siguruar që të ruajë standardet më të larta në lidhje me mbrojtjen e privatësisë për të gjitha palët e interesit.

Gjatë vitit 2024, është luajtur një rol kyç në garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale brenda institucionit, duke siguruar përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi. Në këtë drejtim, janë ofruar udhëzime për trajtimin e të dhënave dhe si dhe këshillime juridike për stafin lidhur me praktikën e duhura të mbrojtjes së të dhënave dhe informacionit. Gjithashtu, ka pasur bashkëpunim të ngushtë midis njësive përkatëse për të adresuar dhe minimizuar rreziqet e mundshme të shkeljeve të privatësisë, duke ndërmarrë masa parandaluese dhe duke trajtuar ankesat e qytetarëve në përputhje me ligjin. Përmes këtyre veprimeve, është forcuar siguria dhe besueshmëria e institucionit në menaxhimin e të dhënave personale.

6. Aktivitetet në Fushën e Efiçencës së Energjisë

6.1 Projektet e zbatuara në sektorin publik



Fondi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë ka filluar aktivitetet e tij në sektorin publik, bazuar në Ligjin për Efiçencë të Energjisë. Në vitin 2020, janë hapur dy thirrje publike, përmes të cilave u nënshkruan 150 marrëveshje për inicimin e projekteve në 24 komuna, sipas parimit “kush vjen i pari, shërbehet i pari”.

Nga këto projekte, 30 janë larguar për arsye të ndryshme, si vjetërsia e ndërtesave, konstruksioni i dobët ose mungesa e fizibilitetit të investimit ku si rezultat mbeten 120 ndërtesa për trajtim. Deri në fund të vitit 2023, në 83 prej tyre janë përfunduar masat e efiçencës së energjisë, në 2 tjera janë afruar përfundimet e punimeve dhe në 1 tjetër punimet kanë arritur në 60%.

Pjesa e mbetur e projekteve është trajtuar gjatë periudhës raportuese 2024, ku 3 projekte kanë qenë në proces të zbatimit, ndërsa për 34 projektet e mbetura është realizuar auditimi i detajuar energjetik dhe janë përgatitur dizajnet e detajuara për zbatim, me ndihmën e Bankës Botërore.

Masat e Efiçencës, të cilat janë zbatuar, kryesisht janë, por nuk kufizohen në:

- Termoizolimi i mureve të jashtme;
- Termoizolimi i çatisë;
- Ndërrimi i dritareve dhe dyerve të jashtme;
- Ndërrimi i trupave ndriçues nga ata jo efiçient në ata LED;
- Rregullimi dhe automatizimi i sistemit të ngrohjes;
- Instalimi i kaldajave me pelet ose në pak raste pompë termike;
- Kolektorë solarë për ngrohjen e ujit sanitar;
- Panelet fotovoltaike;
- Masa jo EE që ndihmojnë EE.

Këto projekte janë zbatuar përmes skemës kthyesë, ku komunat do të kthejnë investimin brenda një periudhe jo më të gjatë se 15 vjet bazuar në kursimet e arritura nga këto investime.

Duke qenë se procesi i trajtimit dhe zbatimit të masave të efiçencës së energjisë përfshin disa faza, nga auditimi i detajuar energjetik, përgatitja e dizajneve, tenderimi, zbatimi i masave, mbikëqyrja e fazës së defekteve dhe deri te matja dhe verifikimi i kursimeve, ky raport do të përshkruajë aktivitetet e zhvilluara gjatë periudhës së raportimit për secilën fazë.

6.1.1 Projektet në Proces të Zbatimit të Masave të Efiçencës së Energjisë

Gjatë kësaj faze, në proces të zbatimit të masave të efiçencës së energjisë kanë qenë tre projekte.

Tabela 3. Projektet e përmbyllura gjatë vitit 2024

Nr.	Emri i institucionit	Komuna	Data e fillimit të projektit	Data e përfundimit të projektit	Vlera totale e investimit €	Progresi
1	Qendra e kulturës	Mitovicë	Mars 2023	Qershor 2024	690,614.50 €	100%
2	Pallati i Kulturës "Asim Vokshi"	Gjakovë	Janar 2024	Dhjetor 2024	472,815.64 €	63.23%
3	SH.F.M.U "Mazllum Këpuska"	Gjakovë	Janar 2024	Dhjetor 2024	288,460.54 €	100%
Total					1,451,890.68 €	


Projekti i Qendrës së Kulturës në Mitrovicë është bartur nga viti 2023. Për shkak të mungesës së qasjes në disa pjesë të ndërtesës dhe kompleksitetit të ndërtesës, ka pasur vonesa në zbatimin e masave të efiçencës. Pas shumë takimeve të përbashkëta me të gjitha palët e përfshira, janë shqyrtuar dhe aprovuar disa zgjidhje teknike alternative dhe lirim të hapësirave, të cilat kanë rezultuar me përfundim të suksesshëm të projektit.

Projektet në komunën e Gjakovës kanë hasur në progres të ngadalshëm dhe sfida në menaxhimin e tyre që nga fillimi, kryesisht për shkak të ritmit të ulët të punimeve nga ana e operatorit ekonomik. Pavarësisht përpjekjeve të shumta të FKEE-së për të zgjidhur situatën në mënyrë miqësore, duke ri-përcaktuar objektivat dhe ofruar asistencë në zgjidhjet teknike alternative, shqiptimi i penaliteteve sipas kushteve kontraktuale ishte i pashmangshëm si rezultat i mosarritjes së objektivave. Megjithatë, pavarësisht të gjitha përpjekjeve, kontrata ka përfunduar në mënyrë të pasuksesshme, pasi operatori ekonomik ka dështuar të përfundojë punimet sipas dinamikës dhe afatit të përcaktuar kontraktual në Pallatin e Kulturës "Asim Vokshi".

Suksesi i arritur në kuadër të kësaj kontrate është se ka arritur të përfundojë zbatimin e masave në shkollën "Mazllum Këpuska", si rezultat i këshillave të dhëna nga FKEE dhe kompania mbikëqyrëse për riorganizimin e punëve. Vlera e penaliteteve të shqiptuara për mos arritjen e objektivave dhe tërheqja e garancionit bankar për mosarritjen e përmbylljes së suksesshme të kontratës, do të përdoren për të mbuluar kostot financiare për pjesën e mbetur të punëve

6.1.2 Projektet në fazën e garancionit

Me përfundimin e zbatimit të masave të efijencës së energjisë të 42 projekteve (grafiku 1) deri në fund të vitit 2023, në vitin 2024 ka filluar faza e garancionit për këto projekte. Gjatë kësaj faze, ndërtesat janë kontrolluar çdo tre muaj për të vlerësuar nëse masat e zbatuara ishin funksionale apo kanë pësuar ndonjë defekt. Në raste specifike, janë realizuar vizita më të shpeshta për të siguruar që çdo devijim ose dëmtim të identifikohet dhe të rregullohet në kohë. Pas periudhës 12 mujore të garancionit për këto ndërtesa është bërë pranimit teknik final i tyre, duke u siguruar kështu që me mirëmbajtje të mëtutjeshme masat e efijencës së energjisë do të japin rezultatet e planifikuara të kursimeve.



Grafiku 1. Shpërndarja e projekteve

Gjatë fazës së garancionit nuk është paraqitur ndonjë problem i pamëshueshëm. Kryesisht, problemet e evidentuara kanë qenë për ndonjë rrjedhje të vogël të kulmit për shkak të ndonjë tjegulle të thyer, dëmtimi fizik i ndonjë dërr dhe/ose dritare, bllokimi i ulluqeve, apo të ngjashme, përderisa të gjitha këto janë rregulluar dhe menaxhuar para pranimit teknik final. Duhet theksuar se një pjesë e dëmeve të evidentuara kanë qenë si pasojë e mosmirëmbajtjes dhe/ose dëmtimeve nga palët e treta.

Për këto projekte është bërë edhe verifikimi i masave nga kompania verifikuese, ku qëllimi i këtij procesi ishte që të ketë një kontroll nga një palë e tretë nga ato të zbatimit dhe mbikëqyrjes, ku është konstatuar që zbatimi i projekteve ka devijime minore, dhe rekomandimet kryesore për përmirësim janë:

- Rregullimi dhe mirëmbajtja e mekanizmave të dritareve dhe dyerve;
- Tolerancë në kapacitet të instaluar të ngrohjes për arsye se devijimi sado i vogël i ndonjë mase, ka ndikim direkt në sistemin e ngrohjes;
- Kontrollimi i çdo xhami për t'u siguruar që janë vendosur shtresat përkatëse;
- Pastrim dhe mirëmbajtje e masave jo-EE në mënyrë që të mbrohen masat EE.


Bazuar në të dhënat e prezantuara, përgatiten dhe përpunohen protokollet e mirëmbajtjes së masave dhe dorëzohen tek komunat me përfundimin e projektit, me qëllim të rritjes së jetëgjatësisë së masave të efijencës së energjisë (EE). Si rezultat, FKEE ka përditësuar termat e referencës për kompanitë mbikëqyrëse, duke përfshirë detyrimin e tyre për të kontrolluar dhe verifikuar planin e mirëmbajtjes, i cili duhet të hartohet nga kompania zbatuese.

Bazuar në raportet e fazës së garancionit dhe ato të matjes dhe verifikimit të masave përmes pajisjeve të testimit, janë rregulluar edhe termat e referencës për punëkryesit, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë dhe duke shtuar detyrimin e operatorëve ekonomikë për mirëmbajtjen gjatë fazës së defekteve. Gjithashtu, është përfshirë trajnimi i personelit të ndërtesës për mirëmbajtje, në mënyrë që gjatë pranimit teknik të shmangen problemet eventuale të shkaktuara nga faktorët e mirëmbajtjes.

6.1.3 Projektet në fazën e dizajnit të masave të Efiçencës së Energjisë

Në fazën e dizajnit të masave, janë përfshirë projektet e fundit të iniciuara nga marrëveshjet ndërmjet FKEE-së dhe komunave, të nënshkruara në vitin 2020. Konkretisht, për 34 projekte të shpërndara në 12 komuna (grafiku 2) janë realizuar auditimet detale energjetike, dizajnet detale të masave të efiçencës së energjisë (EE) dhe raportet e seizmikës.

Parashikimi financiar total për implementimin e këtyre masave është rreth 7.3 milionë euro, ndërsa pritet të arrihet një kursim prej 60-70% të energjisë së shpenzuar në vit.



Grafiku 2. Shpërndarja e projekteve nëpër komuna për të cilat janë dizajnuar masat e efiçencës së energjisë


6.1.4 Projekte në proces të tenderimit dhe fillimit të zbatimit të masave të efiçencës së energjisë

Nga 34 projektet për të cilat janë dizajnuar masat e efiçencës së energjisë (EE), financimi është planifikuar të mbulohet nga një grant prej 2.7 milionë euro nga Bashkimi Evropian, i monitoruar nga Banka Botërore, rreth 3 milionë euro nga Qeveria e Kosovës, dhe pjesa tjetër nga kthimet e investimeve nga projektet e përfunduara përmes skemës së kthimit.


Megjithatë, për shkak të masave të Bashkimit Evropian ndaj Kosovës, granti nga BE-ja është ende në pritje. Për këtë arsye, për 17 projekte janë iniciuar procedurat e tenderimit për kompani mbikëqyrëse dhe zbatuese, duke u financuar nga fondet e Qeverisë së Kosovës dhe pjesërisht nga kthimet e investimeve të projekteve të përfunduara përmes skemës kthyes.

Përzgjedhja e projekteve për fillimin e investimeve është bërë bazuar në kohën e aplikimit, sipas parimit të thirrjes publike “kush vjen i pari, shërbehet i pari”. Pas përfundimit të procedurave të tenderimit, ku për 17 projektet kryesisht nuk ka pasur vonesa të theksuara, janë nënshkruar marrëveshjet për shërbimet e energjisë, si dhe kontratat me kompanitë mbikëqyrëse dhe zbatuese.

Zbatimi i masave të efiçencës së energjisë pritet të përfundojë gjatë vitit 2025. Vlera totale për këto 17 projekte është rreth 3.8 milionë euro, të shpërndara në katër lote dhe gjashtë komuna.




Grafiku 3. Shpërndarja e projekteve nëpër komuna për të cilat ka filluar faza e zbatimit të masave të efijencës së energjisë




Grafiku 4. Shpërndarja e vlerës së investimit në komuna

Pas përfundimit të zbatimit të masave të efijencës së energjisë, bazuar në kalkulime, pritet të kursehen rreth 5,416 MWh/vit (grafiku 5) dhe reduktim të emetimit të CO2 rreth 522 ton/vit (grafiku 6).



Grafiku 5 - Shpërndarja e vlerës së kursimit në MWh/vit në komuna



Grafiku 6 – Reduktimi i emetimit të gazrave serrë (CO₂) Ton/Vit në komuna

6.1.5 Studimi i fizibilitetit dhe aplikimi i masave EE në ndërtesa publike në Kosovë

Studimi i fizibilitetit për aplikimin e masave rinovuese EE në ndërtesat publike në Kosovë është duke u mbështetur nga Qeveria e Kosovës, Qeveria e Danimarkës, si dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Ky studim ka për qëllim që fillimisht ta krijojë bazën e të dhënave të të gjitha ndërtesave publike të nivelit lokal dhe qendror, në mënyrë që të përzgjidhen për investim ndërtesat me potencialin më të madh të kursimit të energjisë. Baza e të dhënave është krijuar në bashkëpunim në mes të kompanisë konsulente të kontraktuar nga BERZH, FKEE-së, zyrtarëve komunalë dhe atyre qendrorë. Nga të dhënat e deritanishme janë evidentuar rreth 1400 ndërtesa në nivelin lokal dhe rreth 900 ndërtesa në nivelin qendror. Bazuar në rezultatet finale të këtij studimi, FKEE bazuar në marrëveshjen me BERZH do të fillojë zbatimin e këtij projekti, si më i madhi ndonjëherë për eficiencën e energjisë në ndërtesa publike në Republikën e Kosovës, me një vlerë totale prej rreth **86 milionë euro**, që do të përfshijë rinovimin e deri **400 ndërtesave publike** të nivelit qendror dhe lokal, duke synuar në:

- Reduktimin e konsumit të energjisë;
- Kursime financiare të ndjeshme;
- Zvogëlimin e emetimeve të gazrave serrë;
- Përmirësimin e kushteve për punonjësit e administratës publike dhe cilësisë së shërbimeve publike për qytetarët.

Ky projekt financohet me 50 milionë euro kredi nga BERZH përmes Qeverisë së Republikës së Kosovës, 12 milionë euro bashkëfinancim nga Qeveria e Republikës së Kosovës, 20 milionë euro grante nga donatorë si Bashkimi Evropian dhe Fondi Danez për Kosovën dhe 3.4 milionë euro grant për asistencë teknike, njësi implementuese dhe studime fizibiliteti.

6.1.6 Projektet në proces për qëndrueshmërinë klimatike në sektorin e ujit në Kosovë

FKEE, parashihet të përfshihet në kuadër të projektit **“Climate resilience in water sector of Kosovo”**, si pjesë e marrëveshjes në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Qeverisë së Konfederatës së Zvicrës, përfaqësuar nga State Secretariat for Economic Affairs (SECO), nënshkruar në vitin 2023. Ky projekt ka në fokus, investimet e drejtpërdrejta në kompanitë rajonale të ujësjellësit, duke rritur eficiencën në shpërndarjen e ujit të pijshëm, eficiencën energjetike, si dhe rritjen e kapaciteteve të burimeve të ripërtëritëshme të energjisë. Bazuar në hapat fillestarë të këtij projekti, FKEE

do të jetë e përfshirë në kuadër të njësisë zbatuese të projektit, duke u fokusuar në eficientë energjetike të ndërtesave përmes masave rinovuese. Projekti parasheh të zhvillohet në dy faza, ku faza I parashihet të fillojë gjatë vitit 2025 dhe të mbarojë në vitin 2026 dhe faza II të fillojë në 2027 dhe mbarojë në vitin 2029.

Gjatë vitit 2024, FKEE ishte aktive gjatë takimeve të organizuara nga SECO, ku pjesëmarrëse ishte e përfshirë edhe Ministria e Ekonomisë. FKEE, aktualisht përfaqësohet nga dy përfaqësues në takimet formale dhe ato jo formale, duke koordinuar hapat për zhvillimin e këtij projekti.

6.2 Donacionet

FKEE ka bërë donacion për Klinikën Pediatrike në kuadër të QKUK-së dhe ndërtesën e Handikos në Ferizaj me qëllim të ndikimit të drejtpërdrejtë në përmirësimin e kushteve në hapësirat e këtyre ndërtesave përmes pajisjeve eficiente. Donacionet e FKEE-së bëhen nga mjetet e gjeneruara nga interesi i afatizimit të mjeteve në sektorin financiar, të cilat u dedikohen kategorive të cënueshme. Deri më tani kanë qenë dy projekte të implementuara sipas përshkrimeve të mëposhtme:

- Pas identifikimit të nevojës për njësi ngrohëse/ftohëse për hapësirat e dhomave të pacientëve në **Klinikën e Pediatrisë**, në kuadër të QKUK-së, FKEE ka ofruar donacion me furnizim dhe instalim të klimave eficiente (inverter), për të rritur komoditetin e fëmijëve dhe stafit mjekësor në dhomat klinikës. Ky donacion arrin shumë prej rreth **10,000 Euro**, përmes së cilës janë instaluar **20 klima eficiente** (inverter).
- Pas komunikimit dhe identifikimit të nevojës për mbështetje financiare ndaj shoqatës **Handikos në Ferizaj**, për ndërtimin e ndërtesës së re, FKEE ka ofruar ekspertizën inxhinierike dhe donacionin prej rreth **55,000 Euro** për furnizimin dhe instalimin e **sistemit eficient të ftohjes dhe ngrohjes** (vrf), duke përfshirë pompën termike me rrjetin respektiv.



6.3 Projektet e zbatuara në sektorin e banimit (rezidencial)

FKEE edhe gjatë vitit 2024 ka vazhduar me zbatimin e masës 3 të pakos së emergjencës shtetërore - pjesë e Planit të Veprimit të miratuar me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 29/112 dhe 03/128, bazuar në Marrëveshjen Financiare IPA III, të nënshkruar më 24 shkurt 2023 ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Komisionit Evropian.

Masa 3, e ndarë në dy komponentë - indikatorë: 1) kursimet e energjisë në shtëpitë individuale dhe 2) kursimet e energjisë në ndërtesat shumë-banesore sociale në pronësi të komunave, me buxhetin e dedikuar në dy masa secila nga 10 milionë euro, kanë pasur dinamika të ndryshme (Tabela 2).

Caku i këtyre masave emergjente ishte ulja e konsumit të energjisë, si rezultat i humbjeve të mëdha termike në ndërtesat ekzistuese të banimit individual dhe atyre shumëbanesore sociale. Ulja e humbjeve termike kishte në fokus ndërhyrjet e drejtpërdrejta përmes masave izoluese dhe të pajisjeve eficiente respektive, të cilat do të arrinin rezultate të menjëhershme në uljen e konsumit të energjisë për ngrohje.

Tabela 4. Granti i ndarë në kuadër të IPA III/ Masa 3

Masa 3 e Paketës emergjente të BE		
Buxheti (Total) [€]	20,000,000 (granti nga BE) + ~168,000 (interesi bankar nga mjetet e deponuara)	
Komponenta	Buxheti i planifikuar [€]	Buxheti i shpenzuar (deri në fund të vitit 2024) [€]
I. Shtëpitë individuale (Të dy thirrjet publike dhe listat e pritjes)	~12,968,000	8,007,844.16 ¹
II. Ndërtesat sociale shumë-banesore	~7,200,000	386,796.62

¹ Vlera e disbursimeve është rreth 7,8 mil derisa pjesa tjetër janë shërbime.

6.3.1 Zbatimi i masave EE në Sektorin Rezidencial në shtëpitë individuale

Pas thirrjes së parë publike, që me miratimin e Bordit u publikua më 8 gusht 2023, me afat deri më 25 shtator 2023 me mundësi të mbylljes së parakohëshme në rast të shpenzimit të buxhetit, FKEE gjatë vitit 2024 trajtoi kërkesat për subvencionim dhe disbursim, proces ky i pasuar nga faza e aplikimit të masave EE në shtëpitë e aplikuesve që posedonin para-aprovimet.



Si rrjedhojë e para-aprovimit të 2148 rasteve nga 3321 sa kanë aplikuar në thirrjen e parë e cila është mbyllur për 13 ditë. Kjo thirrje nuk ka qëndru e hapur deri më 25 shtator pasi që është shpenzuar buxheti. Ndërkaq, është krijuar lista e pritjes me 1010 aplikime për rastet pa raporte të auditimit të thjeshtëzuar të energjisë të cilat sipas thirrjes do të trajtoheshin pas përfundimit të disbursimit të rasteve nga thirrja e parë, nëse do të mbeteshin fonde.

Për thirrjen e parë, aktiviteti më i madh është zhvilluar gjatë periudhës janar-korrik 2024, ku afati përfundimtar i aplikimit për disbursim u caktua zyrtarisht të jetë 31 korrik 2024.


Gjatë kësaj periudhe numri i aplikuesve për disbursim arriti në 1813 nga 2148 aplikime të para-aprovuara (84%), kurse 33 raste janë refuzuar meqë nuk kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në thirrjen publike për zbatimin e masave EE. Nga 1813 kërkesa për disbursim të përfituesve nga thirrja e parë, 1778 janë disbursuar në vitin 2024 duke arritur vlerën prej rreth 6.3 milion €. Të dhënat e përmbledhura janë dhënë në tabelën 6.

Tabela 5. Zbatimi i masave EE në sektorin e banimit, thirrja e parë

Masa 3 Zbatimi i masave EE në Sektorin Rezidencial	
I. Shtëpitë Individuale - Thirrja 1	
Aplikacionet e pranuar	3321
Para-aprovimet e lëshuara	2148
Aplikacionet e pranuar për disbursim	1813
Numri i rasteve të disbursuara	1778
Aplikacionet e refuzuara për disbursim	33
Shuma e disbursuar	6,344,854.53 €
Numri i aplikuesve në listën e pritjes	1010 ²
Lista e pritjes të para-aprovuar	139
Vlera monetare për para-aprovimet e lëshuara	543,603.44 €
Numri i rasteve të disbursuara nga Lista e Pritjes	16
Shuma e disbursuar - lista e pritjes	51,177.91


² Nga 1010 sa ishin në listën e pritjes, vetëm 250 kanë shprehur interesim të vazhdojnë më procedurë.

Shpërndarja gjeografike e përfitimeve në kuadër të thirrjes së parë ishte pothuajse në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës (Grafiku 7).



Grafiku 7. Përfituesit e thirrjes së parë sipas komunave - thirrja e parë

Lista e pritjes nga thirrja e parë është në proces trajtimi, andaj janë paraqitur në grafikun vijues rastet e para-aprovuara sipas komunave (Grafiku 8)



Grafiku 8. Para aprovimet sipas komunave - thirrja e parë - lista e pritjes

Sa i përket gjithpërfshirjes në aspektin gjinor për nga pronësia dhe në aspektin etnik, aplikimi i tyre në thirrjen e parë ishte në numër të vogël (Tabela 7).

Tabela 6. Të dhënat për përfituesit e thirrjes së parë të ndarë sipas pronësisë (aspekti gjinor) dhe komunitetet joshumicë.

	Numri i përfituesve	Shuma e disbursuar [€]
Total	1788	6,344,854.53
Gratë pronare/ bashkëpronare	48	183,598.17
Burra	1740	6,161,256.36

Nga komunitetet joshumicë, kanë qenë rreth 11 përfitues në thirrjen e parë me vlerën monetare të disbursimit prej 53,351.20 €.

Bazuar në shpenzimet nga disbursimet e thirrjes së parë, FKEE me pajtim të Komitetit Drejtues të Projektit dhe Bordin e Drejtorëve, shpall thirrjen e dytë, në kuadër të së cilës u bë thirrje për shprehjen e interesimit edhe për listën e pritjes nga thirrja e parë, ku nga 1010 aplikime sa ishin në listë, 250 aplikues iu përgjigjen pozitivisht kërkesës dhe prej tyre vetëm 139 i plotësuan kushtet për t'i dërguar para-aprovimet.

Marrë parasysh sfidat në Thirrjen e Parë dhe me rekrutimin e stafit të ri, FKEE bëri avancim në organizimin e thirrjes së dytë e cila u shpall me 27.08.2024 me vlerën në dispozicion prej 5 milionë euro. Ndryshimet e aplikuar në thirrjen e dytë, të cilat ndikuan pozitivisht në dinamikën dhe cilësinë e procesit, ishin:

- Digjitalizimi i vulosjes së paraprovimeve dhe dërgimi i tyre në formë elektronike. Përmes vulës digjitale u eliminua nevoja për shtypjen e numrit të madh të dokumenteve dhe vulosjes klasike duke kursyer sasi të mëdha materiali si dhe kursim të kohës së stafit dhe qytetarëve.
- Digjitalizimi i dërgimit të kërkesave për disbursim. Përmes krijimit të platformës digjitale për aplikim për disbursim u minimizua koha për kompletimin dhe mirëmbajtjen e dokumentacionit.
- Mundësimi i përfshirjes së qytetarëve nga komunat veriore. Me një koordinim të mirë dhe bashkëpunim me operatorët zyrtarë për distribuim të energjisë elektrike, u bë e mundshme që të identifikoheshin në formë digjitale, konsumatorët e komunave veriore dhe të mundësohej aplikimi online.
- Mundësimi i dërgesës së kontratave përmes shërbimit postar. Përmes një memorandumit bashkëpunimi me Postën e Kosovës, u mundësua që nënshkrimi i kontratave të bëhet edhe në shtëpitë e përfituesve duke kursyer kohë dhe kosto për ta dhe për stafin e FKEE-së.

Thirrja e planifikuar të jetë e hapur për 14 ditë, u mbyll brenda tri ditësh, si rezultat i interesimit të madh të qytetarëve dhe rezervimit të shpejtë të mjeteve të dedikuara për subvencionim, të cilat ishin të kufizuara në 5 milionë euro. Ky interesim erdhi si rezultat i fushatës së informimit për qytetarët, përmes medimeve të ndryshme për thirrjen e dytë, si dhe suksesit të madh të thirrjes së parë.

Pas mbylljes së thirrjes, një numër i qytetarëve, të cilët tashmë kishin angazhuar auditorët energjetik, kishin në dispozicion raportet e përfunduara të auditimit dhe që mbetën pa aplikuar, FKEE me dakordim të Bordit të Drejtorëve, dha mundësinë për aplikim edhe për 24 orë shtesë përmes së cilës u krijua lista e pritjes së thirrjes dytë, e cila mund të trajtohej nëse mbetet buxhet i pashfrytëzuar nga masa 3 apo nëse sigurohen fonde tjera për të mbuluar subvencionimin.

Tabela 7 prezanton të dhënat e thirrjes së dytë, ku është përfshirë edhe kosto e parashikuar për rastet nga lista e pritjes.

Tabela 7. Të dhënat për thirrjen II

Masa 3 Zbatimi i masave EE në Sektorin e Banimit	
I. Shtëpitë Individuale-Thirrja e dytë	
Aplikacionet e të vlefshme të pranuar	1296
Para-aprovimet e lëshuara	1234
Refuzime	44
Tërheqje nga subvencioni	18
Vlera monetare për para-aprovimet e lëshuara	4,822,152.40 €
Aplikacionet e pranuar për disbursim	1100
Numri i rasteve të disbursuara	414
Shuma e disbursuar	1,414,084.17 €

Lista e pritjes-Thirrja e dytë	Shuma e nevojshme
815	~3,000,000.00 €

Me krijimin e kushteve, ku konsumatorët nga komunat veriore janë përfshirë në databazën e konsumatorëve të furnizuesit që operon në atë pjesë, në bashkëpunim me KESCO, FKEE ndërmori masa që në thirrjen e dytë të përfshihen edhe qytetarët e komunave veriore si masë gjithëpërfshirëse.


Fillimisht u ndërmor një fushatë informimi dhe një prej masave ishte funksionalizimi i zyrës së FKEE-së në Mitrovicën e Veriut ku nëpërmjet stafit, u shpërndanë materiale informuese sikurse

edhe u realizuan takime me qytetarë dhe prezencë e lartë mediatike. Edhe pse u organizua fushata dinamike e informimit, në vështirësi të angazhimit të auditorëve të energjisë, banorët e këtyre komunave patën vështirësi dhe vetëm një numër i vogël prej tyre arritën të aplikojnë në kohë, derisa numër i vogël arritën të listohen edhe në listën e pritjes.

Me një organizim të madh të stafit, FKEE brenda 2 javësh përfundoi me vlerësimin dhe dërgimin e para-aprovimeve. Për të iu mundësuar qytetarëve të aplikojnë sa më shumë, është bërë pastrimi i listave gjatë tre ditëve të aplikimeve nga aplikuesit që kanë aplikuar gabimisht duke i inkurajuar që të aplikojnë prapë ose t'u lirohet vendi të tjerëve. Vlerësimi është bërë në kohë reale dhe për tri ditë janë larguar mëse 200 aplikime me dokumente të gabuara.

Sikurse në thirrjen e parë, komunat më të mëdha që patën aplikacione më shumë ishin Prishtina, pasuar nga Podujeva, Vushtrria, Gjakova dhe Gjilani.

Përfituesit (kërkesat e para-aprovuara) nga **thirrja e dytë**, të ndarë sipas komunave janë paraqitur në grafikun në vijim:



Grafiku 9. Përfituesit (kërkesat e para-aprovuara) nga thirrja II sipas komunave

Tabela në vazhdim jep pasqyrën e saktë sa i përket përfitueseve gra-pronare/bashkëpronare ndaj atyre burra dhe komuniteteve joshumicë:

Tabela 8. Të dhënat për përfituesit e thirrjes së dytë të ndarë sipas pronësisë (aspekti gjinor) dhe komunitetet joshumicë.

	Nr. para-aprovimeve	Shuma e para-aprovuar me auditimet e thjeshtëzuara të energjisë [€]
Total	1788	6,344,854.53
Gratë pronare/ bashkëpronare	48	183,598.17
Burra	1740	6,161,256.36

Sa i përket komuniteteve joshumicë, kanë qenë 4 kërkesa të paraaprovuara në Thirrjen e dytë e që janë në proces të disbursimit me vlerën monetare të para-aprovuar prej 15,400 €.

Në përfundim të procesit të disbursimit të mjeteve financiare nga thirrja e dytë, lista e pritjes së thirrjes së parë dhe buxhetin e shpenzuar për masën 3 në përgjithësi, FKEE ka kërkuar pëlqimin nga komiteti drejtues i projektit përdorimin e buxhetit të mbetur për trajtimin e listës së pritjes nga thirrja e dytë. Në bazë të buxhetit të llogaritur si të mbetur, është planifikuar të trajtohen rreth 350 kërkesa të regjistruara në listën e pritjes - thirrja e dytë.

Nga kjo nën-masë, FKEE konsideron që janë ngritur kapacitetet për të zbatuar modele të ndryshme sa i përket zbatimit të masave EE në sektorin e shtëpive individuale, duke avancuar edhe në trajtimin e kërkesave, rritur dinamikën dhe cilësinë e punës sikurse edhe ngritur vetëdijen e qytetarëve për rëndësinë e aplikimit të masave EE në shtëpitë e tyre.

FKEE konsideron të nevojshëm një softuer ose platformë për menaxhimin sa më të mirë të kërkesave dhe synon të arrijë në realizimin e këtij synimi nëpërmjet donatorëve. Nëpërmjet digjitalizimit të procesit, duke filluar nga aplikimi deri te disbursimi, do të siguronte në rritjen e transparencës, uljen e mundësive për gabime eventuale sikurse edhe ndërlidhjen dhe raportimin sa më të lehtë edhe vlerësimin e impaktit të secilit projekt. Ky softuer është konceptuar dhe do të financohet nga LuxDev gjatë vitit 2025.

Këtu propozojmë të vendosen fotografitë e shtëpive individuale ku tregohet gjendja para dhe pas masave.

6.3.2 Zbatimi i masave EE në ndërtesat shumë-banesore sociale në pronësi të komunave

Indikatori 2 i Masës 3, ka në fokus aplikimin e masave rinovuese për rritjen e efijencës së energjisë në ndërtesat shumë-banesore sociale në pronësi komunale. Përmes kësaj mase parashihet që të ulen humbjet termike, të arrihen kursime të theksuara të energjisë si dhe rritjen e komoditetit jetësor të banorëve, të cilët janë nën skemën sociale.

FKEE hapi thirrjen publike me datë 07 prill 2023 me afat 10 ditor, për aplikimin e komunave të interesuara që të përfshiheshin në kuadër të këtij projekti. Gjatë kësaj kohe FKEE ka pranuar aplikime nga 15 komuna të Kosovës me gjithsej 39 ndërtesa shumë-banesore sociale. Mes tyre, 29 ndërtesa shumë-banesore sociale nga 13 komuna janë miratuar nga FKEE, pasi plotësuan kriteret e pranueshmërisë si më poshtë:

- Objektet duhet të jenë në pronësi të komunës përkatëse;
- Objektet duhet të kenë banesat e shfrytëzueshme nga banorët e cila duhet (të vërtetohet nga numri i faturës/matësit të energjisë elektrike);
- Objektet duhet të kenë strukturë stabile dhe të mos kenë rinovim të plotë për të Efijencës së Energjisë EE në 5 vitet e fundit;
- Objektet nuk duhet të jenë pjesë e ndonjë plani për t'u transformuar, mbyllur, ridestinuuar apo privatizuar;
- Komuna duhet të ketë një linjë specifike buxhetore në dispozicion për angazhim nëpër pjesëmarrje (për dy vitet e ardhshme);
- Duhet të sigurohet angazhimi për mirëmbajtjen dhe qëndrueshmërinë e investimeve, pas përfundimit të periudhës së përgjegjshmërisë për defektet;
- Sigurimi i angazhimit për të ndërmarrë mirëmbajtjen dhe qëndrueshmërinë e investimeve, pas përfundimit të periudhës së përgjegjshmërisë për defektet.

Në kuadër të këtyre projekteve, FKEE financon 90% të investimit në formë të grantit nga BE, ndërsa komunat bashkëfinancojnë me 10% të investimit.

Pas pranimit të të gjitha kërkesave, FKEE përmes procesit të tenderimit ka kontraktuar 4 kompani, të ndara në 4 LOT-e, për vlerësimin strukturor të ndërtesave, auditimin detal energjetik të ndërtesave dhe draftimin e projektit detal për masat rinovuese. Gjatë këtij procesi, FKEE ka nënshkruar kontratat me 3 kompani për 3 LOT-et e para, kurse nënshkrimi i kontratës për LOT 4 është vonuar për arsye të ankesave në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Gjatë procesit të vlerëimit të qëndrueshmërisë strukturore të ndërtesave, nga kompania dizajnuese, një nga ndërtesat (LOT 2) me lokacion në komunën e Kamenicës është vlerësuar se nuk plotëson kriterin e qëndrueshmërisë strukturore, duke u larguar nga lista e ndërtesave. Pas heqjes së një ndërtese, mbeten të trajtohen 28 ndërtesa.

Komunat, të cilave u janë përzgjedhur ndërtesat shumë-banesore sociale, kanë nënshkruar marrëveshjen për inicim të projektit ("MIP") me FKEE-në. Kjo marrëveshje përfaqëson ligjërisht zotimin e komunave për të bashkëfinancuar dhe zbatuar projektin sipas rregullave dhe procedurave të FKEE-së. Kompanitë e kontraktuara, kanë bërë vlerësimet dhe auditimet detale energjetike për 22 ndërtesa, dhe kanë përcaktuar skenarët më të përshtatshëm për kursimin e energjisë, në koordinim me komunat përkatëse. Bazuar në auditimet detale, janë draftuar projektet e detajuara, së bashku me dokumentacionet tjera teknike përkatëse.

Procesi për auditimet detale dhe dizajnin për 6 ndërtesa tjera mbeti në shqyrtim të OSHP-së për 7 muaj andaj, pas të gjitha përgatitjeve nga FKEE, u vazhdua me procedurën me 22 ndërtesa dhe për 6 ndërtesa më vonë duke nënshkruar marrëveshje të bashkëfinancimit me 12 komuna dhe duke nënshkruar kontratat me OE për fillimin e punimeve në periudhën 11-15.10.2024.

Tabela në vazhdim pasqyron situatën lidhur me zbatimin e MEE në NSSHB.

Tabela 9. Zbatimi i masave EE në NSSHB në komunat e Kosovës

Masa 3 Implementimi i masave EE në Sektorin Rezidencial	
II. Ndërtesat sociale shumë-banesore	
Shuma e planifikuar	7,200,000.00 €
Numri i ndërtesave në proces rinovimi	28
Numri i komunave të përfshira	13
Numri i familjeve përfituese	785
Numri i banorëve të familjeve përfituese	4000
Numri i kompanive të kontraktuara për dizajn, auditim të energjisë, mbikëqyrje dhe DLP	4
Numri i pritur i kompanive për kryerjen e punëve	8

25 ndërtesa janë në proces të kryerjes së punimeve, për të cilat janë kontraktuar OE për zbatim të masave. FKEE ka përzgjedhur 7 kompani për kryerje të punimeve. Pas ankesave të njëpasnjëshme në OshP, për një periudhë shumë të gjatë nga operatorët ekonomikë, ende nuk janë përzgjedhur operatorët ekonomikë për kryerje të punimeve për 3 ndërtesat në Prizren.

Rinovimi i mbështjellësit të ndërtesës, izolimi i mureve, bodrumeve, nën-kulmit, hidro ose termo përmirësimeve të kulmit, riparimi/ndërrimi i dyerve dhe dritareve të jashtme, optimizimi i dritareve, përmirësimi/instalimi i sistemit të ngrohjes, ndriçim LED në ndërtesë dhe masa të tjera të këshillueshme, përfshijnë masat që do të implementohen në të gjitha këto ndërtesa nga të cilat përfitojnë rreth 785 familje të cenueshme, nga të cilat rreth 75 familje u takojnë komuniteteve joshumicë.

6.3.3 Kursimi i energjisë për ngrohje

Të dhëna mbi energjinë e kursyer (në kwh, reduktimet e CO₂).

- Sa i përket komponentës së subvencionimit të aplikimit të masave EE në shtëpitë individuale, janë bërë edhe kalkulimet e kursimeve të energjisë për ngrohje dhe ka rezultuar se për **2218** përfitues të trajtuar brenda 2024 është arritur kursime të llogaritura të energjisë primare prej rreth **63,550 MWh/vit (rreth 5.6 ktoe/vit)**. Në bazë të kalkulimeve, pas aplikimit të masave EE është arritur një kursim mesatar i energjisë primare për ngrohje rreth **30%**.
- Tek ndërtesat sociale shumë-banesore, të cilat janë në rinovim, sipas auditimeve detale kursimi i energjisë do të jetë rreth **6,205 MWh/vit (rreth 0.53 ktoe/vit)**.

6.4 Sfidat në Zbatimin e Projekteve në Sektorin Publik dhe Rrezidencial

Sektori rezidencial përballët me një sërë sfidash, të cilat ndryshojnë në varësi të trajtimit të shtëpive individuale dhe ndërtesave shumë-banesore.

Sfidat në Procesin e Aplikimeve për Shtëpitë Individuale:

- **Përdorimi i platformës e-Kosova dhe dokumentacioni elektronik** - Një numër i konsiderueshëm i qytetarëve hasën në vështirësi gjatë aplikimit dhe plotësimit të dokumentacionit përmes platformës e-Kosova, veçanërisht në thirrjen e parë. Në thirrjen e dytë, u vërejt një vetëdijësim më i lartë në këtë aspekt.
- **Mungesa e dokumenteve fizike** - Shumë aplikues ose nuk kanë përfshirë dokumentet e nevojshme ose kanë ngatërruar dokumentacionin për disbursim. Për të adresuar këtë sfidë, FKEE ka ofruar ndihmë përmes thirrjeve telefonike, videove informuese dhe takimeve me qytetarët për t'i asistuar ata gjatë aplikimit.
- **Procesi manual i trajtimit të kërkesave** - Procesi manual i vlerësimit dhe disbursimit ka shkaktuar vonesa. Për ta lehtësuar këtë proces, FKEE ka implementuar digjitalizimin e vulosjes së para-aprovimeve dhe një platformë për aplikimin digjital për disbursim, duke përshpejtuar procesin dhe minimizuar gabimet.
- **Ngatërrimi i numrit të njehsorëve të energjisë elektrike** - Ky problem ka ndikuar në identifikimin e aplikuesve dhe verifikimin e konsumit minimal të nevojshëm. Sfidat është adresuar përmes bashkëpunimit të ngushtë me KESCO-n për verifikimin dhe konfirmimin e saktësisë së të dhënave.
- **Identifikimi i njehsorëve në komunat veriore të Kosovës** - Mungesa e regjistrimeve në platformën e-Kosova ka krijuar vështirësi në identifikimin e përfituesve. FKEE ka bashkëpunuar me operatorët lokalë dhe auditorët energjetikë për të adresuar këtë sfidë.
- **Mungesa e auditorëve të energjisë në komunat veriore dhe nga komunitetet joshumicë**

- Ky faktor ka ndikuar në numrin e ulët të aplikimeve nga këto komuna. Një tjetër pengesë tjetër ka qenë barriera gjuhësore midis auditorëve dhe aplikuesve.

- **Sfidat me auditorët e energjisë** - Qytetarët kanë raportuar vonesa në procesim, çmime të larta dhe cilësi të dobët të raporteve. FKEE ka adresuar këto shqetësime duke raportuar ankesat në institucionet përkatëse.
- **Aplikimet me shtëpi të izoluar** - Disa aplikues kanë paraqitur kërkesa për shtëpi që tashmë kanë izolim termik. Për verifikim, janë organizuar inspektime në terren dhe janë marrë masa ndaj raportuar auditorët energjetikë të përfshirë në raportime të rrejshme.
- **Kushtet dimërore dhe ndikimi në zbatimin e masave EE** - FKEE ka koordinuar procesin me Zyrën e BE-së për të shtyrë afatin e disbursimit deri më 30 prill 2025, për të mundësuar zbatimin e projekteve.
- **Mungesa e kompanive për zbatimin e masave EE** - Kjo ka shkaktuar vonesa në zbatim, ndërsa kërkesa për aplikime ka qenë e lartë. Një mungesë e tillë mbetet një sfidë për thirrjet e ardhshme.
- **Verifikimi dhe dokumentacioni për disbursim** - Disa kompani të kontraktuara kanë hasur vështirësi në kuptimin e procesit, gjë që është tejkaluar përmes takimeve informuese të organizuara nga FKEE. Në disa raste, kompanitë e kontraktuara kanë pasur vështirësi në kuptimin e procesit, çka është tejkaluar përmes takimeve sqaruese.

Sfidat në Ndërtesat nën Menaxhimin Komunal:

- **Vonesat në lëshimin e dokumenteve nga komunat** - Pas nënshkrimit të marrëveshjeve, disa komuna kanë vonuar dhënien e pëlqimeve për fillimin e punimeve, duke ndikuar në afatet e zbatimit të projekteve. Edhe pas nënshkrimit të marrëveshjeve, disa komuna kanë vonuar dhënien e pëlqimeve për fillimin e punimeve, duke ndikuar në planet dinamike të FKEE-së.
- **Mungesa e deponive komunale për materiale inerte dhe të përkohshme** - Mungesa e hapësirave për depozitimin e materialeve të përkohshme ka shkaktuar vështirësi në realizimin e projekteve. Shumë komuna nuk kanë siguruar deponi për këto materiale, duke krijuar pengesa në realizimin e projekteve.
- **Mungesa e deponive për materiale të rrezikshme** - Si rezultat i prezencës së azbestit dhe materialeve të tjera të rrezikshme, ka pasur vonesa të mëdha. Në fund të vitit 2024, me iniciativën e FKEE-së, është arritur një marrëveshje me Ministrinë e Ekonomisë dhe me Trepça SH.A. për shfrytëzimin e deponisë në Kishnicë për disa projekte.
- **Shpërputhjet në të dhënat teknike të projekteve nga kompanitë projektuese dhe mbikëqyrëse** - Mospërputhjet teknike në projekte kanë shkaktuar vonesa dhe kosto shtesë. Për të minimizuar këto probleme, FKEE ka filluar standardizimin e specifikimeve teknike me kërkesat që burojnë nga FKEE.
- **Niveli i ulët i njohurive të kompanive zbatuese mbi masat EE** - Gabimet teknike nga Kompanitë e ndërtimit gjatë zbatimit të masave të eficientës së energjisë kanë kërkuar ndërhyrjen e stafit të FKEE-së, për të siguruar cilësi më të lartë. Kompanitë e ndërtimit shpesh bëjnë gabime gjatë zbatimit të masave EE, duke e bërë të nevojshme ndërhyrjen e stafit të FKEE-së.
- **Mungesa e kompanive të licencuara për trajtimin e materialeve të rrezikshme** -Ky problem vazhdon të jetë një pengesë serioze në realizimin e projekteve të FKEE-së.

Mungesa e operatorëve të licencuar për trajtimin e këtyre materialeve vazhdon të jetë një pengesë serioze për FKEE.

- **Mungesa e matjes dhe monitorimit të energjisë termike** - Shpenzimet e energjisë raportohen nga komunat me konvertime manuale, të cilat shpesh rezultojnë të pasakta. Raportimi i shpenzimeve të energjisë nga komunat bazohet në konvertime manuale, të cilat mund të çojnë në pasaktësi.
- **Afatet e kufizuara për zhvillimin dhe zbatimin e projekteve** - Koha e kufizuar e për projektet e mëdha kanë ndikuar në gabime teknike dhe në vonesa në implementim.
- **Mungesa e standardizimit të dokumenteve** – Dokumentet teknike dhe administrative nuk janë të standardizuara, çka ka krijuar pengesë në menaxhimin e projekteve. Aktualisht,



FKEE

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË
KOSOVSKI FOND ZA ENERGETSKU EFIKASNOST
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND

Raporti i Impaktit

Prishtinë, Korrik 2025

7.1 Ndikimi i Investimeve të FKEE-së

7.1.1 Ndikimi mjedisor

Gjatë vitit 2024, FKEE ka arritur të implementojë masat rinovuese në shtëpitë individuale, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ndikimin në mjedis, kurse në sektorin shumë-banesor social, projektet janë në fazat e para të zbatimit dhe se ndikimi në mjedis është i projektuar, i cili pritet të arrihet gjatë vitit 2025.

Sa i përket projekteve në sektorin e banimit, reduktimi i CO₂ është llogaritur 43 kg/m² të shtëpive të rinovuara që në total rezulton me 23 kiloton reduktim të CO₂ në vit që konsiderohet si ndikim i rëndësishëm mjedisor. Nga rinovimi i ndërtesave sociale shumë-banesore, në bazë të auditimeve detale të energjisë, llogaritet reduktimi i CO₂ në sasi prej mbi 2 kiloton/vit.

Më poshtë janë paraqitur disa shembuj të shtëpive, para dhe pas investimit në masa për rritjen e Efiçencës së Energjisë

Komuna e Prishtinës



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Podujevës



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Pejës



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Gjakovës



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Ferizajt



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Gjilanit



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Prizrenit



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Vushtrisë



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Fushë Kosovës



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Shtimes



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Skenderajt



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Deçanit



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Dragashit



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Mamushës



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Hanit të Elezit



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Mitrovicës së Veriut



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Rahovecit



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Suharekës



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Malishevës



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Mitrovicës së Jugut



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Istogut



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Glogocit/Drenasit



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Lipjanit



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Vitisë



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Kamenicës



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Klinës



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Obiliqit



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Kaçanikut



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Komuna e Novobërdës



Gjendja e shtëpisë
Para masave EE



Gjendja e shtëpisë
Pas masave EE

Ndikimi i drejtëpërdrejtë te qytetarët- përfitues të investimeve në shtëpitë individuale

“Vjet me kanë shku 20 kubik dru, sivjet as 8 sepse vetëm në mëngjes po e lëshojmë sistemin e ngrohjes, më nuk po ka nevojë.”

Tafil Latifi nga Podujeva, përfitues i subvencionimit të masave të efijencës së energjisë, thotë se kjo ulje e koston në lëndën që e përdor për ngrohje, erdhi pas izolimit të shtëpisë, sipas kritereve të FKEE-së.

Përveç kursimit, ai tha se është rritur komoditeti, meqë ngrohtësia vërehet që në hyrje të shtëpisë.



7.2 Ndikimi social

Projektet e realizuara në sektorin privat dhe atë publik kanë ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e cilësisë së jetës për banorët dhe përdoruesit e ndërtesave të trajtuara. Sipas komunikimeve me përfituesit, janë raportuar përmirësime në ngritjen e komoditetit termik duke arritur temperaturën e njëtrajtshme brenda hapësirave të banimit dhe eliminimi i problemeve me lagështinë dhe mykun, problem me të cilat janë ballafaquar qytetarët në ndërtesat e paizoluara.

Aplikimi i masave EE në sektorin e banimit ndikon në aspektin social gjithashtu duke përkrahur qytetarët në kursim monetar sa i përket shfrytëzimit të energjisë elektrike dhe ngritjen e mirëqenies. Tek shtëpitë individuale subvencioni prej 45% dhe pjesërisht me 50% ka mundësuar që familjet, të cilat nuk kanë zotëruar mjetet e mjaftueshme për investime të tilla, të arrijnë të realizojnë izolimin cilësor të shtëpive. Në ndërtesat sociale shumë-banesore aplikimi i masave EE do të prek aspektin social të 785 familjeve nën asistencën sociale, duke konsideruar gjendjen aktuale të hapësirave të brendshme, mungesës së komoditetit termik dhe prezencës së lagështisë. Me këto investime, parashihet që niveli i komoditetit, mirëqenies dhe kushteve higjienike do të ngritet ndjeshëm, krahas kursimeve për energji për ngrohje.

7.3 Ndikimi ekonomik

Me fillimin e zbatimit të projekteve nëpër komuna, një pjesë e madhe e materialeve të përdorura janë prodhime vendore, duke nxitur shitjen dhe shpërndarjen e tyre në të gjithë territorin e Kosovës. Njëkohësisht, rritet kërkesa për shërbime mbështetëse si transporti i materialeve, qiradhënia e makinerive dhe mirëmbajtja, duke krijuar mundësi punësimi në sektorë të ndryshëm. Një ndikim i ngjashëm vërehet edhe në fuqinë punëtore lokale, ku përveç krijimit të vendeve të reja të punës, rritet edhe nevoja për fuqi punëtore të trajnuar, duke nxitur edukimin profesional dhe certifikimin e zanateve të reja. Prandaj, përveç lehtësimit të buxhetit komunal,

këto investime luajnë një rol kyç në stimulimin e zhvillimit ekonomik lokal.

Këto masa kanë pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në ekonominë familjare dhe buxhetin e komunave, duke ulur ndjeshëm kostot vjetore për ngrohje/ftohje. Për sektorin rezidencial privat, një shtëpi e zakonshme ka arritur një reduktim të humbjeve termike prej rreth 40%, çka përkthehet në kursime të mëdha për ngrohje gjatë dimrit.

Krahas kursimeve të arritura në buxhetet familjare dhe ato institucionale-komunale masat EE të projektuara dhe zbatuara, kanë krijuar një injektim të theksuar financiar në sektorin e ndërtimitarisë sikur edhe prodhimit vendor të produkteve ndërtimore si dhe rritjes së vendeve të punës.

Vetëm nga thirrja e parë publike, nga qytetarët përfitues, janë angazhuar **1,572 kompani** në mbarë Kosovën, për kryerjen e punimeve në implementimin e masave të efijencës së energjisë në shtëpitë e tyre.

Përgjatë vitit 2024 janë investuar në total mbi 17 milionë euro në sektorin e shtëpive individuale prej të cilëve FKEE ka marrë pjesë me subvencionim të 45 % e në disa raste 50%, të cilat janë injektuar në sektorin e kompanive ndërtimore. Kurse në sektorin rezidencial të ndërtesave shumë-banesore sociale, në vitin 2024 janë kontraktuar 5.7 milion euro, të cilat do të investohen gjatë vitit 2025. Mbi vlerën e investimeve për zbatimin të masave rinovuese, 5% e kësaj vlere shkon në shërbime të ofruara nga kompani projektuese, kompani mbikëqyrëse, angazhim të auditorëve energjetik individualë, kompanitë verifikuese etj.

Më poshtë janë paraqitur disa shembuj të institucioneve publike para dhe pas investimit në masa për rritjen e Efijencës së Energjisë.


SH.F.M.U "Esad Mekuli ", Deçan



Gjendja Para



Gjendja Pas

 Vlera e Investimit
64,578.96€

 Përqindja e kursimit
53%

SH.F.M.U "Dëshmorët e Drenicës", Drenas



Gjendja Para



Vlera e Investimit
98,573.65€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
68%

SH.F.M.U "Luigj Gurakuqi", Drenas



Gjendja Para



Vlera e Investimit
134,125.05€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
67%

SH.F.M.U "Jusuf Gërvalla", Drenas



Gjendja Para



Vlera e Investimit
101,553.01€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
68%

SH.F.M.U "Gani Elshani", Drenas



Gjendja Para



Vlera e Investimit
90,170.15€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
67%

SH.F.M.U "Migjeni", Drenas



Gjendja Para



Vlera e Investimit
19,8701.8€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
75%

SH.F.M.U "Shaban Polluzha", Drenas



Gjendja Para



Vlera e Investimit
88,113.16



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
78%

SH.F.M.U "Shote Galica", Drenas



Gjendja Para



Vlera e Investimit
18,7208.13€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
67%

SH.F.M.U "24 Korriku", Drenas



Gjendja Para



Vlera e Investimit
76,561.51€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
80%

SH.F.M.U "Fehmi Agani", Gjakovë



Gjendja Para



Vlera e Investimit
449,594.21€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
76%

SH.F.M.U "Kadri Kusari", Gjakovë



Gjendja Para



Vlera e Investimit
429,915€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
56%

SH.F.M.U "Rexhep Elamzi", Gjilan



Gjendja Para



Vlera e Investimit
155,814.24€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
65%

SH.M.T "Mehmet Isai", Gjilan



Gjendja Para



Vlera e Investimit
692,561€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
49%

SH.F.M.U "Abaz Ajeti", Gjilan



Vlera e Investimit
349,993.77€



Përqindja e kursimit
75%

SH.F.M.U "Ilaz Thaqi", Hani Elezit



Vlera e Investimit
34,361.12€



Përqindja e kursimit
11%

SH.F.M.U "Ismail Qemali", Istog



Vlera e Investimit
66,014.18



Përqindja e kursimit
65%

Çerdhe "Pëllumbat e ardhmerisë", Istog



Gjendja Para



Vlera e Investimit
88,724.21€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
77%

SH.F.M.U "Bajram Curri", Istog



Gjendja Para



Vlera e Investimit
65,128.73€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
78%

Gjimnazi "Ismail Qemali", Kamenicë



Gjendja Para



Vlera e Investimit
213,865.28€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
62%

SH.F.M.U "Metush Krasniqi", Kamenicë



Gjendja Para



Vlera e Investimit
174,206.12€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
63%

SH.F.M.U "Motrat Qirazi", Klinë



Gjendja Para



Vlera e Investimit
75,442.65€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
93%

SH.F.M.U "Dëshmoret e Qendreses", Klinë



Gjendja Para



Vlera e Investimit
63,731.02€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
25%

SH.F.M.U "Avni Zhabota", Klinë



Gjendja Para



Vlera e Investimit
61,607.92€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
79%

SH.F.M.U "3 Deshmoret", Klinë



Gjendja Para



Vlera e Investimit
68,467.18€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
73%

SH.F.M.U "Ate Shtjefan Gjegovi", Klinë



Gjendja Para



Vlera e Investimit
59,268.515€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
74%

Gjimnazi "Hamdi Berisha", Malishevë



Vlera e Investimit
29,0017.36€



Përqindja e kursimit
57%

SH.M "Lasgush Poradeci", Malishevë



Vlera e Investimit
199,622.41€



Përqindja e kursimit
50%

SH.F.M.U "Labinot Krasniqi", Malishevë



Vlera e Investimit
116,849.45€



Përqindja e kursimit
85%

SH.F.M.U "Ibrahim Mazreku", Malishevë



Vlera e Investimit
231,616.05€




Përqindja e kursimit
53%

SH.F.M.U "Elena Gjika", Mitrovicë



Vlera e Investimit
125,489.27€



Përqindja e kursimit
89%

Çerdhja "Gezimi Ynë", Mitrovicë



Vlera e Investimit
415,997.19€



Përqindja e kursimit
86%

SH.F.M.U "Eqrem Qabej", Mitrovicë



Vlera e Investimit
204,550.59€



Përqindja e kursimit
83%

SH.M.L.E "Hasan Prishtina", Mitrovicë



Vlera e Investimit
186,005.65€



Përqindja e kursimit
84%

SH.F.M.U "Skenderbeu", Mitrovicë



Vlera e Investimit
542,481.48€



Përqindja e kursimit
64%

SH.M.E "Bora Stankovic", Novoberdë



Gjendja Para



Gjendja Pas



Vlera e Investimit
103,694.21€



Përqindja e kursimit
67%

SH.F "D. Maksimovic", Novoberdë



Gjendja Para



Gjendja Pas



Vlera e Investimit
43,513.9€



Përqindja e kursimit
82%

I.A.A.P "Rifat Gjota" (ish "Shaban Spahija"), Pejë



Gjendja Para



Gjendja Pas



Vlera e Investimit
69,513.45€



Përqindja e kursimit
80%

SH.F.M.U "Asdreni", Pejë



Gjendja Para



Vlera e Investimit
198,042.21€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
90%

Shkolla "Shefki Kuleta", Podujevë



Gjendja Para



Vlera e Investimit
111,710.65€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
74%

SH.F.M.U "Shaban Shala", Podujevë



Gjendja Para



Vlera e Investimit
245,656.14€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
65%

SH.F.M.U "Enver Maloku", Podujevë



Gjendja Para



Gjendja Pas



Vlera e Investimit
303,965.01€



Përqindja e kursimit
68%

SH.F.M.U "Luigj Gurakuqi", Podujevë



Gjendja Para



Gjendja Pas



Vlera e Investimit
63,501.22€



Përqindja e kursimit
84%

SH.F.M.U "Ekrem Rexha", Prizren



Gjendja Para



Gjendja Pas



Vlera e Investimit
183,327.105€



Përqindja e kursimit
76%

SH.F.M.U "Fadil Hisari", Prizren



Gjendja Para



Vlera e Investimit
185,555.55€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
65%

SH.F.M.U "Mate Logoreci", Prizren



Gjendja Para



Vlera e Investimit
240,404.42€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
62%

SH.F.M.U "Gëzim Hamza - Piktori", Rahovec



Gjendja Para



Vlera e Investimit
167,000.03€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
82%

SH.F.M.U "Rilindja", Rahovec



Gjendja Para



Gjendja Pas



Vlera e Investimit
138,675.28€



Përqindja e kursimit
64%

SH.F.M.U "Faik Konica", Rahovec



Gjendja Para



Gjendja Pas



Vlera e Investimit
72,907.52€



Përqindja e kursimit
44%

SH.F.M.U "Dëshmoret e Zatriqit", Rahovec



Gjendja Para



Gjendja Pas



Vlera e Investimit
80,627.37€



Përqindja e kursimit
77%

SH.F.M.U "Hamëz Thaqi", Rahovec



Vlera e Investimit
60.417.42€




Përqindja e kursimit
31%

SH.F.M.U "12 Maji", Rahovec



Vlera e Investimit
172,363.64€



Përqindja e kursimit
79%

SH.F.M.U "Skender Kastrati", Rahovec



Vlera e Investimit
140,069.395€



Përqindja e kursimit
70%

SH.F.M.U "Isa Boletini" , Rahovec



Vlera e Investimit
133,280.73€




Përqindja e kursimit
68%

SH.F.M.U "Bekim Sylka" , Rahovec



Vlera e Investimit
161,632.66€



Përqindja e kursimit
71%

SH.M.L "Naim Frashëri", Shtime



Vlera e Investimit
134,104.16€



Përqindja e kursimit
42%

SH.F.M.U "Emin Duraku", Shtime



Vlera e Investimit
210,546.64€



Përqindja e kursimit
75%

Gjimnazi "Hamez Jashari", Skenderaj



Vlera e Investimit
239,530.2€



Përqindja e kursimit
77%

SH.M.U "Ndre Mjeda", Viti



Vlera e Investimit
85,377.63€



Përqindja e kursimit
58%

SH.M.U "Hysen Terpeza", Viti



Gjendja Para



Vlera e Investimit
80,182.52€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
61%

SH.M.U "Bafti Haxhiu", Viti



Gjendja Para



Vlera e Investimit
146,205.14€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
57%

SH.M.U-1 "RR.Deshmoret e Kombit, Vushtrri



Gjendja Para



Vlera e Investimit
198,629.26€



Gjendja Pas



Përqindja e kursimit
70%

SH.F.M.U "Mazllum Këpuska", Gjakovë



Gjendja Para



Gjendja Pas



Vlera e Investimit
299,799.34€



Përqindja e kursimit
87%

8. Potenciali në Sektorin Rezidencial


8.1 Sektori rezidencial – Një Histori Suksesi

Komponenta 1 e Masës 3 e Pakos së Emergjencës Shtetërore, e përfshirë në Planin e Veprimit të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimet nr. 29/112 dhe 03/128, është një iniciativë kryesore për subvencionimin e masave të efijencës së energjisë (EE) në shtëpitë individuale. Kjo masë është zbatuar në kuadër të Marrëveshjes Financiare IPA III, e nënshkruar më 24 shkurt 2023 ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Komisionit Evropian.

Përfitimet Kryesore të Masës

Si rezultat i zbatimit të kësaj mase, projekti është vlerësuar si një histori sukcesi nga FKEE, Qeveria e Kosovës dhe Bashkimi Evropian, por edhe nga palët e tjera të interesit. Me një subvencion prej 45% të investimit (dhe deri në 50% për gratë bashkëpronare ose pronare të shtëpive, deri në maksimumin prej 5,500 euro), interesi i qytetarëve ishte jashtëzakonisht i lartë.

Përfitimet e kësaj mase kanë qenë të dukshme në disa aspekte kyçe:



Në kuadër të kësaj mase, investimi total ka arritur mbi 17 milionë euro, ku FKEE ka kontribuar me subvencionim prej 45%, dhe në disa raste deri në 50%. Ky investim ka pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik, duke mbështetur operatorët ekonomikë të specializuar në ndërtim dhe furnizim me materiale ndërtimore, si dhe duke rritur kërkesën për fuqi punëtore të kualifikuara.

Përveç ndikimit në sektorin ekonomik dhe social, programi ka vendosur një standard të ri në promovimin e efijencës së energjisë, duke krijuar një bazë të fortë për investime të ardhshme në sektorin rezidencial.

8.2 Potenciali për Zgjerim dhe Nevoja për Përkrahje Buxhetore

Duke marrë parasysh ndikimin pozitiv dhe kërkesën e lartë për këtë skemë, Fondi ka një potencial të madh për zgjerim, duke synuar shtrirjen e projekteve të efijencës së energjisë në një nivel më të gjerë. Për të realizuar këtë ambicie, është thelbësore të sigurohet mbështetje e qëndrueshme financiare dhe institucionale.

Për të mundësuar zgjerimin dhe rritjen e ndikimit të programit, kërkohen veprimet e mëposhtme:

- **Rritja e mbështetjes buxhetore** nga Qeveria e Kosovës dhe donatorët ndërkombëtarë, për të garantuar vazhdimësinë dhe zgjerimin e programeve të subvencionimit.
- **Forcimi i kapaciteteve institucionale** të FKEE-së, për të menaxhuar në mënyrë efikase projekte më komplekse dhe me një shtrirje më të gjerë.
- **Thellimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë** për të siguruar mbështetje teknike dhe financiare, si dhe për të përmirësuar standardet e efijencës së energjisë.
- **Zhvillimi i mekanizmave të rinj financiarë** për të mbështetur qytetarët dhe bizneset në investimet për efijencën e energjisë, duke përfshirë partneritete publiko-private dhe skema të reja të kreditimit të favorshëm.

Duke ndërtuar mbi këtë sukses dhe me mbështetjen e nevojshme financiare dhe institucionale, FKEE është e gatshme të luajë një rol kyç në avancimin e qëndrueshmërisë energjetike të Kosovës, duke kontribuar në reduktimin e konsumit të energjisë, uljen e ndotjes dhe zhvillimin e ekonomisë së gjelbër në vend.

8.3 Hapja e Zyrës në Mitrovicë të Veriut



Fondi i Kosovës për Efijencë të Energjisë në përputhje me misionin e vet për të promovuar praktikën e energjisë efijente dhe ruajtjen e mjedisit, ka synuar të përmirësojë ofrimin e shërbimeve të tij duke hapur një zyrë të re në Mitrovicë të Veriut, për të qenë më pranë përfituesve të tij në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Qëllimi i hapjes së kësaj zyre të re ka qenë përmirësimi i qasjes në mënyrë që shërbimet e FKEE-së të bëhen më të arritshme për sektorin privat dhe atë publik në këtë rajon.

Kjo zyrë gjithashtu ka ofruar mbështetje më të personalizuar për aplikuesit që kanë kërkuar asistencë financiare dhe teknike për projekte të efijencës së energjisë. Në të njëjtën kohë përmes kësaj zyreje është promovuar efijencia e energjisë duke u rritur dukshmëria dhe ndërgjegjësimi për programet dhe iniciativat e saj në nivel lokal në komunat veriore të Republikës së Kosovës.

Zyra në Mitrovicën e Veriut i ka vendosur shërbimet e FKEE-së më pranë përfituesëve potencialë nga komunat veriore të vendit. Kjo ka përmirësuar komunikimin, ka reduktuar kostot e udhëtimit dhe ka siguruar që komuniteti në atë zonë të ketë qasje të barabartë në financim dhe mbështetje, e materializimi më i lartë i kësaj mundësie pritet të arrihet nga programet e ardhshme të FKEE-së dhe donatorëve.



Kjo zyre në të ardhmen do të çojë në krijimin e vendeve të reja pune në rajon, si drejtpërdrejt ashtu edhe tërthorazi. Gjithashtu, zyra mund të shërbejë si një qendër për programe ndihmëse, duke ofruar punëtori, trajnime dhe aktivitete ndihmëse të fokusuara në praktikatat e efijencës së energjisë.

Zyra në Mitrovicë të Veriut ofron udhëzime të personalizuar mbi praktikatat e efijencës së energjisë dhe mundësitë financiare; ndihmë për përfituesit në procesin e aplikimeve për grante për efijencën e energjisë; ofrimin e mbështetjes teknike për vlerësimin e mundësive për kurse të energjisë; organizim të programeve edukative të rregullta mbi efijencën e energjisë për bizneset lokale, institucionet dhe pronarët e shtëpive.

Si përfundim, hapja e kësaj zyre të Fondit të Kosovës për Efijencë të Energjisë ka përmirësuar aftësinë e FKEE-së për të shërbyer komunitetin lokal në veri të vendit, duke kontribuar për një të ardhme më të qëndrueshme për të gjithë qytetarët. Suksesi i kësaj iniciative mbështetet në planifikim të kujdesshëm, burime të mjaftueshme dhe bashkëpunim aktiv me palët e interesit siç janë BE, Qeveria e Kosovës, Komunat veriore dhe palët tjera. Me misionin e qartë dhe punonjës të angazhuar, zyra në Mitrovicë të Veriut synon të bëhet një qendër për avancimin e efijencës së energjisë në atë rajon.

9. Menaxhimi Financiar, Arritjet dhe Sfidat

Gjatë vitit 2024, Fondit i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE) ka bërë përparime të konsiderueshme në menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, duke zbatuar një qasje më të strukturuar dhe efikase në planifikimin dhe administrimin e burimeve financiare. Këto përmirësime janë arritur përmes miratimit të rregulloreve të reja, forcimit të mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe përmirësimit të proceseve të menaxhimit të shpenzimeve, duke garantuar një përdorim të qëndrueshëm dhe efikas të buxhetit.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm i FKEE-së, gjatë vitit 2024 ka shënuar progres të konsiderueshëm, duke reflektuar një qasje më të strukturuar dhe efikase ndaj planifikimit dhe administrimit të burimeve financiare. Ky avancim është arritur përmes miratimit të rregulloreve të reja, forcimit të mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe përmirësimit të proceseve të menaxhimit të shpenzimeve për të garantuar përdorim të qëndrueshëm të buxhetit.

Një hap kyç ishte implementimi i plotë i softuerit të kontabilitetit, i cili ka mundësuar mbajtjen e saktë të regjistrave financiarë dhe analizën e detajuar të të dhënave për marrjen e vendimeve strategjike dhe operative.

Në tremujorin e parë të vitit 2024, FKEE ka përmirësuar ndjeshëm kontrollin e brendshëm në menaxhimin financiar, duke plotësuar vendet e lira dhe duke riorganizuar ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi. Ky proces ka ndihmuar në forcimin e efikasitetit dhe transparencës në operacionet financiare të institucionit.

Një nga arritjet kryesore të vitit ka qenë përgatitja e pasqyrave financiare vjetore për vitin 2023, bazuar ekskluzivisht në softuerin e ri të kontabilitetit. Për të siguruar transparencë dhe përputhshmëri me standardet ligjore, këto pasqyra janë audituar nga auditori i jashtëm dhe janë publikuar në faqen zyrtare të FKEE-së, duke rezultuar në një raport të pakualifikuar dhe pa theksim çështjesh.

Zhvillim tjetër i rëndësishëm është realizimi i auditimit të brendshëm të fushës financiare nga Auditori i Brendshëm i FKEE-së, një praktikë që ka ndihmuar në përmirësimin e mekanizmave të mbikëqyrjes dhe rritjen e besueshmërisë në proceset financiare.

Arritje e rëndësishme gjatë këtij viti ka qenë edhe përgatitja për herë të parë e pasqyrave financiare vjetore për vitin 2023, bazuar ekskluzivisht në softuerin e ri të kontabilitetit. Për të siguruar transparencë dhe përputhshmëri me standardet ligjore, këto pasqyra janë audituar nga auditori i jashtëm dhe janë publikuar në faqen zyrtare të FKEE-së, duke rezultuar me një raport të pakualifikuar dhe pa theksim çështjesh. Një tjetër zhvillim i rëndësishëm ka qenë realizimi i auditimit të brendshëm të fushës financiare nga Auditori i Brendshëm, një praktikë që përmirëson mekanizmat e mbikëqyrjes dhe rrit besueshmërinë në proceset financiare.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, FKEE ka ndërmarrë një nismë retrospektive për evidentimin dhe regjistrimin e të gjitha transaksioneve financiare për periudhën 2019-2023, duke aplikuar standardet SNRF në softuerin e kontabilitetit. Ky hap i ndërmarrë ka përmirësuar saktësinë e raporteve financiare historike dhe ka forcuar transparencën financiare të institucionit.

Për më tepër, me synimin e përmirësimit të kontrollit dhe monitorimit të shpenzimeve në përputhje me buxhetin, është hartuar dhe integruar plani kontabël me strukturën e buxhetit të FKEE-së.

Gjatë vitit 2024, janë aplikuar strategji për përmirësimin e menaxhimit të fondeve dhe llogarive bankare, duke maksimizuar të ardhurat dhe duke siguruar përfitime nga interesat e fondeve të depozituara në sektorin financiar, në një vlerë prej rreth 236 mijë euro, të cilat janë duke u shpërndarë për subvencione të masave në shtëpi individuale si dhe në donacione për grupe të cënueshme.

Një nga sfidat kryesore me të cilat është përballur FKEE gjatë vitit 2024 ka qenë kthimi i ulët i investimeve nga komunat në skemën kthyese. Mungesa e shlyerjes së obligimeve nga komunat për investimet në masat e efijencës së energjisë ka krijuar vështirësi në ri-investimin e fondeve të kthyera.

Ky faktor ka ekspozuar Fondin ndaj rrezikut kreditor dhe rrezikut të likuiditetit, duke ndikuar negativisht në aftësinë e institucionit për të vijuar me investimet e reja në projekte të efijencës së energjisë. Megjithatë, në tremujorin e fundit të vitit 2024 vërehet një përmirësim i dukshëm i cili është rezultat i komunikimit më të afërt dhe më të rregullt me institucionet përfituese, të cilat po rrisin përgjegjshmërinë e këtij bashkëpunimi.

Sfidë tjetër e rëndësishme ka qenë mungesa e buxhetimit të fondeve për FKEE-në në Kornizën e Shpenzimeve Afatmesme, përkatësisht në Ligjin e Buxhetit 2025. Mungesa e fondeve për shpenzime operative rrezikon qëndrueshmërinë e planifikimit të projekteve dhe ruajtjen e kapaciteteve profesionale të institucionit.

Sigurimi i një burimi të qëndrueshëm financiar është thelbësor që të përmbushë objektivat strategjike dhe të vazhdojë zhvillimin e projekteve në fushën e efijencës së energjisë. Në këtë drejtim, Bordi i FKEE-së ka miratuar një tarifë prej 2% për projektet e reja, e cila siguron një bazë të qëndrueshme financiare për investimet e ardhshme. Megjithatë, kjo tarifë do të rishikohet në mënyrë rigorozë për projektet e ardhshme, duke u siguruar që të reflektojë nevojat dhe dinamikat e institucionit.

Si përfundim, FKEE gjatë vitit 2024 ka shënuar përparime të dukshme në menaxhimin financiar duke rritur efikasitetin, transparencën dhe kontrollin e brendshëm. Megjithatë, sfidat e përballura kërkojnë vëmendje të vazhdueshme dhe ndërhyrje strategjike për të siguruar stabilitetin dhe rritjen e qëndrueshme të institucionit.

9.1 Menaxhimi i Portofolit të Skemës Kthyese (Komponenti Qarkullues)

Skema kthyese është një mekanizëm financiar qarkullues, i cili mundëson Fondit të Kosovës për Efijencë të Energjisë (FKEE) të investojë në projekte të efijencës së energjisë duke ri-investuar fondet e rikthyera në projekte të reja. Ky model garanton një përdorim të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm të kapitalit, duke maksimizuar ndikimin e investimeve në përmirësimin e efijencës energjetike në nivel lokal dhe kombëtar.

Deri më tani, FKEE ka zbatuar këtë skemë përmes Marrëveshjeve të Shërbimit të Energjisë (MShE), të cilat synojnë reduktimin e kostove të energjisë për përfituesit. Kursimet e arritura nga këto masa përdoren për shlyerjen e investimeve me një periudhë kthimi që, sipas legjislacionit në fuqi, nuk tejkalon 15 vjet.

Përmes MShE-ve, FKEE ofron një paketë të plotë shërbimesh, duke përfshirë:

- **Auditimin e energjisë;**
- **Dizajnin teknik;**
- **Prokurimin dhe mbikëqyrjen e kontraktuesve;**

- **Masat mbrojtëse mjedisore dhe sociale;**
- **Matjen dhe raportimin e kursimeve të energjisë.**

Deri në fund të vitit 2024, FKEE ka investuar në **85** projekte të efijencës së energjisë në objekte publike komunale, me një vlerë totale prej afro **13.3 milionë euro**. Sipas planeve të kthimit, deri në këtë periudhë, FKEE duhej të kishte marrë rreth **1.34 milionë euro** nga investimet e bëra, por deri më tani janë kthyer rreth **631 mijë euro**. Pavarësisht nivelit të ulët të kthimeve, tendenca është në rritje, dhe pritet që gjatë vitit 2025 të arrihet përmbushja e objektivave, në përputhje me përfundimin e pranimeve teknike të investimeve me komunat. Ky nivel i ulët i kthimit është në rritje dhe pritet që gjatë vitit 2025 të arrihen objektivat, në harmoni me përfundimin e pranimeve teknike të investimeve me komunat.

Për të adresuar këtë sfidë, FKEE planifikon të zhvillojë një strategji të re për alokimin e fondeve përmes MShE-ve dhe të hartojë një plan veprimi për të përmirësuar tutje procesin e kthimit të investimeve nga komunat.

Masat që do të ndërmerren përfshijnë:

- **Forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe raportimit;**
- **Rritjen e ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit me autoritetet komunale;**
- **Zbatimin e masave për nxitjen e kthimeve në kohë;**
- **Themelimin e Komitetit për Menaxhimin e Riskut;**
- **Zhvillimin e një softueri për menaxhimin e risqeve;**
- **Krijimin e një roli të specializuar për menaxhimin e riskut kreditor;**
- **Përdorimin e mekanizmave të përbarimit të borxheve.**

Përmes këtyre masave, FKEE synon të sigurojë funksionimin efikas dhe të qëndrueshëm të skemës kthyese, duke garantuar ri-investimin e suksesshëm në projekte të reja të efijencës së energjisë dhe përmbushjen e objektivave strategjike të institucionit.

9.2 Qëndrueshmëria financiare e FKEE-së

Për të siguruar qëndrueshmërinë financiare, FKEE funksionon si një mekanizëm qarkullues përmes skemës kthyese. Ky mekanizëm mundëson ri-investimin e kapitalit të kthyer nga përfituesit që kanë realizuar investime në efijencë të energjisë me financim nga FKEE.

Deri më tani, FKEE ka investuar në projekte të efijencës së energjisë në objekte publike në pronësi të komunave, pa aplikuar tarifa për menaxhimin dhe zbatimin e këtyre projekteve. Megjithatë, për të adresuar nevojat aktuale për qëndrueshmëri financiare dhe operim efektiv, dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Efijencën e Energjisë, Bordi i Drejtorëve i FKEE-së ka miratuar propozimin e Drejtorit Menaxhues për vendosjen e tarifave në normën **2%** në marrëveshjet e reja për shërbime të energjisë dhe bashkëfinancim. Kjo tarifë pritet të rritet tutje gjatë vitit 2025 për projektet e reja. Këto të ardhura do të ndihmojnë në mbulimin e shpenzimeve operative dhe në sigurimin e kapaciteteve për të vijuar zbatimin e projekteve strategjike në fushën e efijencës së energjisë. Megjithatë, deri në arritjen e vetëqëndrueshmërisë së plotë financiare, FKEE varet nga ndihma financiare e donatorëve dhe Qeverisë së Kosovës.

Në fund të vitit 2024, FKEE ka zhvilluar planin e biznesit për vitet 2025-2027, për herë të parë që nga themelimi i institucionit. Sipas analizave dhe rekomandimeve të përfshira në skenarët e këtij plani, të përgatitur nga kompania Grant Thornton Consulting, me mbështetje financiare nga LuxDev, theksohet rëndësia e qëndrueshmërisë financiare dhe mënyrat për arritjen e saj. Një nga rekomandimet kryesore është fillimi i aplikimit të tarifave për shërbimet e ofruara nga FKEE, praktikë e cila veçse ka filluar.

Implementimi i këtyre tarifave pritet të sjellë përfitime të shumta, duke përfshirë:

- Sigurimin e qëndrueshmërisë financiare me krijimin e një modeli financiar të pavarur dhe të qëndrueshëm për FKEE;
- Sigurimin e burimeve të qëndrueshme për zbatimin e projekteve ekzistuese dhe zhvillimin e projekteve të reja;
- Rritjen e efikasitetit dhe transparencës.

Këto masa janë thelbësore për të garantuar që FKEE të vazhdojë të luajë një rol kyç në promovimin dhe implementimin e projekteve të efijencës së energjisë në Kosovë.

10. Komunikimi me Publikun dhe Transparenca

10.1 Përfshirja e publikut, komunikimi dhe transparenca

Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë, si një nga misionet e saj të rëndësishme ka promovimin e rëndësisë së implementimit të masave të eficiencës së energjisë në ngritjen e mirëqenies dhe kursimin e energjisë.

Në këtë drejtim, FKEE është prezente përmes faqes zyrtare të internetit (uebfaqe), rrjetet sociale dhe kanale të tjera të komunikimit të shtypur dhe audioviziv, ashtu siç parashihet në rregullore. Duke synuar transparenca të lartë ndaj opinionit publik, FKEE vë në dispozicion të opinionit publik dhe i publikon në uebfaqe të gjitha të dhënat që janë publike. Institucioni përfaqësohet përmes Drejtorit Menaxhues, Zyrtarit për Marrëdhënie me Publikun, apo ndonjë punonjës tjetër i caktuar nga Drejtori Menaxhues.

FKEE ka faqen zyrtare në Facebook në të cilën gjatë vitit 2024, ka publikuar 176 postime dhe ka grumbulluar "reaches" rreth 790 mijë. Me zgjerimin e fushëveprimtarisë së institucionit dhe duke parë rritjen e interesimit të qytetarëve për informata rreth FKEE-së, janë hapur edhe llogari në rrjete të tjera sociale si LinkedIn, Instagram dhe X, tek të cilat shpërndahen informacionet në kohë reale.

FKEE është kujdesur për reprezentim të punës dhe aktiviteteve edhe në mediat tradicionale. Gjatë vitit, zyrtarët e FKEE-së kanë dhënë dhjetëra intervista në televizionet dhe radiot e vendit, si dhe FKEE ka lëshuar 12 komunikata për mediat e shkruara lidhur me informacionet më me rëndësi për qytetarët. Ngjarjet e mbajtura nga FKEE, kanë zënë vend edhe në edicionet e lajmeve me storje të përgatitura dhe prononcime të dhëna nga zyrtarët e FKEE-së. Tutje, FKEE ka pranuar 10 kërkesa nga mediat për t'u përgjigjur me shkrim në pyetjet e tyre dhe këtë institucioni e ka bërë brenda afateve të parapara me ligjin.

Të përkushtuar që informacioni dhe transparenca të jenë të një niveli sa më profesional, FKEE ka organizuar takimin e parë të punonjësve të institucionit me përfaqësues të mediave, duke bërë prezantimin e profilit institucional dhe duke u përgjigjur në të gjitha pyetjet e gazetarëve rreth projekteve të FKEE-së.



Qëllimi kryesor i aktiviteteve të komunikimit është rritja e ndërgjegjësimit të publikut për ndikimin që kanë projektet e FKEE-së. Në këtë aspekt, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, është realizuar një kampanjë e gjerë e publikimit të të gjitha projekteve në sektorin publik duke ju mundësuar të gjitha palëve të interesit marrjen e informacioneve rreth gjendjes para-pas të objektit, kostos së investimit, donatorëve, masave të implementuara, ndikimit të këtyre masave në ngritjen e mirëqenies së përfituesve, uljen e shpenzimeve të energjisë dhe mbrojtjen e ambientit.

Vëmendje tejet e madhe i është dhënë komunikimit në të gjitha format për informimin me kohë të të gjitha procedurave në projektet e sektorit rezidencial. Me qëllim të dhënies së informacionit në kohë reale, krahas linjave ekzistente të komunikimit (zyre, telefon, email, rrjete sociale), FKEE u përkujdes që të hap edhe qendrën e thirrjeve pa pagesë për qytetarët dhe zyren rajonale në veri të vendit.

Hapjes së thirrjes së dytë publike për subvencionimin e masave të efijencës së energjisë, si vazhdimësi e thirrjes së parë tejet të suksesshme të vitit 2023, i ka paraprirë një kampanjë informuese përmes të gjitha kanaleve dhe ceremonia solemne të lansimit të saj, në prezencë të krerëve shtetërorë, donatorëve dhe bashkëpunëtorëve të tjerë të FKEE-së.

Përgjatë gjithë vitit dhe tutje, janë përgatitur infografika me informacione për qytetarët rreth secilit hap të procesit të thirrjes, janë dhënë përgjigje në 3 linja telefonike, në të gjitha rrjetet sociale dhe 6 email adresa.

Krahas ceremonisë së hapjes së thirrjes së dytë publike, FKEE ka organizuar edhe tri ceremoni të nënshkrimit të marrëveshjeve, si më poshtë:

- Nënshkrimi i marrëveshjeve me komunat përfituese për implementimin e masave të efijencës së energjisë në ndërtesat shumë-banesore sociale;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve për implementimin e masave të efijencës së energjisë në sektorin publik;
- Nënshkrimi i marrëveshjes prej 86 milionë euro midis FKEE-së dhe BERZH-it. (për projektin e përkrahur nga Qeveria e Kosovës, BERZH-i, Bashkimi Evropian dhe Qeveria Daneze).

FKEE ka organizuar 6 ceremoni përruese për objektet në sektorin publik në Pejë, Klinë, Kamenicë, Rahovec, Prizren dhe Gjiilan. Ngjarjet e tilla organizohen në bashkëpunim me komunat përfituese dhe pjesëmarrës janë donatorët dhe përfituesit.





Të përkushtuar për komunikim transparent me të gjitha palët e interesit, FKEE ka organizuar edhe takime me grupe të interesit për të dhënë informacione të detajuara rreth misionit, angazhimit, projekteve të institucionit. Gjatë 2024 u organizuan:

- Takimi me auditorët e efijencës së energjisë;
- Takimi me zyrtarët komunalë të efijencës së energjisë;
- Takimi me kryetarët e komunave të Kosovës;
- Takimi me përfaqësuesit e bankave komerciale në vend;
- Takimi me gazetarët e ekonomisë;
- Takime të tjera me organizata të shoqërisë civile, organizata ndërkombëtare dhe institucione të tjera publike.

Aktualisht, FKEE është duke realizuar uebfaqen e re që do të përfshijë edhe kalkulatorë, tek të cilët qytetarët do të mund të bëjnë përllogaritje të ndryshme rreth implementimit të masave të efijencës, në shtëpitë apo banesat e tyre.

Në vazhdimësi, FKEE do të iniciojë përpilimin e rregullores së brendshme për komunikim, si një hap më shumë në plotësimin e objektivave në komunikim.

10.2 Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe partnerët

Gjatë vitit 2024 u formuan partneritete të reja dhe u nënshkruan Memorandume Bashkëpunimi për projekte dhe aktivitete bashkëpunuese rreth efijencës energjisë, me mbështetje ligjore, që siguron që çdo marrëveshje të jetë e plotë dhe të përputhet me standardet ligjore dhe mjedisore.

FKEE ka lehtësuar krijimin dhe ekzekutimin e bashkëpunimeve me palë të interesit, duke siguruar mirëkuptim dhe angazhim për qëllime të përbashkëta. Ndër marrëveshjet kryesore, veçohen ato me KESCO, Fakulteti i Arkitekturës pranë Universitetit të Prishtinës, Posta e Kosovës, SHSKUK, Balkan Green Foundation, Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare, etj.

Në çdo rast, FKEE është siguruar që të gjitha marrëveshjet të jenë ligjërish të qëndrueshme dhe të përputhen me objektivat strategjike të FKEE-së.

11. Fjalime dhe Mirënjohje

11.1 Fjala e Donatorëve



Artane Rizvanolli

Ministrja e Ministrisë së
Ekonomisë së Republikës
së Kosovës

Ministria e Ekonomisë

Për herë të parë, eficienta e energjisë është bërë një prioritet qendror në politikat energjetike të Kosovës, duke sjellë një ndryshim thelbësor në mënyrën se si e trajtojmë sektorin e energjisë dhe menaxhimin e burimeve tona natyrore. Ky përkushtim i ri reflekton vizionin tonë për një sektor energjetik të një ekonomie më të qëndrueshme, prej të cilës secili qytetar dhe biznes është përfitues duke shpenzuar më pak për energji e njëkohësisht duke kontribuar në siguri energjetike të vendit e mbrojtje të ambientit.

Në këtë kontekst, Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE) ka luajtur një rol kyç në zhvillimin dhe zbatimin e projekteve të rëndësishme që synojnë reduktimin e konsumit të energjisë dhe optimizimin e përdorimit të saj. Një ndër arritjet më të mëdha, ka qenë zbatimi i projekteve të eficientës në ndërtesat publike administrative, përfshirë ato arsimore, shëndetësore, kulturore, sportive, etj. dhe në shtëpitë individuale të banimit. Këto investime kanë pasur për rezultat kursime të konsiderueshme të energjisë, duke arritur reduktime nga 50% deri në 80% të konsumit.

Këto rezultate dëshmojnë ndikimin e drejtpërdrejtë të politikave të mirëfillta të eficientës energjetike, jo vetëm në uljen e kostove dhe mbrojtjen e mjedisit, por edhe në përmirësimin e kushteve të punës dhe shërbimeve për qytetarët. FKEE ka siguruar që të gjitha këto projekte të realizohen sipas standardeve më të larta, duke vendosur një model të qëndrueshëm për zhvillimin e sektorit të eficientës në vendin tonë.

Eficienta energjetike nuk është thjesht një qasje teknike, por një angazhim strategjik për të ardhmen e Kosovës. Përfitimet e saj shtrihen përtej kursimeve ekonomike, duke kontribuar në uljen e varësisë nga importi, reduktimin e ndotjes dhe mbrojtjen e shëndetit të brezave të ardhshëm.

Ministria e Ekonomisë do të vazhdojë të mbështesë fuqishëm këto përpjekje dhe të inkurajojë të gjitha institucionet relevante që të kontribuojnë në avancimin e eficientës së energjisë.

Dua të falënderoj Fondin e Kosovës për Eficiencë të Energjisë për punën e palodhur dhe kontributin e çmuar në realizimin e këtyre objektivave dhe t'iu uroj suksese të mëtejme në vitet që vijjnë. Pres me entuziazëm të shoh këtë institucion duke u fuqizuar më tej e duke zgjeruar skemat për mbështetje edhe të familjeve e të bizneseve në të ardhmen.



Rhedon Begolli

**Zv. Drejtor i Bankës
Botërore në Maqedoninë
e Veriut**

Specialist i Lartë i
Energjisë në Bankën Botërore
të Kosovës

Banka Botërore në Kosovë

Banka Botërore është krenare që ka mbështetur Fondin e Kosovës për Eficiencën e Energjisë (FKEE) që nga konceptimi fillestar deri në zhvillimin e modelit të tij inovativ të skemës kthyese dhe gjatë sfidave operacionale gjatë pandemisë së COVID-19.

FKEE është dëshmuar të jetë një sukses i jashtëzakonshëm në sektorin e eficiencës së energjisë në Kosovë, duke ofruar rezultate të prekshme që kanë avancuar ndjeshëm kursimet e energjisë në vend. Modeli i skemës kthyese të Fondit qëndron si një shembull i fuqishëm se si mekanizmat e qëndrueshëm të financimit mund të nxisin investime në shkallë të gjerë në eficiencën e energjisë në sektorin publik, dhe interesimi i treguar nga vendet e tjera për modelin e tij është një dëshmi e potencialit të FKEE-së për t'u replikuar si një zgjidhje e shkallëzueshme për përmirësimet e eficiencës së energjisë në nivel global.

Ne presim me padurim të vazhdojmë bashkëpunimin tonë me FKEE-n derisa hyn në fazën e ardhshme të zhvillimit.



David Oberhuber

Drejtor i GIZ në Kosovë

GIZ Kosova

Është kënaqësi dhe mirënjohje e madhe të shpreh vlerësimin tonë për punën e jashtëzakonshme të Fondit të Kosovës për Efiçencën e Energjisë (FKEE) dhe përkushtimin e tij për të lehtësuar investimet në zgjidhjet e qëndrueshme të energjisë në Kosovë. Në një botë ku nevoja për kursim të energjisë dhe mbrojtje të mjedisit është më urgjente se kurrë, roli i FKEE-së mbetet vendimtar në formësimin e kërkesës për një të ardhme të qëndrueshme dhe të sigurt të energjisë në Kosovë.

Efiçenca e energjisë nuk është vetëm një masë teknike apo financiare – është një mjet transformues për forcimin e ekonomisë, përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe ndihmën për Kosovën në arritjen e objektivave të saj afatgjata për zhvillim të qëndrueshëm. Përmes këtyre mekanizmave të financimit, Fondi ka dëshmuar aftësinë për të krijuar një ndikim të vërtetë, duke sjellë përfitime për familjet, komunitetet dhe bizneset anembanë Kosovës.

Për GIZ, partneritetet e qëndrueshme dhe afatgjata janë çelësi i suksesit. Është kënaqësi të shihet progresi i arritur nga FKEE dhe se si Kosova po ecën përpara me vendosmëri drejt një qasjeje më të përgjegjshme dhe të orientuar nga e ardhmja për përmirësimin e kërkesës për energji. Së bashku, GIZ dhe FKEE kanë punuar në forcimin e kapaciteteve institucionale, zhvillimin e rregulloreve të brendshme dhe nxitjen e shkëmbimit të njohurive përmes vizitave studimore, duke siguruar që FKEE të operojë në mënyrë efektive dhe të maksimizojë ndikimin e tij në avancimin e investimeve në efiçencën e energjisë.

Ne e pranojmë që sfidat dhe mundësitë në sektorin e energjisë do të jenë të shumta, por efiçenca e energjisë dhe burimet e ripërtërishme të energjisë do të mbeten gurthemeli i sigurisë energjetike dhe rritjes ekonomike. GIZ mbetet e përkushtuar për ta vazhduar këtë udhëtim së bashku me FKEE-në dhe të gjithë palët e interesuara, duke kontribuar në zhvillimin e një të ardhmeje ku burimet energjetike përdoren me mençuri dhe në mënyrë të qëndrueshme.

Me këtë frymë, ne shprehim mirënjohjen tonë për përkushtimin dhe përpjekjet e palodhshme të ekipit të FKEE-së dhe të gjithë partnerëve me të cilët kemi bashkëpunuar. Kjo nuk është vetëm një arritje institucionale, por një sukses i përbashkët për një sektor energjetik më të fortë dhe më të qëndrueshëm në Kosovë.

Ne presim me padurim vazhdimin e këtij udhëtimi të përbashkët drejt një të ardhmeje më të gjelbër dhe një energjie më të pastër për Kosovën.

11.2 Mirënjohje për Donatorët dhe Bashkëpunëtorët

Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë shpreh mirënjohjen më të thellë dhe falënderimet më të sinqerta për donatorët, për mbështetjen e tyre të paçmuar dhe angazhimin në avancimin e iniciativave për eficiencën e energjisë në Kosovë.

Me kontributet e tyre, FKEE ka arritur përparime të rëndësishme në përmbushjen e misionit të tij për të promovuar praktika të qëndrueshme energjetike, për të reduktuar konsumin e energjisë dhe për të kontribuar në një të ardhme më të gjelbër dhe më të qëndrueshme për Kosovën dhe qytetarët e saj. Mbështetja e tyre ka mundësuar që të realizohen një sërë projektesh me ndikim, dhe jo vetëm në përmirësimin e eficiencës së energjisë, por gjithashtu edhe në sigurimin e përfitimeve afatgjata mjedisore, ekonomike dhe sociale.

FKEE është veçanërisht mirënjohës ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës për mbështetjen e saj dhe angazhimin e vazhdueshëm, duke siguruar një kuadër të fortë institucional për operacionet e FKEE-së. Po ashtu, FKEE vlerëson rolin kyç të donatorëve — Bashkimit Evropian, Bankës Botërore, GIZ-it, WBIF-it, LuxDev-it, BERZH-it, etj.

Ekspertiza dhe mbështetja e tyre financiare dhe teknike kanë qenë thelbësore për formësimin e suksesit të iniciativave të FKEE-së, duke e fuqizuar për të zbatuar zgjidhje inovative dhe për të tejkaluar sfidat.

Së bashku me donatorët dhe bashkëpunëtorët, FKEE ka siguruar që qytetarët e Kosovës të përfitojnë nga zgjidhje energjetike të qëndrueshme dhe të përballueshme, me ndikim afatgjatë për brezat e ardhshëm.

Për të arritur objektivat strategjike, bashkëpunimi me sektorin privat dhe palët e tjera të interesit mbetet thelbësor. Për këtë arsye, FKEE shpreh falënderime të veçanta edhe për:

- Komunitat e Kosovës,
- Koordinatorët e energjisë në komuna,
- Konsulentët,
- Kompanitë projektuese dhe mbikëqyrëse,
- Kompanitë zbatuese,
- Auditorët e energjisë,
- Institucionet publike të ndërlidhura,
- Mediat,
- Organizatat e shoqërisë civile.

Mbështetja dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me këta aktorë janë themeli i suksesit të FKEE-së, duke mundësuar zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të eficiencës së energjisë dhe avancimin drejt një të ardhmeje më të qëndrueshme për Kosovën.

12. Lista e shkurtesave të përdorura

FKEE	Fondi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë
AKEE	Agjensioni i Kosovës për Efiçencë të Energjisë
QK	Qeveria e Republikës së Kosovës
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
EBRD	European Bank for Reconstruction and Development
WBIF	Western Balkan Investment Framework
BGF	Balkan Green Foundation
GIZ	The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH
LuxDev	Agjensioni për Zhvillim i Luksemburgut
EE	Efiçenca e Energjisë
IPA	Instrument for Pre-accession Assistance
ME	Ministria e Ekonomisë
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
BD	Bordi i Drejtorëve
DM	Drejtori Menaxhues
ZKE	Zyrtari Kryesor Ekzekutiv
MEE	Masa për Efiçencë të Energjisë
MSHE	Marrëveshje për Shërbime të Energjisë
MAB	Multi Apartment Buildings
MeM	Memorandum Bashkëpunimi
MIP	Marrëveshje për Inicim të Projektit
MWh	Megavat orë
NSSHB	Ndërtesat Sociale Shumëbanesore
KESCO	Kompania Kosovare për Furnizim me Energji
PA	Marrëveshje Projekti (Project Agreement)
LEE	Ligji për Efiçencën e Energjisë
LMFPP	Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
kwh	Kilovat orë
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
OE	Operatori Ekonomik
AK	Autoriteti Kontraktues
OJQ	Organizata Jo Qeveritare

13. Përfundimi

Në përmbyllje të Raportit Vjetor 2024, Fondi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë reflekton mbi përparimin e arritur në promovimin dhe zbatimin e masave të efiçencës së energjisë në të gjithë vendin. Përkundër sfidave dhe dinamikave të sektorit energjetik, FKEE ka luajtur një rol kyç në krijimin e një mjedisi më të qëndrueshëm dhe më të vetëdijshëm për energjinë, duke kontribuar në reduktimin e konsumit, uljen e ndotjes dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë mjedisore.

Përmes investimeve të mirë-strukturuara, partneriteteve strategjike dhe zbatimit të programeve inovative, FKEE ka mundësuar ndryshime domethënëse në sektorin publik dhe rezidencial, duke sjellë përfitime të matshme si në aspektin energjetik, ekonomik dhe social. Projektet e implementuara jo vetëm që kanë garantuar kursime të konsiderueshme të energjisë, por gjithashtu kanë nxitur inovacion, hapje të vendeve të reja të punës dhe angazhim më të madh të komunitetit në përpjekjet për një të ardhme më të gjelbër.

Bashkëpunimi mes Fondit, institucioneve shtetërore, organizatave ndërkombëtare, mediave, shoqërisë civile dhe palëve të tjera të interesit ka qenë thelbësor në avancimin e agjendës për efiçencën e energjisë në Kosovë. Së bashku, janë vendosur themelet për një të ardhme më të gjelbër dhe më të qëndrueshme energjetike për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Duke parë përpara, FKEE mbetet i përkushtuar për të rritur përpjekjet, për të integruar teknologji të reja dhe për të mbështetur iniciativa që kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe në sigurimin e qëndrueshmërisë së sektorit energjetik të Kosovës. Sfidat e ardhshme janë të konsiderueshme, por përmes vizionit të qartë, inovacionit dhe një qasjeje të integruar, Kosova po ecën drejt një të ardhmeje më të qëndrueshme dhe efiçente në përdorimin e energjisë.

FKEE, Korrik 2025

Kontakti: Tel: +383 (0) 38 223 777;

E-mail: info@fkee-rks.net



FKEE

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË
KOSOVSKI FOND ZA ENERGETSKU EFIKASNOST
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR &

PAŠQYRAT FINANCIARE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2024

Prishtinë, Korrik 2025

Përmbajtja

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	1
DEKLARATË E PAJTUSHMËRISË	3
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZITËS FINANCIARE	4
PASQYRA E TË FITIMIT OSE HUMBJEVE TË ARDHURAVE TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	6
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	7
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE	8-26

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Drejtuar Bordit të Drejtorëve të Fondit i Kosovë për Eficiencë të Energjisë (FKEE)

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare Fondit i Kosovë për Eficiencë të Energjisë ("Fondi" ose "FKEE"), të cilat përfshijnë pasqyrën të pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2024, pasqyrën e të tepricës ose mungesës dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën të ndryshimeve në rezerva dhe pasqyrën të rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar me këtë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë politikat materiale kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit më 31 dhjetor 2024, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen në mënyrë më të detajuar në paragrafin '*Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*' në këtë raport. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me *Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Kontabilistët Profesionistë të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodin BSNEK)* së bashku me kërkesat etike që janë të rëndësishme për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Republikën e Kosovës, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe *Kodit BSNEK*. Ne besojmë së evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë.

Çështje tjetër

Pasqyrat financiare të Fondit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 janë audituar nga një auditor tjetër i cili ka lëshuar një opinion të pamodifikuar mbi ato pasqyra më 28 qershor 2024.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për ato kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Fondit për të vazhduar aktivitetin, duke i shpalosur, kur është e aplikueshme, çështjet në lidhje me vazhdimin e aktivitetit dhe përdorimin e kontabilitetit me parim të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon ta likujdojë Kompaninë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç se ta bëjë këtë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë evidencë të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa rreziku që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontrolleve të brendshëm
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Fondit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë nga menaxhmenti, në bazë të evidencave të auditimit të siguruar, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi parimin e vijimësisë të Fondit. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit për shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare ose nëse këto shpalosje janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte në të ardhmen mund të ndikojnë që Fondi të ndërpres veprimtarinë.
- Vlerësoni paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet themelore në një mënyrë që arrijnë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar për qeverisjen, përveçse çështjeve të tjera, edhe fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

RSM Kosovo Sh.p.k.

RSM Kosovo Sh.p.k.

Prishtina, Republika e Kosovës

16 qershor 2025




Sadik Berisha

Auditor Ligjor

Deklaratë e Pajtueshmërisë
Për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024

Bazuar në njohuritë tona më të mira, deklarojmë që pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024, paraqesin në mënyrë të drejtë dhe të vërtetë pozicionin financiar të Fondit, rezultatin e saj financiar dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në këtë datë në përputhje me kërkesat e SNRF.


Drejtori Menaxhues
Driton Hetemi


Kontabilist i Certifikuar
Nderim Basha


Drejtore e Sektorit të Financave
Ardita Haxhiaj

Prishtinë, 16 qershor 2025

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË (FKEE)

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2024

(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohet ndryshe)

	Shënimet	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	5	13,775,095	27,210,614
Depozitat me afat	6	4,710,016	-
Investimet financiare afatshkurtra	7	1,441,092	1,043,942
Asetet tjera	8	33,095	256,374
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		19,959,298	28,510,930
Pasuritë afatgjata			
Investimet financiare	7	9,659,040	8,447,625
Asetet e shtyra	8	2,201,326	2,558,099
Prona dhe pajisjet	9	139,982	52,847
Pasuritë e paprekshme		10,417	8,364
Gjithsej pasuritë afatgjata		12,010,765	11,066,935
GJITHSEJ PASURITË		31,970,063	39,577,865
DETYRIMET DHE REZERVAT			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Të ardhurat e shtyra	11	13,230,497	16,788,263
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	10	183,000	1,307,245
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		13,413,497	18,095,508
Detyrimet afatgjata			
Të ardhurat e shtyra	11	9,809,901	12,966,165
Gjithsej detyrimet afatgjata		9,809,901	12,966,165
GJITHSEJ DETYRIMET		23,223,398	31,061,673
REZERVAT			
Fondet e bartura		9,000,030	9,000,030
Mungesat e akumuluar		(253,365)	(483,838)
Gjithsej rezervat		8,746,665	8,516,192
GJITHSEJ REZERVAT DHE DETYRIMET		31,970,063	39,577,865

Shënimet shoqëruese në faqet 8 deri në 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Bordi i Drejtorëve më 16 qershor 2025 dhe janë nënshkruar në emër të tyre nga:


Drejtori Menaxhues
Driton Hetem


Kontabilist i Certifikuar
Nderim Basha


Drejtore e Departamentit të Financave
Ardita Haxhiaj

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË (FKEE)

Pasqyra e tepricës ose mungesës dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin 31 dhjetor 2024
(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohet ndryshe)

	Shënimet	Viti që përfundon më 31 dhjetor 2024	Viti që përfundon më 31 dhjetor 2023
FINANCIMET			
Të ardhura nga grantet	12	8,952,687	694,558
Të hyrat tjera	13	278,883	35,000
Gjithsej financimet		9,231,570	729,558
SHPENZIMET			
Shpenzimet e pagave	14	(536,038)	(326,492)
Shpenzimet operative	15	(8,216,215)	(365,469)
Humbjet nga rënia në vlerë	8	(231,552)	-
Shpenzimet e zhvlerësimit		(17,292)	(4,221)
Gjithsej shpenzimet		(9,001,097)	(696,182)
Tepriçë e fondeve të pranuar në raport me shpenzimet		230,473	33,376

Shënimet shoqëruese në faqet 8 deri në 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË (FKEE)

Pasqrya e ndryshimeve ne rezerva më 31 dhjetor 2024

(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohet ndryshe)

	Fondet e bartura	Mungesat e akumuluarra	Gjithsej
Me 1 janar 2023			
Gjendja me 1 janar 2023	4,000,030	(517,214)	3,482,816
Kontribute të fondeve shtesë	5,000,000	-	5,000,000
Teprica e fondve	-	33,376	33,376
Gjendja me 31 dhjetor 2023	9,000,030	(483,838)	8,516,192
Kontribute të fondeve shtesë	-	-	-
Teprica e fondve	-	230,473	230,473
Gjendja me 31 dhjetor 2024	9,000,030	(253,365)	8,746,665

Shënimet shoqëruese në faqet 8 deri në 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË (FKEE)

Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që perfundon me 31 dhjetor 2024

(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohet ndryshe)

Shënimi	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Tepriçë e fondeve të pranuar në raport me shpenzimet	230,473	33,376
Zhvlerësimi dhe amortizimi	17,292	4,221
Humbjet nga rënia në vlerë	231,552	-
	479,317	37,597
Ndryshime në pasuritë dhe detyrimet operative		
Rritje e investimeve afatshkurtra financiare	(397,150)	(503,873)
(Rritje)/Ulje e pasurive të tjera qarkulluese	(8,273)	238,899
Rritje e investimeve afatgjata financiare	(1,211,415)	(4,436,846)
Ulje/(Rritje) e pasurive të tjera joqarkulluese	356,772	(1,846,117)
(Ulje)/Rritje e detyrimeve tregtare dhe të tjera	(1,124,244)	802,446
Rrjedhë neto e parasë e përdorur në aktivitetet operative	(1,904,993)	(5,707,894)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Ndryshim në fondet e shtyra afatshkurtra	(3,557,766)	16,418,869
Ndryshim në fondet e shtyra afatgjata	(3,156,263)	8,164,041
Investimet në depozita me afat	(4,710,016)	-
Blerje e pasurive fikse dhe të paprekshme	(106,481)	(65,432)
Rrjedhë neto e parasë (e përdorur në)/e gjeneruar nga aktivitetet investuese	(11,530,526)	24,517,478
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Kontribut i fondeve shtesë	-	5,000,000
Rrjedhë neto e parasë e gjeneruar nga aktivitetet financuese	-	5,000,000
Ulje/(Rritje) neto në para dhe ekuivalentët e saj	(13,435,520)	23,809,584
Para dhe ekuivalentë të saj në fillim të vitit	27,210,614	3,401,030
Para dhe ekuivalentë të saj në fund të vitit	13,775,095	27,210,614

Shënimet shoqëruese në faqet 8 deri në 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGISË (FKEE)

Shënimet për pasqyrat financiare

(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohen ndryshe)

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE) është themeluar si një entitet i pavarur, autonom dhe i qëndrueshëm, në mbështetje të objektivave të politikave të Republikës së Kosovës për eficiencën e energjisë, duke nxitur, mbështetur dhe zbatuar masa të eficiencës së energjisë, si dhe duke tërhequr dhe menaxhuar burime financiare në mënyrë që të financojë dhe zbatojë projekte investive në fushën e eficiencës së energjisë në mënyrë të qëndrueshme. Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë është regjistruar me Nr. Fiskal 602200066 me datën 27 shtator 2019 në Administratën Tatimore të Kosovës.

Sipas Ligjit për Eficiencë të Energjisë me nr. 06/L-079, FKEE është themeluar si person juridik i pavarur, autonom dhe i qëndrueshëm jofitimprurës dhe do të shërbejë si financuesi kryesor për masat e eficiencës së energjisë (EE). Sipas Ligjit për Eficiencë të Energjisë nr. 06/L-079 (LEE), FKEE funksionon në përputhje me ligjet e Republikës së Kosovës. Megjithatë, në rastin e përdorimit të fondeve në bazë të Marrëveshjeve Ndërkombëtare të Financimit (IFA), FKEE operon në përputhje me rregullat dhe kushtet e aplikueshme për implementimin e marrëveshjeve të tilla që në këtë rast mbizotërojnë legjislacionin lokal për përdorimin e këtyre fondet (neni 33.1).

- Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE)
- Adresa: Ish Banka e Lubjanës, Kati 7, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës
- Drejtor Menaxhues: Driton Hetemi
- Numër telefoni: 038 223 777
- Detajet e kontaktit: info@fkee-rks.net

Qeverisja dhe struktura organizative

Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë është themeluar si person juridik i pavarur, autonom dhe i qëndrueshëm jofitimprurës, në shërbim të interesit publik. FKEE ka personalitet të plotë juridik dhe identitet juridik që është i ndarë dhe i dalluar nga organet qeverisëse dhe ekzekutive që janë Bordi i Drejtorëve dhe Drejtuesit e FKEE.

FKEE ka autonomi të plotë funksionale dhe administrative dhe funksionon jashtë kornizës së strukturave qeveritare të Kosovës dhe Shërbimit Civil të Kosovës, dhe nuk konsiderohet si organizatë buxhetore në kuptim të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Ligji për Ndarjet Buxhetore të Republikës së Kosovës (Neni 25.4). FKEE ka të drejtë të kontraktojë, të padisë dhe të paditet në emrin e vet, administron pasuritë e veta, të investojë në projekte të eficiencës së energjisë dhe t'i merr kthimet në investime, të pranojë dhe të jep grante dhe donacione dhe instrumente të tjera financiare për t'i arritur objektivat e veta, siç përcaktohet me ligj (Neni 25.3).

Objektivat kryesore

FKEE synon zhvillimin, avancimin dhe zgjerimin e mekanizmave më inovativ të financimit, siç janë marrëveshjet e shërbimit të energjisë (MShE) dhe instrumentet tjera financiare, për t'i financuar projektet e dakorduara të EE në sektorin publik dhe rezidencial.

FKEE për dhe gjatë zbatimit të masave EE përmes MSHE-ve siguron një paketë të shërbimit të plotë - auditimin e energjisë, dizajnin teknik, prokurimin dhe mbikëqyrjen e kontraktuesve, masat mbrojtëse mjedisore dhe sociale, matjen dhe raportimin e kursimit të energjisë. Duke qenë skemë financimi qarkulluese, komuna do të pranojë t'i kthejë (ri-paguajë) kursimet e kostos së energjisë të arritur për një periudhë të dakorduar në MShE (deri në 15 vjet). Deri në fund të vitit 2024 FKEE ka zbatuar në tërësi tetëdhjetë e katër (84) projekte në sektorin publik të nivelit lokal, dhe është në zbatim të dy (2) projekteve të ngjashme.

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERJISË (FKEE)

Shënimet për pasqyrat financiare

(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohen ndryshe)

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME (VAZHDIM)

Objektivat kryesore (vazhdim)

Ndërkaq, në fund të vitit 2024 ka nënshkruar shtatëmbëdhjetë (17) projekte të reja të MSHE-ve për zbatimin e masave EE në ndërtesa komunale, të cilat për herë të parë janë shoqëruar me një tarifë për menaxhimin e projekteve për t'i mbuluar kostot e financimit, operimit dhe përgatitjes së projektit (p.sh. auditimet e energjisë, dizajnet teknike), dhe kontribuojnë për një zbatim të qëndrueshëm deri në përfundimin e projektit.

Përveç zhvillimit dhe përdorimit të instrumentit të MShE-ve për EE në ndërtesat publike, FKEE synon përmirësimin e EE edhe në sektorin rezidencial duke zhvilluar modalitete dhe thirrje publike dedikuar qytetarëve, veçanërisht për i) shtëpitë individuale dhe ii) ndërtesa shumë banesore sociale në pronësi komunale. Kriteret, kushtet dhe përcaktimi i modaliteteve për sektorin rezidencial janë përgatitur nga grupi punues me përfaqësues të FKEE, Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës si dhe dy OJQ-ve. Fondet që përdoren për zbatimin e këtyre projekteve, në vlerë gjithsej 20 milionë Euro janë siguruar nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit të IPA III, Pakos së Mbështetjes për Energji të aranzhuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Këto mjete jepen pa kthim për komunën dhe qytetarin, për dallim nga mekanizmi i deritashëm i FKEE.

Në kuadër të sektorit rezidencial, FKEE në fund të vitit 2024 ka nënshkruar njëzet e pesë (25) marrëveshje të bashkëfinancimit (MAB) me dymbëdhjetë (12) komuna për shërbimet e energjisë për zbatimin e masave EE në objektet shumë-banesore të banimit social në pronësi komunale, ku FKEE ofron një paketë të shërbimit të plotë - auditimin e energjisë, dizajnin teknik, prokurimin dhe mbikëqyrjen e kontraktuesve, masat mbrojtëse mjedisore dhe sociale, matjen dhe raportimin e kursimit të energjisë. Ky lloj i financimit përfshinë investimin prej 90% nga FKEE pa kthim nga komuna si dhe vetëm 10% pjesëmarrje nga komuna. Gjithashtu, në kuadër të sektorit rezidencial, FKEE përgjatë vitit 2024 ka vazhduar subvencionimin e qytetarëve nga Thirrja e Parë Publike e vitit 2023, si dhe ka përgatitur dhe shpallur Thirrjen e Dytë Publike për subvencionimin e masave EE në shtëpitë individuale.

Parimet kryesore të FKEE bazohen në praktikat e mëparshme në kuadër të Projektit të Bankës Botërore për Eficiencë në Energji dhe Energji të Rinovueshme (PKEEER) duke zgjeruar aspektet kryesore të mëposhtme për të ndihmuar në rritjen e shkallëzimit dhe qëndrueshmërisë:

- Zhvillimi dhe implementimi sistematik i modeleve të financimit qarkullues që demonstrojnë konceptin e përdorimit të kursimeve të kostos së energjisë për t'i kthyer investimet në EE dhe për ta prezantuar një zhvendosje strategjike larg financimit të EE me grante;
- Forcimi i përfshirjes së Mbrojtjes së Mjedisit dhe Fondeve për EE për të ndërtuar kapacitete afatgjata në ofrimin dhe realizimin e modeleve të shkallëzueshme të financimit për EE dhe për ta lehtësuar replikimin e skemave të financimit qarkullues;
- Përkrahja e zhvillimit të aranzhimeve që mund të lejojnë mbajtjen e investimeve në EE përtej projektit;
- Krijimi i mjedisit për të kaluar në më shumë solucione komerciale të financimit; dhe,
- Financimi i EE të siguruar nga partnerët tjerë për zhvillim.

Si prioritet i parë, Fondi fokusohet në Ndërtesat Publike Komunale dhe Sistemet Komunale të Ndriçimit Rrugor, në pronësi ose përdorim, operim/mirëmbajtje dhe faturat e energjisë paguhen nga komunat. Pritet që projektet e tilla të gjenerojnë kursime të dukshme të kostos së energjisë dhe bashkë-përfitime sociale (p.sh., përmirësim i temperaturës dhe komoditetit në ambiente të mbyllura, cilësi më e mirë e ajrit të brendshëm dhe ulje e ndotjes lokale/globale).

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË (FKEE)

Shënimet për pasqyrat financiare

(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohen ndryshe)

2. PASQYRA E PAJTUESHMERSIE

Pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi të Kosovës si dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të aplikueshme në Kosovë.

3. BAZA E PËRGATITJES DHE POLITIKAT KRYESORE KONTABËL

Këto Pasqyra Financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e matjes që specifikohen nga SNRF për secilin lloj pasurie, detyrimi, të ardhurash dhe shpenzimesh. Bazat e matjes janë përkrahur me hollësisht në Shënimin më poshtë.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon nga drejtuesit të bëjnë vlerësime, llogaritje dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe në shumën e raportuar të pasurive, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet bazë rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën bëhet rishikimi dhe në periudhat e ardhshme që ndikohen.

3.1 Parimi i vijimësisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të vazhdimësisë së veprimtarisë dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"), të cilat janë standarde dhe interpretime të lëshuara nga Bordit Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit ("SNKB").

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e matjes që specifikohen nga SNRF për secilin lloj pasurie, detyrimi, të ardhurash dhe shpenzimesh.

Sa i përket vazhdimësisë së veprimtarive operative, financimi i FKEE-it është i qëndrueshëm dhe është zgjatur deri në fund të vitit 2025 për realizimin e projekteve të kontraktuara në komunat e Kosovës. Nuk ekziston ndonjë rrezik që vë në dyshim parimin e vazhdimësisë.

3.2 Valuta e këmbimit

Të dhënat aktuale të shprehura në këto pasqyra janë të shprehura në valutën euro (€).

Çfarëdo lloj përfitimesh apo humbesh, që kanë të bëjnë me harmonizimin e shumave, të pagueshme ose të arkëtueshme, njihen në pasqyrën e të ardhurave.

Periudha raportuese e FKEE-së përfshinë një periudhë dymbëdhjetë mujore pra 1 janar deri më 31 dhjetor të çdo viti.

Monedha raportuese e Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë është njësia monetare e Unionit Evropian (Euro) njëherësh edhe përdorimi i kësaj valute në vendin tonë, e aprovuar nga Qeveria e Kosovës së bashku me Bankën Qendrore të Kosovës. Transaksionet e valutës së huaj konvertohen duke përdorur normën valide të këmbimit në datën e transaksionit.

3.3 Instrumentet financiare

Fondi fillimisht njihet arkëtimet dhe depozitat në para në datën kur ato kanë ndodhur. Të gjitha pasuritë e tjera financiare njihen fillimisht në datën e ndodhjes në të cilën Fondi bëhet palë në provizionet kontraktuale të instrumentit. Fondi çregjistron një aset financiar kur skadojnë të drejtat e kontratës për të gjeneruar rrjedhje të parave nga asteti, ose ai transferon të drejtat për të marrë rrjedhjet monetare kontraktuale në asetin financiar në një transaksion në të cilin në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë financiare.

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË (FKEE)

Shënime për pasqyrat financiare

(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohen ndryshe)

3. BAZA E PËRGATITJES DHE POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3.3 Instrumentet financiare (vazhdim)

të asetit transferohet. Çfarëdo interesi në asetet financiare të transferuara që është krijuar ose mbajtur nga Fondi njihet si një aset ose detyrim i veçantë. Asetet dhe detyrimet financiare janë kompensuar dhe shuma neto e paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur, Fondi ka të drejtë ligjore të kompensojë shumat dhe synon ose të shlyejë në bazë neto, ose të realizojë asetin dhe të shlyejë përgjegjësinë njëkohësisht.

Instrumentet financiare jo-derivativë të Fondit përbëhen nga paratë dhe ekuivalentë të parave të gatshme, të arkëtueshmet, asete të tjera, të pagueshme ndaj palëve të lidhura, të pagueshmet dhe detyrimet e tjera.

Investimet financiare

Investimet financiare përfaqësojnë kërkesat afatgjata të dhëna komunave sipas skemave të kthimit që shtrihen deri në 15 vjet. Këto investime njihen fillimisht me vlerën e tyre të drejtë (fair value), që korrespondon me vlerën aktuale të rrjedhave të ardhshme të pritshme të parasë, të diskontuara me një normë interesi tregu që pasqyron vlerën kohore të parasë dhe rrezikun kreditor. Më pas, investimet financiare matën në koston amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit (EIR), e cila alokon shumën e investimit gjatë periudhës së kthimit për të reflektuar vlerën e tij ekonomike reale.

Asetet e shtyera

Asetet e shtyra përfaqësojnë ndryshimin midis shumës nominale të investimit dhe vlerës së tij aktuale (prezent) si pasojë e efektit të diskontimit të kushteve afatgjata të kthimit. Këto shuma njihen në bilanc dhe rregullohen me kalimin e kohës për të reflektuar amortizimin e diskontit.

Matja dhe njohja

- Në njohjen fillestare, investimi i plotë regjistrohet në vlerën aktuale (prezente) të kthimeve të ardhshme të pritshme.
- Kthimet e marra nga komunat ulin në përputhje me to shumën e mbartur të investimit financiar.
- Vlerësimet për rënie në vlerë (impairment) kryhen në përputhje me standardet përkatëse të raportimit financiar, për të pasqyruar çdo rrezik krediti ose humbje të pritshme.

Shpalosje

Pasqyrat financiare përfshijnë shpalosje mbi klasifikimin e investimeve financiare dhe pasurive të shtyra, supozimet dhe metodat e përdorura për përcaktimin e vlerës aktuale dhe diskontimit, si dhe politikat e aplikuara për matjen dhe rregullimin e mëtejshëm të këtyre pasurive.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e saj përbëhet nga paratë në bankë dhe në dorë. Për qëllimet e fluksit të mjeteve monetare, paraja dhe ekuivalentët e saj përbëhet nga paratë në dorë dhe paratë e gatshme të mbajtura me bankat, përfshirë depozitat me afat maturimi tre muaj ose më pak.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera nuk mbartin ndonjë interes dhe shprehen në vlerën e tyre nominale, të zvogëluara nga lejimet e duhura për shumat e llogaritshme si të pakthyeshme. Shumat e vlerësuara si të pakthyeshme bazohen në vjetërsinë e llogarive të arkëtueshme dhe përvojën historike.

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera

Llogaritë dhe detyrimet e tjera fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË (FKEE)

Shënimet për pasqyrat financiare

(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohen ndryshe)

3. BAZA E PËRGATITJES DHE POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3.3 Instrumentet financiare (vazhdim)

Metoda e interesit efektiv

Metoda efektive e interesit është një metodë e llogaritjes së kostos së amortizuar të një instrumenti borxhi dhe shpërndarjes së të ardhurave nga interesi për periudhën përkatëse. Norma efektive e interesit është norma që saktësisht zbrit arkëtimet e vlerësuar në të ardhmen (përfshirë të gjitha tarifat dhe pikat e paguara ose të pranuar që përbëjnë një pjesë integrale të normës efektive të interesit, kostot e transaksionit dhe primet e tjera ose zbritjet) përgjatë jetës së pritshme të instrumentit të borxhit, ose, kur është e përshtatshme, një periudhë më e shkurtër, në vlerën kontabël neto të njohjes fillestare.

Vlera e drejtë

Vlera e drejtë e vlerësuar e ekuivalentëve monetarë, llogarive të arketueshme, llogarive të pagueshme dhe kredive janë të ngjashme me vlerën neto të librit.

3.4 Grantet qeveritare

Grantet, duke përfshirë grantet jo monetare me vlerën e drejtë, njihen vetëm kur ka siguri të arsyeshme se:

- njësia ekonomike do të përmbushë kushtet që i bashkëngjiten; dhe
- do të merren grantet. Marrja e një granti në vetvete nuk siguron dëshmi përfundimtare se kushtet që i bashkëngjiten grantit janë përmbushur ose do të përmbushen.

Grantet do të njihen në fitim ose humbje në mënyrë sistematike gjatë periudhave në të cilat entiteti njihet si shpenzime kostot përkatëse për të cilat grantet janë destinuar të kompensojnë.

Një grant njihet vetëm kur ekziston siguri e arsyeshme që kushtet e bashkëngjitura grantit do të përmbushen dhe se ai do të pranohet.

Granti njihet si i pranuar gradualisht gjatë periudhës së nevojshme për t'i përputhur me kostot përkatëse që synon të kompensojë, në mënyrë sistematike.

Nëse një grant bëhet i kthyeshëm, ai duhet të trajtohet si një ndryshim në vlerësim. Kur grantimi origjinal lidhet me të ardhura, kthimi duhet të aplikohet së pari kundrejt çdo bilanci të kredisë së shtyrë që nuk është amortizuar, dhe çdo shumë shtesë duhet të trajtohet si shpenzim. Kur granti fillestar lidhet me një pasuri, kthimi duhet të trajtohet si një rritje e shumës së mbartur të pasurisë ose si një ulje e bilancit të të ardhurave të shtyra. Amortizimi i akumuluar që do të ishte ngarkuar nëse granti nuk do të ishte pranuar duhet të ngarkohet si shpenzim.

Një grant që merret si kompensim për kostot që janë kryer tashmë ose për mbështetje financiare të menjëhershme, pa kosto të ardhshme të lidhura, duhet të njihet si të ardhura në periudhën në të cilën është i pranuar. Përfitimi i një granti me normë të ulët interesi tregu trajtohet si një grant qeveritar, i matur nga diferenca midis shumës së pranuar dhe vlerës së drejtë të kredisë bazuar në normat aktuale të interesit në treg.

FKEE nuk ka pranuar ndonjë subvencion nga Ministria e Ekonomisë gjatë vitit 2024 (2023: 5 milionë EUR) për të mbuluar shpenzimet operative nën kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transferime", për periudhën e mbulimit të shpenzimeve operative dhe projekteve në vazhdim në llogarinë e tij bankare. Njohja e granteve nga Qeveria e Kosovës nga Fondi njihet përmes qasjes kapitaliste e cila njihet në kohën e ndodhjes.

FKEE mban llogaritë kryesore rrjedhëse dhe llogari të ndryshme në banka nën NLB Bank dhe PCB Bank.

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË (FKEE)

Shënime për pasqyrat financiare

(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohen ndryshe)

3. BAZA E PËRGATITJES DHE POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3.4 Grantet qeveritare (vazhdim)

Procedura për disbursimin e Fondeve të Grant-it bëhet sipas udhëzimeve në fuqi përmes personave të autorizuar për qasje, aplikim i cili përmes Ministrisë së Financave procedohet tek zyra e Bankës Botërore.

Të hyrat në nën llogarinë bankare për Fondet e Grantit pranohen duke aplikuar përmes sistemit të Bankës Botërore (Client Connection), me vlerë maksimale deri në 1,000,000 euro (një milion euro). Për çdo kërkesë për disbursim të Grantit në llogarinë bankare të FKEE-së duhet të arsyetohen shpenzimet deri në datën e aplikimit për fonde shtesë.

Prezantimi i granteve lidhur me asetet

Grantet që lidhen me asetet, duke përfshirë grantet jomonetare me vlerën e drejtë, do të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar ose duke vendosur grantin si të ardhura të shtyra ose duke zbritur grantin për të arritur vlerën kontabël të asetit.

3.5 Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paratë dhe ekuivalentët e parave paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar me kosto. Për qëllimet e pasqyrës së rrjedhës së parave, "paratë" përfshijnë paratë në arkë dhe depozitat në llogari rrjedhëse (në kërkesë).

3.6 Përfitimet e punëtorëve

Më 31 Dhjetor 2024, Fondi për Eficiencë të Energjisë në Kosovë (FKEE) kishte të punësuar gjithsej 35 persona (2023: 23). Prej tyre, 20 punonjës (2023: 12) paguhen nga llogaria e kontributit të Qeverisë. ndërkaq, 12 punonjës (2023: 11) paguhen përmes llogarisë së Grantit.

FKEE ka Bordin e Drejtorëve si organin kryesor drejtues, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e përgjithshme të veprimtarisë së FKEE-it. Bordi përbëhet nga shtatë (7) anëtarë (5 janë me të drejtë vote): një (1) përfaqësues i emëruar nga Ministria e Ekonomisë, një (1) nga Ministria e Financave, një (1) nga Ministria e Administratës Publike (tani Ministria e Punëve të Brendshme), një (1) përfaqësues i emëruar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, një (1) Drejtori Menaxhues i FKEE-it, dhe (2 janë pa të drejtë vote): një (1) nga Banka Botërore (BB), një (1) nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë (BE).

Fondi ka kryer pagesat në emër të punonjësve, si dhe kompensimin për pjesëmarrje në mbledhjet e Bordit të Drejtorëve për anëtarët me të drejtë vote, për kontributet pensionale dhe tatimin në të ardhurat personale, të cilat llogariten bazuar në pagat bruto sipas legjislacionit në fuqi. Përfaqësuesit e donatorëve (BB, BE) si anëtarë pa të drejtë vote nuk kompensohen nga FKEE. Këto shpenzime ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave për periudhën përkatëse.

3.7 Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në momentin e kryerjes së shërbimit ose në datën e faturimit.

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË (FKEE)

Shënime për pasqyrat financiare

(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohen ndryshe)

3. BAZA E PËRGATITJES DHE POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3.8 Burimet e financimit

Burimet e financimit të FKEE përfshijnë: financimin fillestar të Fondit për themelimin dhe mbulimin e shpenzimeve gjatë viteve të para të funksionimit, deri në momentin kur Fondi arrin vetëqëndrueshmëri të plotë. Fondet fillestare përdoren për të mbuluar shpenzimet operative dhe investime. Fondet fillestare mund të sigurohen nga Buxheti i Shtetit, ndihma nga donatorët, huatë ose nga një kombinim i dy apo më shumë burimeve. Në vitin 2023, Qeveria kontribuoi me një injektim fondesh në vlerë prej 5 milionë eurosh për të mbuluar shpenzimet operative dhe për të mbështetur zhvillimin e projekteve ekzistuese dhe atyre të reja. Gjatë vitit 2024 nuk janë pranuar kontribute financiare nga Qeveria.

3.9 Qiraja

Fondi operon në hapësirat e ndërtesave publike të menaxhuara nga Ministria e Punëve të Brendshme, e cila i ka dhënë në shfrytëzim FKEE-së hapësirat në fund të muajit Mars 2020. Selia dhe administrata e FKEE gjendet në ndërtesën e vjetër të Bankës së Lubjanës, kati 7 (shtatë). FKEE nuk paguan qira për hapësirat publike të cilat i shfrytëzon aktualisht.

3.10 Klasifikimi afatshkurtër dhe afatgjatë

Pasuritë dhe detyrimet janë paraqitur në pasqyrën e pozitës financiare duke u bazuar në klasifikimin afatshkurtër dhe atë afatgjatë.

Pasuria afatshkurtër klasifikohet atëherë kur prej saj pritet ndonjë realizim, ose qëllimi i saj është për tu shitur ose konsumuar në ciklin normal operativ, mbahet për qëllime primare tregtare, pritet të realizohet brenda 12 muajve pas periudhës raportuese, ose pasuria është paraja apo ekuivalenti i parasë përveç nëse ndalohet për tu këmbyer apo përdorur për kryerjen e ndonjë detyrimi më së paku 12 muaj pas periudhës raportuese. Të gjitha pasuritë e tjera konsiderohen afatgjate.

Një detyrim klasifikohet si afatshkurtër kur pritet të kryhet në ciklin normal operativ: mbahet për qëllime primare të tregtimit, pritet të kryhet brenda 12 muajve pas periudhës raportuese; ose nuk ka të drejtë të pakushtëzuar për ta shtyrë kryerjen e detyrimit për më së paku 12 muaj pas periudhës raportuese. Të gjitha detyrimet tjera klasifikohen si afatgjata.

3.11 Prona dhe pajisjet

Prona dhe pajisjet paraqiten në koston minus zhvlerësimin e akumuluar dhe çfarëdo humbje tjetër të akumuluar nga dëmet.

Kur një pronë dhe pajisje përbëjnë komponentë të mëdha që kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si prona dhe pajisje të veçanta. Shpenzimet e mëvonshme kapitalizohen nëse në të ardhmen do të ketë përfitime ekonomike nga ai shpenzim. Të gjitha shpenzimet tjera, duke përfshirë riparimin dhe mirëmbajtjen njihen në pasqyrat e të hyrave gjithëpërfshirëse në momentin kur ndodhin. Zhvlerësimi bëhet sipas metodës lineare gjatë jetës së dobishme të pasurisë.

Fitimet dhe humbjet nga heqja e përdorimit përcaktohet duke krahasuar të hyrat nga shitja me vlerën e bartur, të cilat po ashtu duhet të përfshihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse. Zhvlerësimi llogaritet me metodën lineare me norma të cilat përafrojnë me jetën mesatare ekonomike të dobishme të aktivitetit. Jetët e dobishme të pritshme për periudhën korrente dhe atë krahasuese janë si vijon:

- Pajisje IT - 4 vite
- Automjetet - 7 vite
- Ndërtesa - 40 vite

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË (FKEE)

Shënime për pasqyrat financiare

(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohen ndryshe)

3. BAZA E PËRGATITJES DHE POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3.12 Provizionet

Një provizion njihet kur Fondi, si pasojë e ngjarjeve të shkuara ka një detyrim aktual, ligjor ose strukturor, që mund të matet në mënyrë të besueshme dhe është e mundshme që do të nevojitet një fluks dalës të mirash ekonomike për të shlyer detyrimin. Provizionet llogariten duke diskontuar flukset e ardhshme monetare me një normë përpara tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit.

3.13 Zbatimi i ndryshimeve në standardet ekzistuese në fuqi për periudhën raportuese

i) Standardet dhe interpretimet në fuqi gjatë periudhës aktuale

Gjatë vitit aktual, Fondi ka zbatuar një numër ndryshimesh në Standardet e Kontabilitetit të SNRF të lëshuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (SNKB), të cilat janë detyruesisht në fuqi për periudhën kontabël që fillon më 1 janar 2024 ose më pas. Zbatimi i tyre nuk ka pasur ndikim material në shpalosjet apo shumat e raportuara në këto pasqyra financiare. Ndryshimet e reja në standardet ekzistuese, të lëshuara nga SNKB dhe që janë në fuqi për periudhën aktuale raportuese, përfshijnë:

- **Ndryshimet në SNK 1** – Paraqitja e Pasqyrave Financiare: Klasifikimi i Detyrimeve si Afatshkurtra ose Afatgjata, si dhe ndryshimet në SNK 1 lidhur me Detyrimet Afatgjata me Kushte.
- **Ndryshimet në SNK 7** – Pasqyra e Rrjedhës së Parasë dhe në SNRF 7 – Instrumentet Financiare: Shpalosjet, në lidhje me marrëveshjet e financimit me furnitorë.
- **Ndryshimet në SNRF 16** – Qiratë: Detyrimi për qira në një shitje dhe marrje me qira pasuese.

Zbatimi i këtyre ndryshimeve në standardet ekzistuese dhe interpretimet nuk ka sjellë ndonjë ndryshim material në pasqyrat financiare të ndërmarrjes.

ii) Standardet dhe interpretimet që nuk janë në fuqi për periudhën aktuale

Në datën e miratimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet në vijim, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja ishin në qarkullim, por ende nuk kishin hyrë në fuqi ose nuk ishin miratuar paraprakisht nga Fondi:

- **Ndryshimet në SNK 21** – Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit Valutor: Mungesa e Këmbyeshmërisë.
- **Ndryshimet në SNRF 9 dhe SNRF 7** – Ndryshimet në Klasifikimin dhe Matjen e Instrumenteve Financiare.
- **Ndryshimet në SNRF 9 dhe SNRF 7** – Kontratat që Referojnë Energjinë Elektrike të Varur nga Natyra.
- **Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 7, SNRF 9, SNRF 10 dhe SNK 7** – Përmirësime Vjetore në Standardet e Kontabilitetit të SNRF – Vëllimi 11.
- **SNRF 18** – Paraqitja dhe Shpalosjet në Pasqyrat Financiare.
- **SNRF 19** – Filialet pa Përgjegjësi Publike: Shpalosjet.
- **SNRF 14** – Llogaritë e Shtyra Rregullative.
- **Ndryshimet në SNRF 10** – Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe në SNK 28 – Investimet në Shoqëri të Lidhura dhe Sipërmarrje të Përbashkëta: Shitja ose Kontributi i Pasurive midis një Investitori dhe Shoqërisë së tij të Lidhur ose Sipërmarrjes së Përbashkët.

Fondi ka zgjedhur të mos i zbatojë këto standarde, ndryshime dhe interpretime të reja përpara datës së hyrjes së tyre në fuqi dhe aktualisht është duke analizuar ndikimin që mund të kenë në periudhën kur do të zbatohen për herë të parë.

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË (FKEE)

Shënime për pasqyrat financiare

(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohen ndryshe)

4. VLERËSIMET DHE GJYKIMET KRITIKE KONTABËL

Fondi përgatit pasqyrat e saj financiare në përputhje me SNRF, zbatimi i të cilave shpesh kërkon që gjykimet të bëhen nga menaxhmenti kur formulon pozicionin financiar dhe rezultatet e fondit. Sipas SNRF, menaxhmentit i kërkohet që të miratoj ato politika kontabël më të përshtatshme me rrethanat e Fondit me qëllim të paraqitjes së drejtë të pozicionit financiar të Fondit, performancës financiare dhe flukseve të parave.

Në përcaktimin dhe aplikimin e politikave kontabël, gjykimi shpesh kërkohet në lidhje me zërat ku zgjedhja e politikës specifike, vlerësimi i kontabilitetit ose supozimi që do të ndiqet mund të ndikoj në mënyrë materiale rezultatet e raportuara ose pozicionin neto të pasurisë së Fondit, nëse më vonë përcaktohet se një tjetër zgjidhje do të jetë më e përshtatshme.

Menaxhmenti konsideron vlerësimet e kontabilitetit dhe një supozim të diskutuar më poshtë si vlerësime kritike dhe, në përputhje, ofron një shpjegim të secilës më poshtë.

Informacioni në lidhje me fushat e rëndësishme të pasigurisë dhe vlerësimit kritik në aplikimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumën e njohur në pasqyrat financiare janë të përshkruara në paragrafët vijues, si dhe në shënime vijuese:

Vlerësimet që lidhen me faktorët e diskontimit dhe vlerësimin e investimeve

Menaxhmenti aplikon vlerësime dhe gjykime kyçe në përcaktimin e vlerës kontabël të investimeve financiare, në veçanti:

- *Faktori i diskontimit:* Përdoret për të llogaritur vlerën aktuale të kërkesave afatgjata, duke reflektuar vlerën e parasë në kohë, rrezikun e kreditor dhe afatet e kthimit.
- *Vlerësimi i investimeve:* Bazohet në flukset e pritshme të ardhshme të parasë, të diskontuara me normën e vlerësuar të diskontimit.

Këto vlerësime rishikohen dhe përditësohen rregullisht, sipas nevojës, për të siguruar paraqitjen e saktë të vlerës së drejtë të investimeve.

Provizioni për rënien në vlerë të llogarive të arkëtueshme

Në rrjedhën normale të operimit të aktivitetit, Fondi bën vlerësime për rikuperimin dhe realizimin e llogarive të arkëtueshme. Bazuar në këtë vlerësim, menaxhmenti regjistron një provizion të përshtatshëm për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimi.

Jetëgjatësia e pronës, impianteve dhe pajisjeve

Menaxhmenti i Fondit rishikon jetëgjatësinë e pronës dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportuese.

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË (FKEE)

Shënimet për pasqyrat financiare

(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohen ndryshe)

5. PARATË DHE EKVIVALENTËT E PARASË

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paratë që entiteti i ka të depozituara në bankë.

Gjendja e parasë siç janë pasqyruar në bilancin e gjendjes në këtë notë është si vijon:

	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
Paraja në bankë		
Llogaritë rrjedhëse	2,790,095	18,210,614
Llogaritë e kursimit	10,985,000	9,000,000
Gjithsej	13,775,095	27,210,614

Llogaritë e kursimeve në bankat komerciale bartin një interes vjetor prej 1% dhe janë lehtësisht të konvertueshme në ekuivalentë të parasë.

6. DEPOZITAT ME AFAT

	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
Depozitat me afat	4,700,000	-
Interesi aktual	10,016	-
Gjithsej	4,710,016	-

Depozitat me afat mbahen në bankat komerciale dhe kanë një normë interesi vjetore prej 3%, me maturim në qershor 2025.

7. INVESTIMET FINANCIARE

Investimet financiare paraqesin shumën e investimeve në objekte komunale për të cilën Fondi pret që të kthehet investimi përmes mekanizmit qarkullues të FKEE-së sipas marrëveshjeve me komunat ("Marrëveshjet e Shërbimit të Energjisë"-MSHE) për një periudhë rreth 15 vite. Kthimi i investimit përfshinë Komponentën 1 "Efiçienca e energjisë dhe energjia e ripërtëritshme në ndërtesat publike", dhe Komponentën 2 "Studime Teknike dhe Mbikëqyrja", të cilat janë paraqitur si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
Të arkëtueshmet nga Komunat	11,100,132	9,491,567
Lejimet për të arkëtueshmet e dyshimta	-	-
Gjithsej	11,100,132	9,491,567
Pjesa rrjedhëse (afatshkurtër)	1,441,092	1,043,942
Pjesa jo-rrjedhëse (afatgjatë)	9,659,040	8,447,625
Gjithsej	11,100,132	9,491,567

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË (FKEE)

Shënime për pasqyrat financiare

(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohen ndryshe)

7. INVESTIMET FINANCIARE (VAZHDIM)

Të arketueshmet nga Komunat për vitin 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë paraqitur si në vijim:

Komuna	Më pak se 12 muaj		Më shumë se 12 muaj		Gjithsej	
	2024	2023	2024	2023	2024	2023
Mitrovicë	365,642	186,444	1,967,382	1,634,192	2,333,024	1,820,636
Malishevë	154,478	128,624	1,364,160	1,419,426	1,518,638	1,548,050
Rahovec	122,365	59,802	992,860	951,329	1,115,225	1,011,131
Gjakovë	69,680	45,603	955,064	495,832	1,024,744	541,435
Drenas	130,406	88,753	872,537	910,466	1,002,943	999,219
Istog	59,120	66,315	717,997	740,893	777,117	807,208
Podujevë	95,176	58,636	639,795	653,336	734,971	711,972
Gjilan	52,123	72,513	611,705	654,035	663,828	726,548
Prizren	32,640	11,639	549,376	361,371	582,016	373,010
Ferizaj	85,712	56,651	525,549	558,857	611,261	615,508
Skenderaj	49,870	57,888	462,339	481,867	512,209	539,755
Kamenicë	41,288	35,255	428,916	446,366	470,204	481,621
Novoberdë	23,997	31,877	312,533	330,856	336,530	362,733
Shtime	7,167	31,802	309,350	310,675	316,517	342,477
Klinë	29,739	19,391	294,271	282,192	324,010	301,583
Viti	61,240	38,971	282,467	271,805	343,707	310,776
Pejë	36,920	7,048	259,470	195,683	296,390	202,731
Vushtrri	11,459	15,279	156,612	170,729	168,071	186,008
Deçan	30,346	27,327	62,593	56,058	92,939	83,385
Mamushë	3,996	9,970	40,509	43,988	44,505	53,958
Suhareke	-	-	17,748	-	17,748	-
Hani Elezit	9,815	16,620	16,072	19,854	25,887	36,474
Ranillug	1,008	2,356	15,145	15,914	16,153	18,270
Lipjan	-	-	5,916	-	5,916	-
Gjithsej pa diskontuar	1,474,187	1,068,764	11,860,366	11,005,724	13,334,553	12,074,488
Diskontimi (Shënim 8)	33,095	24,822	2,201,326	2,558,099	2,234,421	2,582,921
Gjithsej të diskontuar (neto)	1,441,092	1,043,942	9,659,040	8,447,625	11,100,132	9,491,567

Norma e skontimi në 2024 ishte 3.8% (2023: 3.8%).

8. ASETET TJERA

Asetet e tjera përfshijnë të ardhurat e pritshme nga diskontimi i instrumenteve financiare dhe pjesën e parapagimit ndaj kontraktorit joperformues. Humbjet nga dëmtimi të njohura gjatë periudhës aktuale raportuese lidhen me këto parapagime, të cilat janë dëmtuar plotësisht për shkak të mospërmbushjes së kontraktorit. Këto humbje janë shpalosur si pasuri kontigjente në Shënimin 19.

	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
Asetet e shtyre nga diskontimi i të arketueshmeve	2,234,421	2,582,921
Parapagimet	231,552	231,552
Minus: Humbjet nga rënia në vlerë	(231,552)	-
Gjithsej	2,234,421	2,814,473
Pjesa rrjedhëse (afatshkurtër)	33,095	256,374
Pjesa jo-rrjedhëse (afatgjatë)	2,201,326	2,558,099
Gjithsej	2,234,421	2,814,473

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË (FKEE)

Shënimet për pasqyrat financiare

*(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohen ndryshe)***9. PRONA DHE PAJSIJET**

	Pajisje të IT	Automjete	Përmisimet në objekt	Gjithsej
Kosto historike				
Me 1 janar 2023	-	-	-	-
Shtesat	12,181	44,887	-	57,068
Me 31 dhjetor 2023	12,181	44,887	-	57,068
Me 1 janar 2024	12,181	44,887	-	57,068
Shtesat	77,179	-	27,102	104,281
Me 31 dhjetor 2024	89,360	44,887	27,102	161,349
Zhvlerësimi i akumuluar				
Me 1 janar 2023	-	-	-	-
Zhvlerësimi për vitin	(1,774)	(2,447)	-	(4,221)
Me 31 dhjetor 2023	(1,774)	(2,447)	-	(4,221)
Me 1 janar 2024	(1,774)	(2,447)	-	(4,221)
Zhvlerësimi për vitin	(9,604)	(6,413)	(1,129)	(17,146)
Me 31 dhjetor 2024	(11,378)	(8,860)	(1,129)	(21,367)
Vlera neto e tanishme				
Me 31 dhjetor 2023	10,407	42,440	-	52,847
Me 31 dhjetor 2024	77,982	36,027	25,973	139,982

10. LLOGARITË E PAGUESHME DHE TË TJERA

Llogaritë e pagueshme dhe të pagueshmet tjera janë detajuar më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
Llogaritë e pagueshme ndaj kontraktorëve	91,079	688,637
Llogaritë e pagueshme – Pagesat e mbajtura	83,494	613,301
Tatimi në paga dhe kontribute	8,427	5,307
Gjithsej	183,000	1,307,245

Paratë e mbajtura (Retention Money) janë shuma të mbajtura nga pagesat për kontraktorët, të cilat paguhen pas përfundimit të periudhës së garancisë dhe verifikimit përfundimtar të punimeve.

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË (FKEE)

Shënimet për pasqyrat financiare

*(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohen ndryshe)***11. TË ARDHURA TË SHTYRA**

Të ardhurat e shtyra nga financimet/grantet janë të detajuara më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
Të hyrat e shtyra nga:		
BB/IPA	7,077,831	6,386,179
BB/IDA	3,944,530	3,494,496
Ndërtesa shumë-banesore (Sociale)	9,759,024	9,914,903
Shtëpitë private (Shtëpitë individuale)	1,989,156	9,958,850
GIZ	4,703	-
Komunat	265,154	-
Total	23,040,398	29,754,428
Pjesa rrjedhëse (afatshkurtër)	13,230,497	16,788,263
Pjesa jo-rrjedhëse (afatgjatë)	9,809,901	12,966,165
Gjithsej	23,040,398	29,754,428

Më 31 dhjetor 2024:

Grantet	Të ardhurat e shtyra në 2023	Transferuar në 2024	Liruar në 2024	Të ardhurat e shtyra në 2024
BB/IPA	6,386,179	1,247,654	556,002	7,077,831
BB/IDA	3,494,496	688,766	238,732	3,944,530
Ndërtesa me shumë apartamente	9,914,903	-	155,879	9,759,024
Shtëpitë individuale	9,958,850	-	7,969,694	1,989,156
GIZ	-	37,083	32,380	4,703
Komunat	-	265,154	-	265,154
Gjithsej	29,754,428	2,238,657	8,952,687	23,040,398

Më 31 dhjetor 2023:

Grant	Të ardhurat e shtyra në 2022	Transferuar në 2023	Liruar në 2023	Të ardhurat e shtyra në 2023
BB/IPA	3,546,198	3,236,145	396,164	6,386,179
BB/IDA	1,625,319	2,041,324	172,147	3,494,496
Ndërtesa me shumë apartamente	-	10,000,000	85,097	9,914,903
Shtëpitë individuale	-	10,000,000	41,150	9,958,850
Gjithsej	5,171,517	25,277,469	694,558	29,754,428

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGIJË (FKEE)

Shënime për pasqyrat financiare

(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohen ndryshe)

11. TË ARDHURA TË SHTYRA (VAZHDIM)

Në vitin 2020, është nënshkruar marrëveshja për grantin në mes të Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillimi ("IDA") si administratore e Programit të Partneritetit Pjesa III të Fondit të Mirëbesimit të Komisionit Evropian (KE) dhe Bankës Botërore, për të mbështetur projektin "Eficienca e Energjisë dhe Energjia e Ripërtërishme (KEEREP)" në shumën EUR 9,355,886 dhe implementues Fondi i Kosovës për Eficienca të Energjisë (FKEE), ku objektivat e projektit janë si në vijim:

a) ulja e konsumit të energjisë dhe përdorimit të karburanteve fosile në ndërtesat publike përmes eficientës së energjisë dhe investimeve në energjinë e ripërtërishme;

b) përmirësimin e politikës dhe rregullativës mjedisore për energjinë e ripërtërishme dhe eficientën e energjisë.

Gjithashtu për projektin e KEEREP, Republika e Kosovës ka nënshkruar marrëveshje të financimit me Bankën Botërore/IDA, dhe një pjesë të këtyre fondeve, rreth EUR 5 milionë i ka dedikuar për zbatimin e projekteve të EE nga FKEE. Të gjitha pagesat nga këto fonde janë realizuar nga Ministria e Ekonomisë si zbatuese e projektit të financuar nga kredia. Në vijim paraqiten detajet e të dhënave financiare për këto dy marrëveshje.

Projekti ka përfunduar në gjysmën e parë të viti 2024 dhe është financuar nga tri burime, Komisioni Evropian (IPA) 54%, Banka Botërore (IDA) 35% dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (QRK) 11%.

IDA si administratore e Programit të Partneritetit të Fondeve në Mirëbesimit të KE mori përsipër të financojë projektin me një shumë maksimale prej EUR 9,355,886. Pagesat financuese gjatë vitit 2024 arritën në totalin prej 1,247,654 EUR (2023: 3,442,626 EUR), të detajuara si më poshtë: 808,060 EUR u disbursuan më 7 shkurt 2024; 349,990 EUR më 24 prill 2024; dhe 99,990 EUR më 3 maj 2024. Gjithashtu, një shumë prej 10,386 EUR u kthye më 3 shtator 2024.

Banka Botërore/IDA u angazhua të financojë projektin me një shumë maksimale prej 5 milionë EUR. Fondet nuk u transferuan drejtpërdrejt në llogaritë bankare të FKEE, por u kanalisuan përmes Ministrisë së Ekonomisë, e cila mbuloi kostot e projektit të kryera, që korrespondojnë me 35% të çdo fature të pranuar deri më tani. Më 31 dhjetor 2024, kostot e mbuluara nga ky grant arrinin në 688,766 EUR (2023: 2,041,323 EUR). Periudha fillestare e zbatimit ishte 24 muaj; megjithatë, për shkak të pandemisë, projekti u zgjat për 4 muaj shtesë dhe u përfundua më 30 prill 2024.

FKEE gjatë 2024 ka vazhduar me projektin e subvencionimit të masave EE për përfituesit e shtëpive individuale nga Thirrja e Parë Publike e shpallur në 2023. Gjatë vitit 2024, FKEE ka realizuar Thirrjen e Dytë Publike për subvencionimin e masave EE në shtëpitë individuale, përmes projektit "Zbatimi i Masave të Eficientës së Energjisë për Shtëpitë Individuale të Banimit", FKEE ka mundur subvencionim 45%, jo më shumë se EUR 5,500, për implementim të masave: izolim i jashtëm, i kulmit dhe ndërrim i dyerve e dritareve. Ky projekt ka vlerën prej EUR 10 milionë dhe është mundur nga Bashkimi Evropian (IPA III) përmes Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Në fund të vitit 2024 FKEE ka filluar zbatimin e projektit në bashkëfinancim me komunat përfituese për implementimin e masave të eficientës në ndërtesat e banimit social me pronësi komunale, me 90% të financimit të këtij projekti nga FKEE dhe 10% financim nga komuna përfituese. Projektet e MAB-ve kapin vlerën prej EUR 10 milionë, janë mundur nga Bashkimi Evropian (IPA III) përmes Qeverisë së Republikës së Kosovës. FKEE gjatë vitit 2023 për projektin e MAB-ve ka pranuar EUR 10 milionë nga Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Në vitin 2023, FKEE mori 10 milionë EUR nga Qeveria e Republikës së Kosovës për projektin MAB dhe një shumë shtesë prej 10 milionë EUR për projektin e Shtëpive Individuale. Në fund të vitit 2024, FKEE kishte marrë gjithashtu grante në total prej 265,154 EUR nga komunat pjesëmarrëse, të destinuar për aktivitete projekti të planifikuara të fillojnë në vitin 2025 (2023: 0 EUR).

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË (FKEE)

Shënimet për pasqyrat financiare

(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohen ndryshe)

12. TË ARDHURA NGA GRANTET

Të ardhura nga grantet përbëhen dhe detajohen si më poshtë:

	Viti që përfundon më 31 dhjetor 2024	Viti që përfundon më 31 dhjetor 2023
Grantet:		
Shtëpitë private (Shtëpitë individuale)	7,969,694	41,150
BB/IPA	556,002	396,164
BB/IDA	238,732	172,147
Ndërtesa me shumë apartamente (Sociale)	155,879	85,097
GIZ	32,380	-
Gjithsej	8,952,687	694,558

13. TË HYRAT TJERA

	Viti që përfundon më 31 dhjetor 2024	Viti që përfundon më 31 dhjetor 2023
Të hyrat nga interesi	246,558	-
Të hyrat nga ndëshkimet e kontraktorëve	32,325	35,000
Gjithsej	278,883	35,000

Të ardhurat nga interesat përfshijnë të ardhurat e fituara nga depozitat afatgjata me një normë interesi prej 3% (2023: Zero) si dhe interesat e fituara nga fondet e mbajtura në llogaritë rrjedhëse me një normë interesi prej 0.15% (2023: Zero).

14. PAGAT DHE PËRFITIMET E STAFIT

	Viti që përfundon më 31 dhjetor 2024	Viti që përfundon më 31 dhjetor 2023
Pagat dhe mëditjet e stafit	482,300	292,636
Kontributet pensionale	23,680	14,925
Kompensimi për anëtarët e bordit	30,058	18,931
Gjithsej	536,038	326,492

Numri i të punësuarve deri më 31 dhjetor 2024 është 35 (31 dhjetor 2023: 23).

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË (FKEE)

Shënimet për pasqyrat financiare

(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohen ndryshe)

15. SHPENZIMET TJERA

	Viti që përfundon më 31 dhjetor 2024	Viti që përfundon më 31 dhjetor 2023
Subvencione për shtëpitë individuale	7,769,469	41,138
Kostot e projektit - të tjera	354,181	268,941
Pajisje të vogla	13,706	8,071
Furnzime për zyre	11,191	7,157
Shërbime profesionale dhe konsulencë	10,620	10,770
Dhurata dhe donacione	9,558	912
Shpenzime sigurimi	9,047	341
Shpenzime udhëtimi	7,095	2,244
Internet dhe Komunikim	5,162	4,039
Shpenzime derivate	4,931	1,894
Mirëmbajtje	4,077	1,623
Reprezentacion	3,627	4,157
Trajnime dhe punëtori	2,568	-
Provizione bankre	2,217	3,745
Shpenzime qeraje	2,198	4,379
Marketing dhe reklamim	2,139	1,015
Shpenzime për përkthime dhe zërim	1,800	3,693
Shpenzime të tjera	1,414	14
Shpenzime për publikime	662	1,336
Shpenzime postare	553	-
Gjithsej	8,216,215	365,469

Subvencionet për shtëpitë individuale përfaqësojnë fonde të shpërndara tek individët përmes thirrjeve publike për renovimin e shtëpive familjare. Gjithashtu, kostot e projektit përfshijnë shpenzime për auditim, dizajn, monitorim dhe vlerësim për projekte të tjera.

16. MATJA E VLERËS SË DREJTË

16.1 Instrumentet financiare të matura në vlerën e drejtë

Asset financiare të matura në vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar kategorizohen në përputhje me hierarkinë e vlerës së drejtë, e cila klasifikon inputet e përdorura në teknikat e vlerësimit në tre nivele, bazuar në vëzhgueshmërinë dhe rëndësinë e këtyre inputeve. Hierarkia e vlerës së drejtë është si më poshtë:

- **Niveli 1:** Çmime të kuotuar (të pa ndryshuara) në tregje aktive për asete ose detyrime identike;
- **Niveli 2:** Inputet të tjera përveç çmimeve të kuotuar të përfshira në Nivelin 1, që janë të vëzhgueshme për asetet ose detyrimet, drejtpërdrejt (p.sh., si çmime) ose tërthortë (p.sh., të nxjerra nga çmimet);
- **Niveli 3:** Inputet që nuk janë të vëzhgueshme për asetet ose detyrimet, të cilat nuk bazohen në të dhëna të tregut të vëzhgueshme.

Në datën 31 dhjetor 2024 dhe 2023, Fondi nuk mban asnjë aset financiar të matur në vlerën e drejtë.

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË (FKEE)

Shënimet për pasqyrat financiare

(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohen ndryshe)

16. MATJA E VLERËS SË DREJTË (VAZHDIM)

Tabela më poshtë përmbledh shumën e shfaqur në bilanc dhe vlerat e drejtë të aseteve dhe detyrimeve financiare që nuk janë paraqitur në vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar.

	Vlera në libra		Vlera e drejtë	
	2024	2023	2024	2023
PASURITE				
Paraja dhe ekuivalentet e saj	13,775,095	27,210,614	13,775,095	27,210,614
Depozitat me afat	4,710,016	-	4,710,016	-
Investimet financiare	11,100,132	9,491,567	11,100,132	9,491,567
Gjithsej	29,585,243	36,702,181	29,585,243	36,702,181
DETYRIMET				
Të pagushmet dhe të tjera	183,002	1,307,245	183,002	1,307,245
Gjithsej	183,002	1,307,245	183,002	1,307,245

Paraja dhe ekuivalentet e saj

Vlera e drejtë e aseteve monetare, përfshirë paratë në dorë dhe ekuivalentët e tyre, konsiderohet të jetë afër vlerës së tyre në bilancin e gjendjes financiare, për shkak të afatit të shkurtër të maturimit, që është më pak se tre muaj.

Të pagushmet dhe të tjera

Vlera e shfaqur në bilanc për detyrimet tregtare dhe të tjera konsiderohet e afërt me vlerën e tyre të drejtë.

Matja e vlerës së drejtë e aseteve jo-financiare

Asetet jo-financiare, si prona, pajisjet dhe asetet e paluajtshme, vlerësohen me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet për vlerën. Fondi nuk ka bërë rishikim të vlerës së drejtë për këto asete gjatë periudhave raportuese dhe nuk ka pasur ndryshime që kërkojnë rregullime në shumën e tyre të shfaqur në bilanc.

17. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

Fondi është i ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme që lidhen me instrumentet financiare. Asetet dhe detyrimet financiare të Fondit, të klasifikuara sipas kategorive, janë përmbledhur në Shënimin 16. Llojet kryesore të rreziqeve përfshijnë rrezikun e tregut, rrezikun e kredisë dhe rrezikun e likuiditetit. Në mënyrë që risku të menaxhohet me kujdesin e duhur, Bordi i Drejtorëve ka themeluar Komitetin e Menaxhimit të Risqeve në FKEE, i cili përbëhet nga tre anëtarë. Fokusimi është që të sigurohen në mënyrë aktive rrjedhat e parasë afatshkurtra dhe afatmesme, duke minimizuar ekspozimin ndaj rrezikjve të likuiditetit. Investimet financiare afatgjata menaxhohen për të gjeneruar kthime të qëndrueshme. Fondi nuk merret me tregtim të instrumenteve financiare dhe derivative. Rreziqet financiare më të rëndësishme me të cilat përballet Fondi përshkruhen më poshtë.

Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku që një palë tjetër kontraktuale të mos përmbushë detyrimet e saj ndaj Fondit. Fondi është i ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë kryesisht përmes investimeve afatgjata në projektet e masave EE, dhe paraqet mundësinë që përfituesit e projekteve të financuara nga FKEE-së, si komunat apo institucionet tjera publike, të mos përmbushin obligimet e tyre kontraktuale për kthimin e investimeve. Një nivel i ulët i kthimit të fondeve mund të kufizojë aftësinë e FKEE-së për të ri-investuar në projekte të reja të eficientës së energjisë. Ndërkaq, rreziku kreditor që ndërlidhet me bilancet e parasë dhe denozitat bankare menaxhohet duke diversifikuar mbajtjen e parasë në institucione financiare

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË (FKEE)

Shënime për pasqyrat financiare

(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohen ndryshe)

17. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kreditit përfaqësohet nga vlera kontabël e secilit aktiv financiar të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar.

	2024	2023
<i>Asetet financiare</i>		
Paraja dhe ekuivalentet e saj	13,775,095	27,210,614
Depozitat me afat	4,710,016	-
Investimet financiare	11,100,132	9,491,567
Gjithsej	29,585,243	36,702,181

Rreziku i likuiditetit

Fondi nuk është i ekspozuar ndaj rrezikut të konsiderueshëm të likuiditetit pasi mban asete të mjaftueshme likuide për të përmbushur detyrimet e tij financiare kur ato skadojnë. Prandaj, zbulimet e hollësishme në lidhje me rrezikun e likuiditetit nuk konsiderohen të nevojshme.

Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i ndryshimeve në çmimet e tregut, siç janë kurset e këmbimit valutor dhe normat e interesit, të cilat mund të ndikojnë në të ardhurat e Fondit ose në vlerën e instrumenteve të saj financiare. Objektivi i menaxhimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimin ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm.

Rreziku i këmbimit valutor

Fondi operon në tregun vendas brenda territorit të Republikës së Kosovës dhe nuk është i ekspozuar ndjeshëm ndaj rrezikut të këmbimit valutor pasi të gjitha transaksionet për vitet që përfundojnë më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë të denominuara në Euro.

Në përgjithësi, Fondi nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të këmbimit valutor sepse:

- Të ardhurat fitohen në Euro;
- Blerjet e aseteve dhe materialeve kryesore të përdorura në aktivitetet e investimit të Fondit janë të denominuara në Euro;
- Grantet merren në Euro;
- Asetet financiare janë të denominuara në Euro.

18. TRANSAKSIONET ME PALET E LIDHURA

Palët e lidhura përfshijnë njësi dhe individë me kontroll, kontroll të përbashkët ose ndikim të rëndësishëm mbi Fondin, si dhe personelin kryesor të menaxhimit. Transaksionet me palët e lidhura u kryen në rrjedhën e zakonshme të biznesit. Tabela më poshtë tregon vëllimin dhe bilancet e transaksioneve të tilla për vitet që përfunduan më 31 dhjetor 2024 dhe 2023.

	Viti që përfundon më 31 dhjetor 2024	Viti që përfundon më 31 dhjetor 2023
Kompenzimi per Personelin kyq	73,932	50,486
Kontributet e fondeve nga Qeveria	-	5,000,000

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGIJË (FKEE)

Shënime për pasqyrat financiare

(Shumat në Euro, përveç nëse deklarohen ndryshe)

19. ZOTIMET DHE KONTIGJENCAT

Zotimet

FKEE është aktualisht i përfshirë në procedura ligjore të nisura nga një operator ekonomik, i cili ka ngritur një padi duke kërkuar një pagesë përfundimtare të papaguar në shumën prej 82,795 EUR. Kjo kërkesë lidhet me punët e kryera në kuadër të projekteve të financuar nga Fondi. Megjithatë, për shkak të dështimit të operatorit ekonomik për të përmbushur detyrimet kontraktuale dhe përfundimit të pa-sukses të kontratës, Fondi nuk e ka ekzekutuar këtë pagesë, pasi që ndaj këtij operatori ekonomik kemi një parapagim të hapur.

Kontigjencat

Për të shlyer parapagimet ndaj furnizuesit dhe për të ju përgjigjur ndaj padisë së operatorit ekonomik, FKEE ka nisur veprime ligjore kundër kompanisë së sigurimeve (“Garantuesi” — një ofruer sigurimi përgjegjës për lëshimin e garancive lidhur me performancën në emër të kontraktorit) për moszbatimin e garancive të lëshuara për kontraktorin. Padia ligjore përfshinë:

- EUR 273,978 nën garancinë e performancës, dhe
- EUR 241,901 nën garancinë e avancit.

Të dyja rastet ligjore janë aktualisht në proces në gjykatën e shkallës së parë. Bazuar në vlerësimin ligjor të përgatitur nga përfaqësuesit e FKEE-it dhe dokumentacionin mbështetës, FKEE ka një nivel të lartë besimi për një rezultat të favorshëm.

20. NGJARJET PAS PËRFUNDIMT TË PERIUdhËS RAPORTUESE

Zhvillimet e rëndësishme në FKEE pas periudhës raportuese dhe pritjet

Bazuar në ligjin për Eficiencë të Energjisë, Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE) ka zgjeruar dhe vijon funksionimin e tij me investime në eficiencën e energjisë në sektorin Rezidencial dhe atë Privat, duke zbatuar Projektin Emergjent që synon përmirësimin e kursimit të energjisë dhe niveleve të mirëqenies së përfituesve në ndërtesat shumë-banesore sociale në pronësi të komunave në Kosovë si dhe zbatimin e masave të eficiencës së energjisë në shtëpitë individuale të banimit.

Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit të IPA III, Pakos së Mbështetjes për Energji të aranzhuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ku FKEE-ja zbaton “Masën 3: Mbështetja e konsumatorëve individual familjar duke përfshirë konsumatorë në nevojë përmes rritjes së eficiencës në njësitë e banimit dhe ndërtesa” – në vlerë deri në 20 milionë Euro (për dy nën-masa). Për këtë FKEE-ja ka ftuar të gjitha komunat e interesuara që t’i dorëzojnë aplikacionet e tyre për Projektin Emergjent, i cili në njërin masë përfshinë investimin prej 90% nga FKEE (si Grant për Komunën) si dhe vetëm 10% pjesëmarrje nga Komuna, ku punimet në terren fillojnë në muajin janar 2025. Gjithashtu, si pjesë e masës 3 të lartpërmendur, planifikohet të vazhdoj disbusrimi për zbatimin e masave të eficiencës së energjisë në shtëpitë individuale të banimit. Këto mjete jepen pa kthim për komunën dhe qytetarin, për dallim nga mekanizmi i deritashëm i FKEE.


Sa i përket sektorit publik, FKEE po ashtu pritet të fillojë implementimin e masave të eficiencës të energjisë edhe në 17 projekte tjera të sektorit publik.

Ngjarjet e përshkruara më sipër, nuk kanë asnjë ndikim në Pasqyrat Vjetore Financiare 2024, por vetëm sa e konfirmojnë konkuzionin se parimi i vijimësisë nuk vjen në pikëpyetje

21. APROVIMI I PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga bordi i drejtorëve me datën 16 qershor 2025 dhe janë autorizuar për publikimin e tyre.





Publikimi i këtij raporti është mundësuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Fondit të Kosovës për Efiçencë të Energjis dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.